



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe

**JURISPRUDENCA E GJYKATËS
EVROPIANE TË TË DREJTAVE
TË NJERIUT NË LIDHJE ME
SHQIPËRINË, KROACINË,
BOSNJEN DHE
HERCEGOVINË,
MAQEDONINË DHE SERBINË**

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të
Drejtave të Njeriut në lidhje me Shqipërinë,
Kroacinë, Bosnjen dhe Hercegovinën,
Maqedoninë dhe Serbinë

Përgatitur nga Qendra AIRE

Ne do të dëshironim të falenderonim Velimir Delovski – avokat, Valentina Pavlicic – Avokatja e Shtetit e Malit të Zi në GJEDNJ, Natasa Plavsic - Avokatja e Shtetit e Serbisë në GJEDNJ, Elma Veledar Arifagic – avokate, dhe Ina Xhepa – drejtore ekzekutive e Qendrës Europiane për kontributin e tyre në këtë publikim.

PËRMBAJTJA

2017 NË GJYKATËN EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT – PËRMBLEDHJA VJETORE.....	5
SHQIPËRIA	10
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	13
KROACIA	21
MAQEDONIA.....	29
MALI I ZI	39
SERBIA.....	45

2017 në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut – Përmbledhja vjetore

Një shqyrtim i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata ose GJEDNJ) gjatë vitit 2017 tregon një sërë tendencash dhe sfidash specifike. Trendet kryesore dhe sfidat do të paraqiten në pjesën e parë të këtij publikimi. Gjithashtu, ky botim do të trajtojë gjashtë çështje me rëndësi të veçantë, vendime ose kërkesa të sjella para Gjykatës vitin e kaluar. Kjo përmbledhje do të pasohet nga shqyrtimi i jurisprudencës së Gjykatës kundër vendeve të rajonit gjatë vitit 2017.

Trendet e vendimeve

Në fillim të vitit 2017 përpara Gjykatës ishin në pritje 79,750 çështje; kjo shifër u rrit në 93,200 në qershor 2017. Kjo situatë shpjegohet pjesërisht për shkak të rritjes së konsiderueshme të çështjeve që vijnë nga Turqia, pas trazirave politike dhe një përpjekje të dështuar të grushtit të shtetit në fund të vitit 2016.

Çështja e mbingarkesës së Gjykatës me kërkesa dhe nevoja për reforma - të cilat do të kenë në vëmendje administrimin e çështjeve - nuk përbën një problematikë e re. Vala e dytë e reformës së madhe, e cila trajtoi një numër të lartë çështjesh të reja dhe atyre që ishin në pritje përpara Gjykatës u adresua me hyrjen në fuqi të Protokollit 14 në vitin 2010. Ky Protokoll prezantoi formacionet e reja gjyqësore për çështje më të thjeshta dhe vendosi kritere të reja pranueshmërie (ekzistenca e një “disavantazhi të rëndësishëm» për kërkuuesin); gjithashtu zgjati mandatin e gjyqtarëve në 9 vjet (1 parinovueshëm).

Gjatë viteve janë bërë një sërë deklaratash të rëndësishme, pas takimeve ndërmjet Shteteve Anëtare, të cilat kanë kërkuar reforma, p.sh., Deklarata e Brighton (2012) dhe Deklarata e Brukselit (2015). Deklaratat vazhduan përpjekjen për të gjetur mënyra të reja për të përshpejtuar shqyrtimin e çështjeve. Përveç kësaj, dy protokolle të tjerë janë hartuar dhe janë paraqitur për ratifikim përpara Shteteve Anëtare. Megjithatë, këto protokolle ende duhet të ratifikohen nga të gjitha Shtetet Anëtare për të hyrë në fuqi. Protokollit 15 përcakton një reduktim të kohës brenda së cilës një kërkesë duhet të depozitohet përpara Gjykatës, nga gjashtë në katër muaj pas marrjes së vendimit përfundimtar në nivel kombëtar. Për më tepër, parimi i subsidiaritetit do të jetë pjesë e Preambulës së Konventës sapo të hyjë në fuqi Protokollit 15, ku Shteti Kontraktues mban përgjegjësinë parësore të mbrojtjes së të drejtave të Konventës. Protokollit 16 do të lejonte, që gjykatat më të larta kombëtare të kërkonin nga Gjykata një opinion ligjor mbi çështje parimesh, që kanë të bëjnë me interpretimin ose zbatimin e Konventës.

Së fundmi, në fillim të vitit 2018, u hartua drafti i Deklaratës së Kopenhagenit - pas takimeve me Shtetet Anëtare. Shtetet Anëtare dhe Gjykata kanë qenë të hapura për disa nga hapat më të rëndësishme të reformave të përcaktuara për gjatë viteve. Deri më tani, masat e reformave kanë qenë të suksesshme në lidhje me reduktimin e numrit të çështjeve përpara Gjykatës. Megjithatë, si Shtetet Anëtare dhe Gjykata dakordësohen me faktin se ndërmarrja e hapve të mëtejshme është e nevojshme.

Statistikat tregojnë rritje të theksuar të numrit të vendimeve të dhëna nga Gjykata. Në vitin 2017, u dhanë 1,068 vendime, 8% më shumë se viti 2016. Në 2017 formacionet me një gjyqtar të vetëm vendosën për 66,156 kërkesa (një rritje prej 113% krahasuar me vitin 2016), 523 vendime u dhanë nga Komitetet me tre gjyqtarë (69% më shumë se në 2016), shifër që përbën 17% të vendimeve të dhëna nga Komiteti gjatë këtij viti. Dhoma e Madhe ka mbajtur 13 seanca dëgjimore dhe ka dhënë 19 vendime, që përfaqësojnë 12,167 kërkesa.

Përsa i takon çështjeve që janë ende në pritje përpara Gjykatës: 24 raste janë në pritje para Dhomës së Madhe, të cilat përfaqësojnë 39 kërkesa individuale. Në fund të vitit 2017, ka pasur 56,250 çështje në pritje para Dhomave, krahasuar me 79,750 në fillim të vitit 2017. Rënia e numrit të kërkesave në pritje është veçanërisht e dukshme duke pasur parasysh presionin në rritje të Gjykatës, që rrjedh nga numri i madh i rasteve nga Turqia. Megjithatë, duhet të theksohet se afërsisht 12,000 kërkesa u nxorën nga lista përmes vendimit të *Burmych* (shih më poshtë).

Pra, Gjykata ka qenë e suksesshme në përpjekjet e saj për të zvogëluar numrin e çështjeve pezull gjatë vitit 2017. Në total ka pasur një rënie prej 29% të rasteve të pazgjidhura, si rezultat i rritjes së vendimeve të publikuara.

Procedura

Pavarësisht rënies së përgjithshme të numrit të kërkesave në pritje, ende mbetet sfida e uljes së numrit të çështjeve të përsëritura përpara Dhomave. Prezantimi i procedurave të reja ka synuar të modernizojë përpunimin dhe gjykimin. Ndërkohë, është zbatuar një politikë prioritare që u mundëson përqëndrimin e burimeve në rastet më të ngutshme.

Për shembull, 6,000 raste nga Hungaria që lidheshin me paraburgimin, fillimisht u klasifikuan në kategorinë e prioriteteve. Ato u dërguan më pas tek Formacioni me një Gjyqtar të vetëm pasi Dhoma deklaroi se Hungaria kishte miratuar një mekanizëm rregullues në nivel kombëtar. Së dyti, kërkesat që lidhen me kushtet e ndalimit në Rumani janë subjekt i një procedure pilot.

Përqasja e politikave prioritare ka kontribuar në uljen e numrit total të çështjeve me 23% në 2017 krahasuar me vitin 2016. Numri i kërkesave prioritare që përfunduan me vendim u rrit me 26% midis 2016 dhe 2017.

Komiteti i Ministrave mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve dhe siguron, që shteti të përmbushë detyrimin ligjor në zbatim të nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve), duke përfshirë marrjen e masave që do të përmirësojnë situatën. Lidhur me rolin e Komitetit të Ministrave, shih më poshtë një shënim mbi çështjen *Burmych*, ku një numër i madh çështjesh i kaluan Komitetit të Ministrave.

Rrjeti i Gjykatave të Larta u lançua në 2015 për shkëmbimin e informacionit mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së ndërmjet gjykatave më të larta kombëtare dhe GJEDNJ. Në vitin 2017 ndodhi një zgjerim i tij.

Forumi i parë i Pikave të Kontaktit u mbajt në Strasburg në qershor 2017. Pesëdhjetë përfaqësues nga Pikat e Kontaktit dhe dyzetë e katër të tjerë nga gjykatat e niveleve të larta, si dhe punonjës të Sekretariatit të Gjykatës morën pjesë në këtë event ku diskutuan mbi funksionimin dhe të ardhmen e Rrjetit të Gjykatave të Larta. Deri më tani ky rrjet numëron 64 gjykata në 34 Shtete Anëtare.

Jurisprudenca

Neni 6, e drejta për një proces të rregullt, ishte edhe në 2017 neni më i invokuar. Veçanërisht kërkuesit u ankuan për kohëzgjatjen e proceseve në nivel vendor dhe moszbatimin e vendimeve të brendshme. Më tej, në kontekstin e nenit 3, çështjet e paraqitura përfshinin më së shumti trajtim çnjerëzor ose poshtëruar dhe mungesën e hetimit efektiv. Për shembull, kërkuesit janë ankuar se shteti nuk ka marrë

masat e duhura dhe nuk kujdeset për nevojat e tyre, fizike apo mendore, gjatë kohës së ndalimit. Së fundmi, shumë kërkues argumentuan një shkelje të së drejtës së tyre për liri dhe siguri sipas nenit 5, për shembull duke u arrestuar dhe ndaluar për disa orë pa asnjë akuzë konkrete.

Numri më i madh i rasteve, në të gjitha fushat u soll kundër Rumanisë, e ndjekur nga Rusia dhe Turqia.

Në vitin 2017 u dhanë një numër vendimesh të rëndësishme, që ndikojnë si substancën e jurisprudencës së Konventës, ashtu edhe procedurat e GJEDNJ. Në vazhdim kemi elaboruar më tej një përzgjedhje të tyre.

Përzgjedhja e çështjeve

Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë, vendim i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, nr. 56080/13l: Kërkuesja pretendonte shkelje të nenit 2, e drejta për jetën, me argumentin se bashkëshorti i saj kishte marrë një infeksion në spital, ku personeli mjekësor kishte qenë i pakujdesshëm dhe neglizhent në trajtimin e tij. Detyrimi substancial pozitiv në rastin e neglizhencës mjekësore u konstatua të jetë i kufizuar në krijimin e një kuadri rregullator të përshtatshëm, që imponon spitalet, qoftë private apo publike, për të miratuar masat e duhura për mbrojtjen e jetës së pacientëve. Në rrethanat e rastit, kuadri rregullator përkatës në Portugali nuk ka shfaqur ndonjë mangësi. Nuk u vlerësua shkelje e nenit 2 në aspektin substancial. Në kontrast, në lidhje me detyrimin procedural, Gjykata konsideroi se sistemi i brendshëm në tërësi, kur u përball me një rast të neglizhencës mjekësore, që rezultoi me vdekjen e bashkëshortit të kërkueses, nuk arriti të japë në kohë një përgjigje të përshtatshme në pajtim me detyrimin e shtetit sipas nenit 2. Për rrjedhojë, u vlerësua shkelje e aspektit procedural të nenit 2.

Tagayeva dhe Tërjet k. Rusisë, vendim i 13 prillit 2017, nr. 26562/07 dhe 6 kërkesa të tjera: kërkuesit ngritën çështje të ndryshme lidhur me sulmin terrorist, rrethimin dhe goditjen e shkollës nr. 1 në Beslan, Rusi, në shtator 2004 dhe reagimin e shtetit ndaj atij sulmi.

Planifikimi dhe kontrolli i operacionit për të liruar pengjet, nuk kishte marrë të gjitha masat e mundshme për të shmangur dhe/ose minimizuar humbjen e rastësishme të jetës së civilëve. Në lidhje me disa prej kërkuesve, Gjykata gjeti prova që mbështesin një ankesë *prima facie* që agjentët shtetërorë përdorën armët pa dallim ndaj ndërtesës ku brenda ishin terroristët dhe pengjet. Qeveria nuk dha një shpjegim të kënaqshëm dhe bindës në lidhje me përdorimin e forcës, rrethanave të vdekjes dhe lëndimeve për të cilat ankoheshin kërkuesit. Përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga agjentët e shtetit u gjet për të kontribuar, deri diku, në rritjen e numrit të viktimave midis pengjeve.

Gjykata më pas shqyrtoi nëse përdorimi i forcës me pasojë vdekjen mund të konsiderohej i justifikuar. Gjykata vërejti se nuk ishte detyrë e saj të zëvendësonte mendimin e vetë asaj në lidhje me situatën e agjentëve të sigurisë, të cilët ishin të detyruar të ndërhynin për të shpëtuar jetën e njerëzve në një situatë jashtëzakonisht të vështirë. Gabimet në gjykim ose vlerësimet e gabuara, fatkeqësisht në retrospektivë, nuk do të sjellin përgjegjësi sipas nenit 2. Megjithatë, përdorimi i armëve shpërthyes pa dallim, siç ndodhi në këtë rast, nuk mund të konsiderohet si absolutisht e nevojshme në rrethanat konkrete. Një shkelje e nenit 2 është gjetur për shkak të përdorimit masiv të forcës me pasojë vdekjen. Brishtësia e kuadrit ligjor që rregullon përdorimin e forcës në të tilla raste derivoi në arritjen e këtij përfundimi.

Gjithashtu, Gjykata konkludoi se kishte pasur një shkelje të nenit 2 në lidhje me të gjithë kërkuesit pasi hetimi nuk ishte në gjendje të çonte në përcaktimin nëse forca e përdorur në këtë rast ishte e justifikuar dhe për këtë arsye nuk ishte efektive.

Becker k. Norvegjisë, vendim i 5 tetorit 2017, nr. 21272/12: Ky vendim ishte një zhvillim i rëndësishëm në sferën e lirisë së shtypit, mbrojtur nga neni 10 (liria e shprehjes). Kërkuesja ishte një gazetare që pretendonte se ishte detyruar të jepte dëshmi, që do të lejonte një ose më shumë burime gazetareske të identifikoheshin, duke shkelur të drejtën e saj për të marrë dhe për të dhënë informacion. Kërkuesja nuk u urdhërua shprehimisht të zbulonte identitetin e burimit të informacionit në artikullin e saj të lajmeve. Vendimi i gjykatës vendase ishte i kufizuar në urdhërimin e saj për të dëshmuar për kontaktin e saj me z. X., i cili kishte deklaruar veten se ishte burimi i informacionit. Megjithatë, Gjykata Evropiane konsideroi se efektet e mundshme të një urdhri të tillë ishin të një natyre të tillë, që mundësonin aplikimin e parimeve të përgjithshme të zhvilluara në lidhje me urdhrat e zbulimit të burimeve të informacionit.

Gjykata pati parasysh rëndësinë e mbrojtjes së burimeve gazetareske në kuadër të lirisë së shtypit dhe konstatoi se arsyet e parashtruara në favor të detyrimit të kërkueses për të dëshmuar mbi pikën e saj të kontaktit z. X. (parandalimi i krimit dhe prishjes së rendit), edhe pse të rëndësishme ishin të pamjaftueshme. Gjykata nuk u bind se kjo kërkesë ishte në interes të publikut. U konstatua shkelje e nenit 10.

Bărbulescu k. Rumanisë, vendim i Dhomës së Madhe i 5 shtatorit 2017, nr. 61496/08: Interesat konkurruese në çështjen në fjalë ishin, nga njëra anë, e drejta e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private sipas nenit 8 dhe nga ana tjetër, e drejta e punëdhënësit të tij për t'u angazhuar në monitorimin e komunikimeve, duke përfshirë kompetencat përkatëse disiplinore, në për të siguruar një menaxhim të mirë të kompanisë. Në sajë të detyrimeve pozitive të Shtetit sipas nenit 8 të Konventës, autoriteteve kombëtare u është kërkuar të balancojnë këto interesa. Përmbajtja e komunikimit të dërguar nga kërkuesi ishte përdorur si argument për nisjen e procedurave disiplinore kundër tij.

Ishte e diskutueshme nëse autoritetet kombëtare kishin arritur një ekuilibër të drejtë midis interesave, që vihehin në lojë. Gjykatat vendase nuk arritën të përcaktojnë nëse kërkuesi kishte marrë njoftim paraprak se komunikimet e tij mund të monitoroheshin dhe nuk kishin parasysh faktin se kërkuesi nuk ishte informuar për natyrën apo shtrirjen e monitorimit, ose shkallën e ndërhyrjes në jetën e tij private dhe korrespondencën. Gjykatat kombëtare nuk kishin arritur të përcaktonin arsyen specifike për justifikimin e masave monitoruese, nëse mund të ishin përdorur masa të tjera dhe nëse komunikimet mund të aksesoheshin pa dijeninë e kërkuesit. U konstatua shkelje e nenit 8.

Merabishvili k. Gjeorgjisë, vendim i Dhomës së Madhe i 28 nëntorit 2017, nr. 72508/13: Kjo çështje ka të bëjë me arrestimin dhe paraburgimin e njërit prej ish kryeministrave të Gjeorgjisë.

Ai ishte arrestuar me akuzën e shpërdorimit të detyrës, mashtrimit zgjedhor dhe keqpërdorimit të fondëve. Gjykata konstatoi se kufizimi i të drejtës së kërkuesit për liri kishte arritur në një situatë të vazhdueshme dhe në të gjitha rrethanat, qëllimi mbizotërues i kufizimit kishte ndryshuar me kalimin e kohës. Në fillim, arrestimi dhe hetimi ndaj tij ishte bazuar mbi një dyshim të arsyeshëm. Megjithatë, më vonë, qëllimi mbizotërues u bë marrja e informacionit për vdekjen e një individi dhe të dhënat e llogarisë bankare të tij. U konstatua shkelje e nenit 18 në lidhje me nenin 5 të Konventës.

Burmych dhe Tërjet k. Ukrainës, vendim i Dhomës së Madhe i 12 tetorit 2017, nr. 46952/13, 47786/13, 54125/13, 56605/13, 3653/14: kërkuessit u ankuan për mosekzekutim ose vonesa në zbatimin e vendimeve të brendshme të dhëna në favor të tyre. Ata pretendonin shkelje të të drejtave të tyre sipas nenit 6, e drejta për një proces të rregullt dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, mbrojtjen e pronës, si dhe në kuadër të nenit 13, e drejta për një mjet ankimi efektiv.

Gjykata përsëriti konkludimet e saj në vendimin pilot *Ivanov*, konkretisht problemet strukturore ishin të një shkalle të gjerë dhe komplekse në natyrë, që kërkonte zbatimin e masave gjithëpërfshirëse dhe komplekse – mundësisht të një natyre legjislative dhe administrative. Gjykata vuri në dukje se dëshimi i autoriteteve ukrainase përgjatë viteve në marrjen e masave e kishte lënë problemin sistematik të moszbatimit të vendimeve të brendshme gjyqësore, të pazgjidhur duke shkaktuar kështu një numër të madh kërkesash pasuese, të cilat ngritën çështje të njëjta me rastin në fjalë.

Situata bëri, që Gjykata të miratojë një praktikë të trajtimit të çështjeve pasuese të vendimit *Ivanov* përmes një procedure më të shpejtë dhe të thjeshtuar, e cila i lejoi kërkuessve të marrin një vendim të shpejtë, duke u dhënë atyre mjete financiare. Procedura e vendimit pilot u krijua në përgjigje të rritjes së numrit të çështjeve përpara Gjykatës, që shkaktohen nga mosfunksionimi i sistemeve - me synimin kryesor për të siguruar efektivitet afatgjatë të makinerisë së Konventës. Qëllimi i dyfishtë i gjykimit pilot ishte funksionimi më efektiv i sistemit të Konventës dhe zgjidhja e çështjeve themelore në nivel vendor - ku përfshihet rivendosja në pozitë e mëparshme e viktimave aktuale dhe ato potenciale.

Së fundi, Gjykata deklaroi se ishte detyrë e Komitetit të Ministrave që të mbikëqyrte ekzekutimin e vendimit dhe të sigurote, që shteti të përmbushë detyrimet e veta sipas nenit 46. Më pas, Gjykata nxorri jashtë liste 12,143 kërkesa kundër Ukrainës dhe e konsideroi Komitetin e Ministrave si mekanizmin më të mirë për të garantuar ekzekutimin e vendimit të Gjykatës nga Ukraina.

Mammadov k. Azerbajxhanit, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 majit 2014, nr. 15172/13: Rasti, i cili u vendos fillimisht në vitin 2014, kishte të bënte me arrestimin dhe ndalimin e një politikani të shquar të opozitës në Azerbajxhan. Kërkuessi argumentoi se ai u arrestua dhe u ndalua pa asnjë dyshim të arsyeshëm, duke shkelur dhe të drejtën e tij për t'u konsideruar i pafajshëm. Gjykata konstatoi se Qeveria nuk kishte demonstruar dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, për të arrestuar kërkuessin dhe se ai ishte shpallur fajtor përpara se kjo fajësi të vërtetohej konform ligjit. Rrjedhimisht, është konstatuar shkelje e nenit 5 § 1 dhe nenit 6 § 2 të Konventës.

Në dhjetor 2017, Komiteti i Ministrave përdori për herë të parë procedurat e pezullimit kundër Azerbajxhanit, për shkak se autoritetet vazhdonin të refuzonin lirimin e pakushtëzuar të kërkuessit. Komiteti i ka drejtuar zyrtarisht Gjykatës pyetjen nëse shteti ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij për të ekzekutuar një vendim. Përdorimi i një dispozite të tillë ka ekzistuar që kur Protokollin 14 ka hyrë në fuqi dhe ka për qëllim të përdoret vetëm në "rrethana të jashtëzakonshme". Ky proces ende nuk ka përfunduar.

SHQIPËRIA

Hyrje

Ky dokument përmbledh vendimet e marra nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në lidhje me Republikën e Shqipërisë, që nga koha e ratifikimit të Konventës Evropiane më 2 tetor 1996.

Deri më 31 dhjetor 2016, Gjykata ka vendosur kundër Shqipërisë 70 vendime themeli dhe 62 vendime mbi pranueshmërinë. Gjatë 2017 nuk u dha asnjë vendim themeli dhe pranueshmërie në lidhje me Shqipërinë. Megjithatë, 8 çështje u nxorrën nga lista e rasteve në pritje, nga Komiteti me Tre Gjyqtarë. Gjithashtu, Komiteti i Ministrave, i cili monitoron ekzekutimin e vendimeve dhënë nga Gjykata, miratoi një rezolutë për Shqipërinë në lidhje me tre çështje, duke e mbyllur shqyrtimin e tyre pasi ishin miratuar masat e përshtatshme në nivel vendor nga shteti shqiptar.¹

Më poshtë gjendet një përmbledhje e shkurtër e llojeve të çështjeve në të cilat është përfshirë Shqipëria.

Në lidhje me nenin 2 të Konventës, e drejta e jetës, janë dy vendime kryesore: *Ceka* çështja u çregjistrua, pasi Gjykata vendosi se kërkuesi kishte marrë zgjidhjen e plotë sipas së drejtës së brendshme, duke qenë se Shteti kishte pranuar qartazi shkeljen dhe kishte ofruar dëmshpërblimin e përshtatshëm.² *Rrapo*³ kishte të bënte me ekstradimin e kërkuesit, nuk u konstatua shkelje, pasi në notën diplomatike jepeshin garanci të mjaftueshme se nuk do të kishte cenim të së drejtës së jetës pas ekstradimit.

Pesë vendime janë dhënë në lidhje me nenin 3. Në tre prej tyre është gjetur shkelje e këtij neni. Çështjet kishin të bënin me kushtet e ndalimit⁴, mungesa e trajtimit të duhur mjekësor në burg⁵ dhe dhunimi i një kërkuesi, që gjendet në kontrollin e policisë⁶. Në këto vendime Gjykata vërejtë se kushtet e ndalimit dhe dhe trajtimi mjekësor ishin të përshtatshme me kushtet shëndetësore, p.sh., vendosja e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor në të njëjtin ambient me të burgosur të shëndetshëm dhe mungesa e ndihmës mjekësore⁷, si dhe ashpërsia e dhunës ishte e tillë që derivoi torturë në kuptim të nenit 3.⁸

Dy vendime janë dhënë në lidhje me nenin 5, e drejta për liri dhe siguri, ku në të dy këto raste është gjetur shkelje. Në vendimin *Delijorgji*⁹, Gjykata Evropiane gjeti shkelje të neneve 5§1 dhe 5§4 për shkak të kohëzgjatjes së paraburgimit “në pritje të vendimit”, si edhe periudhës së gjatë që u desh për të shqyrtuar një kërkesë për lirim. Bazuar në nenin 5§1, kërkuesi pretendonte se periudha e paraburgimit “në pritje të vendimit” kishte skaduar dhe nëse ishte kështu, ndalimi i tij vazhdonte të ishte i paligjshëm.

1 Rezoluta e Komitetit të Ministrave CM/ResDH(2017)417.

2 *Ceka k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012

3 *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012

4 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009

5 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009; *Dybeku k. Shqipërisë*, vendim i 18 dhjetorit 2007.

6 *Kaciu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012.

7 *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009

8 *Kaciu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, vendim i 23 tetorit 2012.

9 *Delijorgji k. Shqipërisë*, vendim i 28 prillit 2015

Në total janë dhënë 36 vendime në lidhje me nenin 6. Shkelje u gjetën në 33 çështje. Pjesa më e madhe e çështjeve kanë pasur në objekt ankim për proces të parregullt dhe mungesë të aksesit në gjykatë. Për shembull, në çështjen në rastin *Caka*¹⁰ - dështimi për të siguruar dhënien e dëshmisë në gjykimin e kërkuarit nga dëshmitarë të caktuar dhe dështimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për të marrë parasysh siç duhej dëshmitë e katër dëshmitarëve në favor të kërkuarit (shkelje e nenit 6§1 i lexuar me nenin 6§3(d)). në rastin *Laska and Lika*¹¹ - dështimi për të korigjuar parregullsitë në fazën e hetimit të lidhura me identifikimin e të dyshuarve, gjatë gjykimin të kërkuarve (shkelje të nenit 6§1). në rastin *Cani*¹² - refuzimi për t'i dhënë kërkuarit të drejtën të mbronte veten e tij në një seancë publike para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë (shkelje të nenit 6§1). Në rastin *Dauti*¹³, Gjykata vërejtë se komisioni i ankesave nuk mund të konsiderohej si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, siç kërkohej nga neni 6§1 i Konventës dhe vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në atë kohë, nuk mund të kundërshtoheshin para një gjykate vendase. Në rastin *Qufaj*¹⁴, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të së drejtës së kompanisë kërkuarë për gjykim të drejtë, për shkak të moszbatimit të një vendimi përfundimtar gjyqësor (shkelje e nenit 6§1). Rasti *Luli*¹⁵ kishte të bënte me zgjatjen e tepruar të procedurave civile para organeve të ndryshme prej vitit 1996 e deri më tani. Gjykata Evropiane kritikoi në veçanti, dështimin e sistemit gjyqësor për të menaxhuar siç duhej një shtim të proceseve, që lidheshin me të njëjtën problematikë.

Një rast tjetër i rëndësishëm është *Bici*¹⁶, i cili ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave para Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Durrësit lidhur me njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës. Gjykata Evropiane gjeti shkelje të nenit 6§1 për arsye se këto procedura kishin zgjatur për 11 vjet, 9 muaj dhe 18 ditë para një niveli të vetëm juridiksioni.

Në një grup çështjesh, Gjykata ngriti shqetësimin e problemit sistematik për dështimin e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare gjyqësore dhe administrative. Gjykata Evropiane mori një vendim pilot, *Manushaqe Puto dhe të Tjerët*¹⁷. Gjykata konstatoi se kuadri i brendshëm ligjor nuk ofronte zgjidhje efektive për të bërë të mundur dëshmipërblimin e përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në lidhje me moszbatimin e vendimeve të komisionit, që njihnin të drejtën e kërkuarve për kompensim. Duke parë problematikën e mekanizmit të kompensimit në Shqipëri, e cila vazhdoi të sillej para Gjykatës edhe pas vendimit edhe në një seri rastesh të tjera (*Driza dhe Ramadhi*) dhe të nevojës urgjente për zgjidhje të shpejtë dhe të duhur në nivelin e brendshëm kundrejt kërkuarve, Gjykata e konsideroi të domosdoshme aplikimin e procedurës vendim-pilot. Sipas nenit 46, Shqipëria duhej të ndërmerre masa të përgjithshme, si një çështje urgjente, në mënyrë që të sigurohej në mënyrë efektive e drejta e kompensimit.

10 *Balliu k. Shqipërisë*, vendim i 16 qershorit 2005; *Caka k. Shqipërisë*, vendim i 8 dhjetorit 2009

11 *Laska dhe Lika k. Shqipërisë*, vendim i 20 prillit 2010

12 *Cani k. Shqipërisë*, vendim i 6 marsit 2011

13 *Dauti k. Shqipërisë*, vendim i 3 shkurtit 2009; *Driza k. Shqipërisë*, vendim i 13 nëntorit 2007

14 *Qufaj k. Shqipërisë*, vendim i 18 nëntorit 2004

15 *Luli dhe të Tjerët Others k. Shqipërisë*, vendim i 1 prillit 2014

16 *Bici k. Shqipërisë*, vendim i 3 dhjetorit 2015.

17 *Manushaqe Puto dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, vendim i 31 korrikut 2012

Në lidhje me nenin 7 është dhënë një vendim, rasti *Alimuçaj*, në të cilin u konstatua shkelje dhe jo-shkelje.¹⁸ Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të parimit të ligjshmërisë së veprave penale dhe dënimeve, pasi kërkuesit i ishte dhënë një dënim më i rëndë sesa ai që parashikohej në kohën e kryerjes së veprës penale

Ka pasur dy raste lidhur me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare sipas nenit 8¹⁹. Në rastin *Bajrami*²⁰ që kishte të bënte me shkeljen e të drejtës së kërkuesit për respektimin e jetës familjare për shkak të dështimit të autoriteteve shqiptare për të ndërmarrë masat e nevojshme për ribashkimin me vajzën e tij u konstatua shkelje, Gjykata konstatoi se sistemi ligjor shqiptar, në kohën e gjykimit, nuk ofronte një kornizë alternative ligjore që t'i siguronte kërkuesit mbrojtje praktike dhe efektive, detyrim pozitiv ky i shtetit sanksionuar në nenin 8.²¹

22 vendime janë dhënë në lidhje me nenin 13, të gjitha në lidhje me nenin 6 dhe/ose të nenit 1 të Protokollit nr.1. Një vendim është dhënë në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7, e drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë. Gjykata konstatoi shkelje për shkak të përsëritjes së proceseve penale, që kanë përfunduar me një vendim të formës së prerë, i cili ka marrë fuqi si vendim i formës së prerë.²²

Janë dhënë 15 vendime në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Disa prej tyre kanë përfshirë probleme të mosekzekutimit të vendimeve të brendshme, si dhe një shpërblim i përfituar me vendim gjykate mund të konsiderohet pronë për qëllime të Konventës (shih p.sh., *Manushaqe Puto dhe të Tjerët* përmendur më lart tek neni 6).

18 *Alimuçaj k. Shqipërisë*, vendim i 7 shkurtit 2012.

19 *Qama k. Shqipërisë dhe Italisë*, vendim i 8 janarit 2013; *Bajrami k. Shqipërisë*, vendim i 12 dhjetorit 2006.

20 *Bajrami k. Shqipërisë*, vendim i 12 dhjetorit 2006.

21 *Qama k. Shqipërisë dhe Italisë*, vendim i 8 janarit 2013.

22 *Xheraj k. Shqipërisë*, vendim i 29 korrikut 2008.

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Hyrje

Bosnja dhe Hercegovina (tani e tutje: “BiH”) ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat Themelore (tani e tutje: “Konventa ose KEDNJ”) më 12 korrik të 2002, dhe që prej kësaj date është anëtare e Konventës dhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje: GJEDNJ).

Që prej ratifikimit të Konventës nga Shteti dhe deri më 31 dhjetor 2017, Gjykata ka dhënë 56 vendime dhe 87 vendime për pranueshmëri në lidhje me BiH.

Nga numri i total i vendimeve kundër BiH, katër janë dhënë nga Dhoma e Madhe. Këto raste kanë të bëjnë me të drejtat në lidhje me nenin 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12, sipas nenit 7, nenit 10 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Numri më i madh i vendimeve të dhëna janë në lidhje me të drejtat e pronës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe të drejtës për një proces të rregullt sipas nenit 6 për shkak të dështimit të autoriteteve shtetërore për të zbatuar vendimet e gjykatave vendase. Deri më 31 dhjetor 2017, Gjykata ka dhënë 24 vendime në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata gjithashtu ka dhënë 32 vendime në lidhje me nenin 6, nga të cilat në 30 raste janë konstatuar shkelje. Megjithëse numri total i rasteve të gjykuara nga Gjykata nuk është shumë i madh në krahasim me vendet e tjera të rajonit, duhet theksuar se Gjykata ka trajtuar probleme sistematike dhe të rëndësishme, si për shembull kthimi i kursimeve në monedhë të huaj ose riposedimi i banesave të paraluftës.

Në vendimin e parë kundër BiH²³ është trajtuar problemi i mos ekzekutimit të vendimit përfundimtar të gjykatës vendase që i jep kërkuesit të drejtën për zhblokimin e kursimeve të “monedhave të huaja” të depozituara në një bankë tregtare vendase sipas nenit 6. Më tej, në rastin *Colić dhe të Tjerët*, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe të nenit 6 për shkak të moszbatimit të vendimeve përfundimtare të gjykatës vendase që u jepnin kompensim kërkuesve në lidhje me “dëmet e luftes”.²⁴ Ky rast ka të bëjë me pezullimin ligjor të ekzekutimit të një kategorie të tërë të vendimesh përfundimtare për shkak të borxhit të madh publik që rrjedh si pasojë e vendimeve. Praktika gjyqësore e Gjykatës u pasua nga një sërë vendimesh, të cilat theksonin se vonesat në ekzekutimin e vendimeve ishin të paarsyeshme dhe si rrjedhojë është shkëlur neni 6.²⁵

Në lidhje me problemin e depozitave të “monedhave të huaja” të përmendura më lart, u konstatua gjithashtu shkelje e nenit 1 të Protokollit nr. 1, në vendimin e parë pilot në lidhje me BiH në çështjen *Suljagić k. BiH*.²⁶ Një tjetër çështje, që lidhet me kursimet në monedhë të huaj, është *Ališić dhe të Tjerët*

23 *Jeličić k. BiH*, vendim i 10 tetorit 2006.

24 *Čolić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 10 nëntorit 2009.

25 *Runić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 15 nëntorit 2011.

26 Megjithëse të dy vendimet kanë të bëjnë me pamundësinë e kërkuesve për të tërhequr kursimet “e vjetra” në valutë të huaj, dallimi kryesor i çështjes *Suljagić k. BiH* dhe *Jeličić k. BiH* qëndron në faktin se kërkuesi Jeličić ka marrë një vendim të formës së prerë nga autoritetet vendore ndërsa kërkuesi *Suljagić* nuk ka marrë një gjykim të tillë, por ka k.shtuar ligjshmërinë e legjislacionit të brendshëm që parashikon skemën e përgjithshme të shlyerjes për kursimet në valutë me anë të obligacioneve qeveritare.

k. BiH, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Maqedonisë.²⁷ Përsëri, u zbatua procedura e vendimit pilot. Ky rast ka të bëjë me pamundësinë e kërkueseve për të tërhequr kursimet e «vjetra» nga llogaritë e tyre bankare që prej shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe lidhur me shkeljen e të drejtës për mjete ligjore efektive dhe të drejtës për gëzim paqësor të pronës.

Një problem tjetër ka ardhur si pasojë e riposedimit të banesave ushtarake, siç është rasti *Dokić k. BiH*.²⁸ Ky rast ka të bëjë me pamundësinë e kërkuesit për të riposeduar banesën e tij ushtarake, pronësinë e së cilës e kishte fituar para luftës në Sarajevë, dhe për t'u regjistruar si pronar i saj, pavarësisht ekzistencës së një kontrate të ligjshme blerje. Në këtë rast është shkelur neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës.

Në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë sipas nenit 6, Gjykata në vendimin *Averdi dhe të Tjerët* konstatoi se nuk kishte “përcaktim” real të të drejtave dhe detyrimeve civile para Gjykatës Kushtetuese në BiH dhe si rrjedhojë e drejta për të aksesuar gjykatën mbetet e pazbatueshme në praktikë.²⁹ *Përsa i përket aksesit në gjykatë, në çështjen Lončar k. BiH*³⁰ Gjykata vendosi se kufizimi i aksesit në gjykatë ndaj kërkuesit ishte proporcional.

Vetëm në një çështje e cila shqyrtonte nenin 2 nuk është konstatuar shkelje. Në çështjen *Palić k. BiH*³¹, Gjykata shqyrtoi për herë të parë nëse BiH përmbush detyrimet e saj procedurale për të kryer një hetim penal efektiv dhe të pavarur pas zhdukjes së personave gjatë luftës. Gjithashtu sipas Gjykatës reagimet e autoriteteve nuk mund të kategorizoheshin si trajtim çnjerëzor ose poshtërues në kuptim të nenit 3 të Konventës. Në lidhje me mospërputhshmërinë e autoriteteve shtetërore me detyrimin pozitiv për të hetuar fatin e personave të zhdukur gjatë luftës në BiH në periudhën 1992-1995, Gjykata ka dhënë një numër vendimesh.³²

Në lidhje me nenin 3 të Konventës, Gjykata ka dhënë katër vendime për shkeljet e pretenduara të të drejtave të azilkërkuesve. Në njërin prej tyre, Gjykata konstatoi se do të kishte patur shkelje të nenit 3 të Konventës në rast dëbimi në Siri.³³ Megjithatë, lidhur me vendet e tjera të origjinës së kërkuesve, si Iraku dhe Tunizia, Gjykata vlerësoi se nuk ekziston një rrezik real që kërkuesit, në rast deportimi, do t'i nënshtroheshin keqtrajtimit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.³⁴ Në një rast tjetër, Gjykata konstatoi se integriteti fizik i kërkuesve pas mbërritjes së tyre në burg ishte siguruar në mënyrë të përshatshme vetëm pasi ishin strehuar në njësinë e spitalit të burgut, dhe konkludoi se vuajtjet e pësuar nga kërkuesi ishin përtej pragut të ashpërsisë të parashikuar nga neni 3.³⁵

27 *Ališić dhe të Tjerët k. BiH dhe të Tjerët*, vendim i Dhomës së Madhe i 16 korrikut 2014 (vendim i Dhomës i 6 nëntorit 2012).

28 *Dokić k. BiH*, vendim i 27 majit 2010.

29 *Avdić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 19 nëntorit 2013.

30 *Lončar k. BiH*, vendim i 25 shkurtit 2014.

31 *Palić k. BiH*, vendim i 15 shkurtit 2011.

32 *Mujkanović dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 3 qershorit 2014; *Fazlić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 3 qershorit 2014; *Šeremet*, vendim i 8 korrikut 2014; *Hamidović k. BiH*, vendim i 2 shkurtit 2014; *Žerajić dhe Gojković k. BiH*, vendim i 13 nëntorit 2014.

33 *Al Husin k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012.

34 *Al Hanchi k. BiH*, vendim i 15 nëntorit 2011; *Al Hamdani k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012.

35 *Rodić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 27 majit 2008.

Në lidhje me nenin 5, Gjykata ka dhënë disa vendime për sigurinë e të pandehurve me sëmundje të shëndeti mendor³⁶ dhe ndalimin e azilkërkuesve në BiH. Në rastet e azilkërkuesve³⁷, bazuar në jurisprudencën e saj, Gjykata përsëriti se paraburgimi për arsye sigurise nuk është legjitim në kuptim të nenit 5 § 1 të Konventës.

Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 7, sipas të cilit askush nuk mund të shpallet fajtor për shkak të një veprimi që nuk përbënte një vepër penale sipas ligjit kombëtar ose ndërkombëtar në kohën kur ishte kryer.³⁸ Gjykata, rrjedhimisht, konstatoi që kërkuesve nuk u ishin ofruar masa mbrojtëse efektive kundër vendosjes së një dënimi më të rëndë, gjë që përbën shkelje sipas Konventës. Në rastin *Šimšić k. BiH*³⁹ kërkuesi pretendoi shkelje në bazë të nenit 7 të Konventës, pasi ishte shpallur fajtor për krimet kundër njerëzimit edhe pse vepra penale e konsumuar nuk përbënte një vepër penale sipas ligjit kombëtar gjatë luftës së viteve 1992-95. Gjykata vuri në dukje se edhe pse aktet e kundërshtuara nuk përbënin krim kundër njerëzimit sipas ligjit të brendshëm, ato përbënin krim kundër njerëzimit sipas ligjit ndërkombëtar.

Në lidhje me nenin 8, është marrë vetëm një vendim i cili ka të bëjë me të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private dhe familjare.⁴⁰ Në këtë rast, Gjykata shqyrtoi detyrimin pozitiv për të lehtësuar bashkimin midis prindërve dhe fëmijëve dhe theksoi se efektshmëria e një mase duhet të vlerësohet përmes shpejtësisë së zbatimit të saj pasi kalimi i kohës mund të sjellë pasoja të pariparueshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve dhe prindërve.

Në lidhje me nenin 14 janë dhënë pesë vendime dhe në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 12 janë dhënë katër vendime. Këto vendime kanë të bëjnë me dispozita kushtetuese diskriminuese për gëzimin e të drejtave zgjedhore. Vendimi i parë ndaj BiH që trajton diskriminimin e pretenduar ishte *Sejdić dhe Finci k. BiH*,⁴¹ në të cilin Gjykata për herë të parë zbatoi nenin 1 të Protokollit nr. 12 lidhur me pretendimin se kërkuesit nuk mund të kandidonin për t'u zgjedhur President për shkak se ata nuk ishin anëtarë të “njerëzve që mund të zgjidhen” në BiH. U konstatua se kërkuesit ishin diskriminuar për shkak të origjinës së tyre hebraike dhe rome.

Gjykata konstatoi se mos plotësimi i kriterëve të kërkuesve për të kandiduar për president nuk kishin një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dhe për këtë arsye shkelej neni 14 i marrë së bashku me nenin 3 të Protokollit nr. 1. Dispozitat kushtetuese të cilat i bënin kërkuesit të papërshtatshëm për të kandiduar për president të BiH u konsideruan diskriminuese dhe në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 12. Pas gjykimit *Sejdić dhe Finci*, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme zbatoi praktikën e saj në disa vendime pasuese⁴². Për më tepër, në vendimin *Šekerović dhe Pašalić k. BiH*⁴³, Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit nr. 1 për shkak të diskriminimit të kërkuesve të cilët ishin “persona të zhvendosur brenda vendit”.

36 *Tokić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 8 korrikut 2008.

37 *Al Hamdani k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012; *Al Husin k. BiH*, vendim i 7 shkurtit 2012.

38 *Maktouf dhe Damjanović k. BiH*, vendim i 18 korrik 2013.

39 *Šimšić k. BiH*, vendim i 10 prillit 2012.

40 *Šobota-Gajić k. BiH*, vendim i 6 nëntorit 2007.

41 *Sejdić dhe Finci k. BiH*, vendim i 22 dhjetorit 2009.

42 *Zornić k. BiH*, vendim i 15 korrikut 2014, *Pilav k. BiH*, vendim i 9 qershorit 2016, *Šlaku k. BiH*, vendim i 26 majit 2016.

43 *Šekerović dhe Pašalić k. BiH*, vendim i 8 marsit 2011.

Në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 7, Gjykata ka shqyrtuar vetëm një kërkesë.⁴⁴ U konstatua se pavarësisht nga klasifikimi i ndryshëm i dy shkeljeve sipas ligjit të brendshëm, kërkuesi ishte gjykuar dhe dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale dhe për të njëjtën kundërvajtje penale, në kundërshtim të parimit *ne bis in idem*.

Vendime të 2017

Nga janari deri më dhjetor 2017, Gjykata ka dhënë njëmbëdhjetë vendime dhe pesë vendime për pranueshmëri. Një vendim është dhënë prej Dhomës së Madhe, pesë nga Dhoma dhe pesë nga një Komitet prej tre gjyqtarësh. Gjykata trajtoi rastet sipas nenit 10, nenit 9, nenit 5 dhe nenit 6 të Konventës. Gjithashtu, vijohen të trajtohen çështje që lidhen me nenin 6.

Ky seksion do të shqyrtojë vendimet në lidhje me BiH në vitin 2017 dhe do të ofrojë përmbledhje të shkurtra të fakteve dhe vendimeve të Gjykatës.

Vendime

Neni 10 - liria e shprehjes

Dhoma e Madhe nuk konstatoi shkelje në çështjen *Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe Tjerët k. BiH*⁴⁵. Kërkuesi, një bashkësi fetare myslime dhe tre Organizata Jo-Fitimprurëse (OJF) etnike boshnjake në Qarkun e Bërçkos në BiH, i dërguan një letër autoriteteve më të larta të qarkut, duke shprehur shqetësimet e tyre rreth procedurës së emërimit të drejtorit të radios multi-etnike dhe duke pretenduar se një kandidat për drejtor, i cili ishte njëkohësisht edhe redaktori i radios, kishte kryer veprime që nuk respektonin muslimanët dhe boshnjakët etnikë. Më pas, letra u botua në tre gazeta të përditshme. Personi i akuzuar hapi proces civil për shpifje kundër kërkuësve dhe urdhëroi tërheqjen e letrës. Gjykata theksoi se vendimet e gjykatave të brendshme përbënin ndërhyrje në lirinë e shprehjes së kërkuësve dhe se kjo ndërhyrje ishte përcaktuar me ligj dhe kishte një qëllim legjitim, përkatësisht mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve. Gjykata më tej shqyrtoi nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, Gjykata konstatoi se akuzat kishin një nivel të lartë rëndësie sipas nenit 8 dhe mund të rrezikonin të drejtat e kandidatit. Prandaj, Gjykata duhej të verifikonte nëse autoritetet vendase kishin mbajtur një ekuilibër të drejtë midis dy të drejtave të garantuara nga njëra anë, liria e shprehjes së kërkuësit e mbrojtur nga neni 10 dhe, nga ana tjetër, e drejta e redaktorit për respektimin e reputacionit të tij sipas nenit 8. Gjykata mbajti të njëjtin qëndrim me autoritet vendase. Përgjegjësia për shpifje duhet të vlerësohet vetëm në lidhje me korrespondencën e tyre private me autoritetet lokale dhe jo me publikimin e letrës në media, pasi nuk ishte vërtetuar se ata ishin përgjegjës për botimin e saj. Gjykata përsëriti se kur një OJF tërheq vëmendjen për çështjeve me interes publik, po ushtronte një rol me rëndësi të ngjashme me atë të shtypit. Gjithashtu, u vu në dukje që në balancimin e interesave të përfshira, ishte e përshtatshme të merren parasysh kriteret që përgjithësisht aplikohen për shpërndarjen e deklaratave shpifëse nga media në ushtrimin e funksionit publik të mbikëqyrjes. Një faktor tjetër i rëndësishëm ishte nëse publikimi i deklaratave të kundërshtuara kishte patur si qëllim të akuzojë redaktorin ose të njoftojë zyrtarët shtetërorë kompetent për sjelljen e paligjshme. Kërkuësit pohuan se qëllimi i tyre ishte të informonin autoritetet kompetente për

44 *Muslija k. BiH*, vendim i 14 janarit 2014.

45 *Medžlis Islamske zajednice Brčko dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i Dhomës së Madhe i 17 qershorit 2017.

disa parregullsi dhe t'i nxitnin ata që të hetonin dhe verifikonin pretendimet e bëra në letër. Megjithatë, Gjykata deklaroi se letra e kundërshtuar nuk përmbante ndonjë kërkesë për hetimin dhe verifikimin e pretendimeve të tyre.

Gjykata konstatoi se ndonëse akuzat iu dorëzuan një numri të kufizuar të zyrtarëve shtetërorë me anë të korrespondencës private, kjo nuk eliminoi efektin e tyre potencialisht të dëmshëm për karrierën e redaktorit si nëpunës civil dhe reputacionin e tij profesional si gazetar. Pa marrë parasysh sesi letra u bë publike në media, u konkludua se publikimi i saj hapi një mundësi për debat publik dhe përkeqësoi dinjitetin dhe reputacionin e tij.

Gjithashtu, Gjykata mbajti të njëjtin qëndrim me gjykatat e brendshme në lidhje me faktin që kërkuesit nuk kishin kontrolluar vërtetësinë e deklaratave të tyre që ata dinin ose duhej ta dinin në goftë se ishin të rreme dhe në lidhje me këtë konkluduan se kërkuesit nuk kishin një bazë faktike të mjaftueshme për akuzat e tyre rreth redaktorit. Ndërhyrja e diskutuar ishte mbështetur nga fakte të mjaftueshme dhe relevante dhe autoritetet e shtetit të paditur kishin arritur një balancë të drejtë midis interesave të kërkuesve për lirisë së shprehjes nga njëra anë dhe interesit të redaktorit për mbrojtjen e reputacionit të tij nga ana tjetër, duke vepruar kështu brenda hapësirës së tyre të vlerësimit.

Neni 9, Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

*Çështja Hamidović k. BiH*⁴⁶ kishte të bënte me refuzimin e kërkuesit për heqjen e kapeles fetare të tij gjatë paraqitjes së provave para gjykatës penale, e cila po shqyrtonte një rast lidhur me sulmin ndaj Ambasadës Amerikane në Sarajevë në vitin 2011. Në shtator 2012, z. Hamidović, i cili i përkiste grupit vehabi/selefi në BiH, u thirr si dëshmitar. Kryetari i kolegjit i kërkoi atij të hiqte kapelen pasi ishte në kundërshtim me kodin e veshjes së institucioneve gjyqësore dhe se simbolet ose veshjet fetare nuk lejoheshin në gjykatë. Megjithatë, z. Hamidović refuzoi, duke pretenduar se nuk mund ta hiqte kapelen për shkak se ajo ishte një simbol i fesë së tij. Gjyqtari e dëboi nga salla e gjyqit, dhe e dënoi për shkelje të rregullave të gjykatës me gjobë, e cila më pas u zëvendësua në 30 ditë burg, pasi z. Hamidović nuk kishte paguar gjobën. Kërkuesi zbatoi dënimin.

Në lidhje me nenet 9 (*liria e fesë*) dhe 14 (*ndalimi i diskriminimit*) të GJEDNJ, z. Hamidović pretendoi se dënimi i tij për shkelje të rregullave të gjykatës ishte joproporcional dhe se ndërhyrja nuk ishte e ligjshme, pasi asnjë dispozitë ligjore nuk e ndalonte shprehimisht veshjen e kapeles fetare në sallën e gjyqit.

Gjykata theksoi se dënimi i dhënë ndaj kërkuesit për të mbajtur kapele në një sallë gjyqi përbënte një kufizim të manifestimit të fesë së tij, i cili ishte gjithashtu në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata mbështeti mendimin e Gjykatës Kushtetuese se ndërhyrja ishte e ligjshme dhe se kishte një bazë ligjore për kufizimin e mbajtjes së kapeles në sallën e gjyqit. Kërkuesi kishte argumentuar se ndërhyrja në ushtrimin e lirisë së tij për të manifestuar fenë e tij nuk përputhej me asnjë nga qëllimet e renditura në nenin 9 § 2. Gjykata u shpreh se laicizmi është i mbrojtur nga neni 9 dhe se qëllimi për të mbështetur vlerat laike dhe demokratike mund të lidhen me qëllimin legjitim të “mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve” në kuptim të nenit 9 § 2. Detyra e Gjykatës ishte të përcaktojë nëse masat e marra në nivel kombëtar ishin parimisht të justifikuara dhe proporcionale.

46 *Hamidović k. BiH*, vendim i 5 dhjetorit 2017.

Gjykata nuk dyshoi se akti i kërkuetit ishte frymëzuar nga besimi i sigurtë fetar, dhe pa asnjë qëllim për të nëpërkëmbur gjykatën. Pluralizmi, toleranca dhe liberalizmi janë shenjë dalluese e një “shoqërie demokratike”. Edhe pse interesat individuale duhet të jenë në varësi të atyre të shumicës, demokracia nuk do të thotë thjesht që pikëpamjet e shumicës duhet të mbizotërojnë gjithnjë. Roli i autoriteteve nuk është të heqë shkaqet e tensionit duke eliminuar pluralizmin, por të sigurojë që grupet konkurruese të tolerojnë njëri-tjetrin. Më tej, Gjykata theksoi se nuk kishte asnjë indikacion se kërkueti nuk ishte i gatshëm të dëshmonte ose se kishte një qëndrim jo besnik. Në këto rrethana, dënimi i tij për mospërfillje të gjykatës për shkak të refuzimit të tij për heqjen e kapeles nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe u konstatua shkelje e nenit 9. Gjykata nuk e shqyrtoi çështjen sipas nenit 14.

Neni 5, e drejta për liri dhe siguri

Në çështjen *Čović k. BiH*⁴⁷, kërkueti pretendoi se refuzimi i kërkesës së tij kushtetuese për shkak të dështimit të Gjykatës Kushtetuese për të arritur shumicën i kishte mohuar atij të drejtën për një proces efektiv. Si rrjedhojë, paraburgimi i tij nuk ishte i ligjshëm siç parashikohet nga neni 5 § 4 is Konventës.

Gjykata theksoi se qëllimi i nenit 5 § 4 është t’i sigurojë personave të arrestuar dhe të paraburgosur të drejtën për mbikëqyrjen gjyqësore të ligjshmërisë së masës të cilës i janë nënshtruar. Gjykata vuri në dukje se ka trajtuar dhe më parë një çështje të ngjashme kundër BiH (*Avdić dhe të Tjerët*)⁴⁸. Gjykata Kushtetuese mori një vendim formal mbi pretendimin e kërkuetit, por në fakt refuzoi të vendoste për pranueshmërinë dhe/ose thelbin e saj. Arsyeja e vetme për të cilën ishte hedhur poshtë kërkesa e kërkuetit ishte dështimi i gjykatës për të arritur shumicën për të marrë vendimin. Prandaj, Gjykata u shpreh se çështja e kushtetutshmërisë së paraburgimit të kërkuetit mbetet e pazgjidhur. Ajo përsëriti se duke hedhur poshtë ankesën e kërkuetit thjesht për shkak se nuk ishte në gjendje të arrinte një shumicë në ndonjë nga propozimet në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese nuk arriti t’i japë kërkuetit mundësinë reale të përdorimit të mjetit juridik dhe si rrjedhojë kishte pasur shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës.

Neni 6, e drejta për një proces të rregullt

Çështja *Panorama Ltd dhe Miličić k. BiH*⁴⁹, kanë të bëjnë me mos ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të brendshme në favor të kërkuetesve në lidhje me pretendimet pronësore nga lufta 1992-1995.

Të dy kërkuetit fituan çështjen kundër Shtetit, njëri për konfiskimin dhe një tjetri për shkatërrimin e pronës. Vendimet në favor të tyre u bënë përfundimtare respektivisht në janar 2009 dhe nëntor 2007. Në kohën kur kërkesat e kërkuetesve u shqyrtuan në bazë të ligjit të brendshëm, interesi i vonuar nuk zbatohet për dëmet e luftës. Megjithatë, gjykatat civile zbatuan rregullat e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve dhe u dhanë interesave të parakohshme kërkuetesve. Shpërblimi kryesor dhe tarifat ligjore u janë paguar të dy kërkuetesve, por Ministria Federale e Financave refuzoi të autorizonte pagesën e interesit dhe vendimet përfundimtare në favor të tyre në këtë drejtim nuk u zbatuan. Kërkuetit u mbështetën në nenin 6 § 1 (*e drejta për një proces të rregullt gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 (*mbrojtja e pronës*).

47 *Čović k. BiH*, vendim i 3 tetorit 2017.

48 *Adović dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 19 nëntorit 2013

49 *Panorama Ltd dhe Miličić k. BiH*, vendim i datës 25 korrik 2017.

Gjykata më tej, vuri në dukje se kërkuesi i dytë ishte udhëzuar nga përmbartuesi për të ngritur një padi civile për dëmet ndaj bankës sipas rregullave të zakonshme të së drejtës së detyrimeve për dësh-timin e tij për të zbatuar plotësisht vendimin në favor të tij. Në lidhje me këtë, Gjykata përsëriti se kër-esa e kërkuesit për të ndjekur një sërë procesesh civile, pasi ai tashmë ka marrë një gjykim të formës së prerë në favor të tij, do t'i ngarkonte një barrë të tepruar. Nga vendimet përkatëse vendase kishin kalur me shume se dhjetë vjet dhe Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1.

Në çështjen *Kahriman*⁵⁰, kërkuesi pretendoi një kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit sipas nenit 6 § 1. Edhe pse Qeveria vendosi se kërkuesi nuk mund të pretendonte më se ishte “viktimë” për shkak se Gjykata Kushtetuese kishte pranuar shkeljen e supozuar, Gjykata përsëriti se një vendim ose masë e favorshme për kërkuesin nuk është në parim e mjaftueshme për ta privuar atë nga statusi i tij si “vik-timë” përveç nëse autoritetet kombëtare kanë pranuar shkeljen dhe kanë dhënë dëmshpërblim për të. Në momentin që kërkuesi pretendoi kompensim për shkelje të “kohës të arsyeshme” dhe Gjykata Kushtetuese nuk dha asnjë shpërblim të drejtë, paditësi ende mund të pretendonte të ishte “viktimë”. Gjykata vërtetoi se procesi civil zgjati përafërsisht nëntë vjet për tre nivelet e juridiksionit dhe konstatoi se kohëzgjatja e procedurave ishte e tepruar dhe nuk arriti të përmbushë kërkesat e “afatit të arsye-shëm” në kundërshtim me nenin 6 § 1.

Në rastin *Damjanović dhe Euromag d.o.o.*⁵¹ Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me kërkuesin e dytë. Kërkuesit pretenduan se kohëzgjatja e proceseve administrative nuk ishte në për-puthje me “afatin e arsyeshëm”. Në përcaktimin e kompetencave *ratione personae*, Gjykata theksoi se mosmarrja parasysh e personalitetit juridik të një kompanie justifikohet vetëm në rrethana të jashtëza-konshme, veçanërisht kur vërtetohet qartë se është e pamundur që një kompani të bëjë kërkesë në Gjykatë përmes organeve të themeluara sipas neneve të statutit të saj ose - në rast të likuidimit - përmes likuiduesve të tij. Në rastin në fjalë, kërkuesi i dytë i'u drejtua në Gjykatës përmes drejtorit të saj, kërkuesi i parë, ndonëse një nga themeluesit e kompanisë, nuk ishte palë në procedurën e brendshme. Rrjedhimisht, kërkuesi i parë nuk mund të pretendonte të ishte një “Viktimë”, sipas kuptimit të nenit 34 të Konventës.

Vendimet *Kunić dhe të Tjerët*⁵² dhe *Spahić dhe të Tjerët k. BiH*⁵³ janë më të fundit që Gjykata ka dhënë në lidhje me kërkesat për pamundësinë për akses në gjykata për shkak të dështimit për të zbatuar vendimet. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të BiH, të cilat kishin konstatuar se kishte pasur shkel-je të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të detyrueshme ligjërisht dhe mosveprimit nga ana e qeverive lokale kompetente për të ndërmarrë hapat e urdhëruara nga ato vendime për të siguruar pagesën e borxhit të qeverisë lokale, nuk ishin respektuar brenda një kohe të arsyeshme. Duke mos arritur për një periudhë të konsiderueshme kohore të marrë masat e nevojshme për t'ju përmbajtur vendimeve të formës së prerë në rastin në fjalë, autoritetet dështuan në zbatimin e dispozitave të nenit 6 § 1, dhe gjithashtu i penguan kërkuesit të marrin paratë që u takonin. Ky dështim përbënte një ndërhyrje joproporcionale në gëzimin paqësor të pasurisë.

50 *Kahriman k. BiH*, vendim i 17 tetorit 2017.

51 *Damjanović dhe Euromag doo v. BiH*, vendim i 31 tetorit 2017.

52 *Kunić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 14 nëntorit 2017.

53 *Spahić dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 14 dhjetorit 2017.

Në *Dorić k. BiH*⁵⁴, *Prazina*⁵⁵ dhe *Mandić and Popović*⁵⁶, Gjykata konsideroi se kohëzgjatja e proceseve, ose ekzekutimi i vonuar i vendimeve të detyrueshme të brendshme, ishte i pajustificuar dhe nuk arrin të përmbushë kërkesën e “afatit të arsyeshëm” duke shkelur nenin 6 § 1.

Vendimet

Në çështjen *Stevančević*⁵⁷, kërkuesi u ankua për pamundësinë për të rifituar posedimin e banesës së tij të paraluftës, ndërsa më shumë se dy vjet para se të paraqiste kërkesën, ai kishte marrë kompensim për atë banesë. Gjykata në bazë të rrethanave të çështjes, vuri në dukje se kompensimi i paguar për kërkeusin ishte i përshtatshëm në raport me humbjet financiare që kërkuesi kishte pësuar. Nën dritën e këtij konstatimi, Gjykata vlerësoi se kjo kërkesë përbënte një abuzim me të drejtën e kërkesës individuale dhe prandaj u refuzua.

Në çështjen *Vidović*⁵⁸, kërkuesi pretendoi se e drejta për t’u dëgjuar ishte shkelur si pasojë e sekuestrit të kompjuterit të saj dhe se pamundësia e saj për të vepruar si mbrojtës për B.S. dhe F.R. ka shkelur të drejtën t’u mbrojtur vetë sipas sipas Nenit 6 § 3 (c) të Konventës. Për sa i përket aplikueshmërisë së nenit 6, Gjykata vuri në dukje se procedimet penale të kontestuara ishin iniciuar kundër B.S. dhe F.R. Kërkuesi veproi si avokat mbrojtës deri në një vendim të gjykatës vendase. Kompjuteri i përdorur nga hetuesi i kërkuetit u konfiskua gjithashtu si pjesë e masave që synonin marrjen e provave kundër B.S. dhe F.R., por Gjykata deklaroi se proceset e ankimuara nuk kishin të bënin me “përcaktimin e një akuze penale” kundër kërkuetit. Kështu që kjo ankesë ishte *ratione materiae* e papajtueshme me dispozitat e Konventës.

Në çështjen *Knežević dhe të Tjerët*⁵⁹, Gjykata miratoi një vendim për të hequr çështjen nga lista e çështjeve për shqyrtim pasi kërkesa kishte në thelb një çështje të zgjidhur Konventës kështu që nuk ishte i nevojshëm shqyrtim i mëtejshëm i çështjes.

Rasti *Šahman k. BiH*⁶⁰, kishte të bënte me një pretendim sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës se ajo nuk është lejuar të përfaqësohet nga një avokat i zgjedhur prej saj në procesin penal kundër saj duke cenuar të drejtat e mbrojtjes dhe minuar drejtësinë e procesit në tërësi. Pasi, Gjykata konstatoi se proceset penale kundër paditësit ishin ende në shqyrtim nga gjykata vendase në shkallën e parë, u konkludua se kërkesa ishte e parakohshme.

54 *Dorić k. BiH*, vendim i 7 nëntorit 2017.

55 *Prazina k. BiH*, vendim i 5 dhjetorit 2017.

56 *Mandić dhe Popović k. BiH*, vendim i 19 dhjetorit 2017.

57 *Stevančević v. BiH*, vendim i 10 janarit 2017.

58 *Vidović k. BiH*, vendim i 10 i janarit 2017.

59 *Knežević dhe të Tjerët k. BiH*, vendim i 14 marsit 2017.

60 *Šahman k. BiH*, vendim i 25 prillit 2017.

KROACIA

Hyrje

Republika e Kroacisë firmosi dhe ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventën) më 5 Nëntor 1997.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('GJEDNJ' ose 'Gjykata') deri tani ka dhënë 377 vendime në lidhje me Kroacinë, duke konstatuar shkelje të Konvente në 301 prej tyre. Në njëzet vitet e fundit, 26 çështje janë zgjidhur me pajtim.

Gjashtë prej 377 vendimeve të dhëna kundër Kroacisë janë marrë nga Dhoma e Madhe. *Blečić k. Kroacisë*⁶¹ ishte çështja e parë kroate e shqyrtuar nga Dhoma e Madhe. *Marguš k. Kroacisë*⁶², edhe ky vendim i marrë nga Dhoma e Madhe, në të cilin Gjykata ka trajtuar zbatimin e parimit *ne bis in idem* për krime lufte ose për shkelje të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare dhe humanitare. Vendimi i fundit i Dhomës së Madhe në rastin *Mursić k. Kroacisë*⁶³ përmbledh dhe riafirmon standardet e Gjykatës lidhur me kushtet e burgimit dhe ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor sipas nenit 3 të Konventës.

Nga tërësia e vendimeve të Gjykatës kundër Kroacisë, shumica e tyre kanë të bëjnë me nenin 6 të Konventës (e drejta për një proces të rregullt ligjor). Nga 199 vendime të dhëna në lidhje me nenin 6, 99 prej tyre kanë të bëjnë ekskluzivisht me të drejtën e dëgjimit brenda një kohe të arsyeshme, pjesë e së drejtës për gjykim të drejtë të parashikuar në nenin 6 të Konventës. 100 rastet e tjera kanë të bëjnë me të drejta të tjera sipas nenit 6 të Konventës, si për shembull e drejta për gjykim të drejtë, barazia e armëve, prezumimi i pafajësisë ose të drejtat e mbrojtjes në procedurën penale. Vendimet më të rëndësishme në lidhje me nenin 6 përfshijnë vendimin e Dhomës së Madhe në rastin e *Dvorski k. Kroacisë* (e drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur nga një avokat i zgjedhur prej tij)⁶⁴, si dhe vendimet e Dhomës në rastet e *Ajdarić k. Kroacisë* (vlerësimi i provave dhe arsyetimi i pamjaftueshëm në dënimin penal)⁶⁵ *Šikić k. Kroacisë* (përkufizimi dhe zbatimi i aspektit civil të nenit 6 të Konventës)⁶⁶, *Klauz k. Kroacisë* (e drejta për gjykim të drejtë dhe shpenzimet e procedurës civile).⁶⁷

Vendimet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me vendimet e Gjykatës mbi të drejtën për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës. Gjykata ka dhënë 33 gjykime të tilla deri më sot dhe shumica e tyre kanë konsideruar mungesën e një mjeti efektiv juridik për ankim brenda një kohe të arsyeshme.

Gjykata ka dhënë 40 vendime kundër Kroacisë, në të cilat shqyrtohen të drejtat e parashikuara nga neni 8. Në këto vendime, Gjykata shqyrton të drejtën për jetë private dhe familjare, të drejtën për banesë, të drejtën për privatësi dhe korrespondencë. Vendimet më të rëndësishme në nenin 8 të Konventës në lidhje me Kroacinë përfshijnë; *Karadžić k. Kroacisë* (aspektet civile të rrëmbimit të fëmi-

61 *Blečić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 marsit 2006.

62 *Marguš k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 majit 2014.

63 *Mursić k. Kroacisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 Tetorit 2016.

64 *Dvorski v. Kroacisë*, vendim i 20 tetorit 2015.

65 *Ajdarić k. Kroacisë*, vendim i 13 dhjetorit 2011.

66 *Šikić k. Kroacisë*, vendim i 15 korrikut 2010.

67 *Klauz k. Kroacisë*, vendim i 18 korrikut 2013.

jëve)⁶⁸, *Gluhaković k. Kroacisë* (e drejta e prindit që nuk jeton me fëmijën për të patur kontakte me të)⁶⁹, *X k. Kroacisë* (përjashtimi i kërkuesit, të cili i është hequr nga zotësia e tij për të vepruar, nga procedurat e adoptimit të vajzës së saj)⁷⁰, *Ćosić k. Kroacisë* (e drejta për banesë)⁷¹, dhe *Dragojević k. Kroacisë* (shkelje e së drejtës për privatësi)⁷².

Gjykata ka dhënë 33 vendime kundër Kroacisë në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (e drejta për gëzimin paqësor të pasurisë). Përveç vendimit të lartpërmendur të Dhomës së Madhe në çështjen *Blečić k. Kroacisë*⁷³, vendimet më të rëndësishme të GJEDNJ-së mbi këtë të drejtë të Konventës përfshijnë ato në rastet e *Statileo k. Kroacisë*⁷⁴, *Vajagić k. Kroacisë*⁷⁵ (e drejta për kompensim për tokën e shpronësuar), *Radanović k. Kroacisë* (kthimi i pronës të marrë përkohësisht në gëzim dhe posedim).⁷⁶

Gjykata dha 28 vendime për të drejtën e lirisë dhe sigurisë të personit të parashikuar nga neni 5 i Konventës. Shumica e këtyre çështjeve trajtojnë heqjen e lirisë, veçanërisht urdhërimin dhe zgjatjen e paraburgimit.

Nga 12 vendime të Gjykatës, 10 prej tyre janë në lidhje me nenin 2 të Konventës (e drejta për jetë) dhe trajtojnë aspektin procedural të së drejtës për jetë, sidomos zbatimin e hetimeve efektive dhe krijimin e mekanizmave për mbrojtjen të drejtës për jetë në sistemin juridik të brendshëm. *Marta Jularić k. Kroacisë*⁷⁷ ishte gjykimi i parë i tillë. Vetëm dy vendime të Gjykatës kanë të bëjnë me aspektin substancial të së drejtës për jetë; i pari ishte rasti i *Branko Tomašić dhe të Tjerët k. Kroacisë*,⁷⁸ i cili trajtonte mbrojtjen nga dhuna në familje.

Vendime të vitit 2017

Në vitin 2017 Gjykata ka dhënë 28 vendime dhe 15 vendime papranueshmrie. Gjykata konstatoi shkelje të të paktën 1 neni të Konventës në 19 vendime të dhëna dhe asnjë shkelje në tetë nga këto vendime; në vendimin *Vijatović k. Kroacisë* në të cilën vendosi mbi shpërblimin e drejtë sipas nenit 41 të Konventës (në vendimin e vitit 2016, Gjykata konstatoi një shkelje të së drejtës për gëzimin paqësor të pronës sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1, por nuk vendosi për shpërblimin e drejtë për shkeljen).⁷⁹

Gjykata ka shqyrtuar gjithsej 502 kërkesa kundër Kroacisë në vitin 2017 dhe ka komunikuar 93 raste të reja me kundër Kroacisë.

Më poshtë është një përmbledhje e vendimeve të Gjykatës sipas neneve të Konventës.

68 *Karadžić k. Kroacisë*, vendim i 15 marsit 2006.

69 *Gluhaković k. Kroacisë*, vendim i 12 prillit 2011.

70 *X k. Kroacisë*, vendim i 17 korrikut 2008.

71 *Ćosić k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2009.

72 *Dragojević k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2015.

73 *Blečić k. Kroacisë*, vendim i 8 marsit 2006.

74 *Statileo k. Kroacisë*, vendim i 10 korrikut 2014.

75 *Vajagić k. Kroacisë*, vendim i 20 korrikut 2006.

76 *Radanović k. Kroacisë*, vendim i 21 dhjetorit 2006.

77 *Marta Jularić k. Kroacisë*, vendim i 20 janarit 2011.

78 *Branko Tomašić k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2009.

79 *Vijatović k. Kroacisë*, vendim i 21 dhjetorit 2017.

E drejta për jetën - Neni 2 i Konventës

Gjatë vitit 2017 Gjykata ka dhënë gjashtë vendime kundër Kroacisë mbi aspektin procedural të së drejtës për jetë sipas nenit 2 të Konventës; në pesë raste, ajo konstatoi se shteti ka respektuar procedurat e mbrojtjes sipas nenit 2 dhe ka kryer hetime efektive për vdekje të dyshimta; në një çështje tjetër (*M dhe të Tjerët kundër Kroacisë*),⁸⁰ Gjykata konstatoi se nuk ishte kryer hetim efektiv. Faktet e çështjes *M dhe të Tjerët* janë të lidhur ligjërisht me rastet e *Borojević k. Kroacisë* dhe *Trivkanović k. Kroacisë*⁸¹, në të cilën Gjykata nuk kishte gjetur shkelje të Konventës.

Çështjet *M dhe të Tjerët*, *Borojević dhe Trivkanović* janë pjesë e një procesi gjyqësor për krimet e luftës kundër ish-shefit të policisë V.M., i cili u dënua me 14 vjet burgi. Ndërsa në çështjen *Borojević dhe Trivkanović*⁸² kishte konstatuar se dënimi i një personi për shkak të përgjegjësisë së tij si komandant i plotësonte kërkesat e Nenit 2. Çështjen *M dhe të Tjerët*, Gjykata vendosi që shteti i paditur duhet të kishte kryer hetim jo vetëm ndaj personave që kishin që kishin funksione drejtuese, si edhe ndaj autorëve të veprave penale.

Rasti i *Molnar k. Kroacisë* vlen të veçohet për pranueshmërinë e kërkesave që pretendojnë shkelje të nenit 2.⁸³ Kërkuesi pretendoi për një hetim të mangët të rrethanave në të cilat kishte vdekur djali i tij polic. Djali i kërkuesit kishte paralajmëruar eprorët e tij për praktikën e paligjshme dhe korrupsionin e mundshëm në polici. Këto pretendime sollën procedura disiplinore kundër disa punonjësve të policisë. Më 21 janar 2013, djali i kërkuesit nuk u paraqit në punë dhe nuk përgjigjej në telefonin e tij celular. Pas kërkimeve të policisë, në të njëjtën ditë në orën 19:00 djali i kërkuesit u gjet i vdekur pranë një lumi në sediljen e mbrapme të makinës dhe me një godtje arme në ballë. Pas një hetimi të plotë autoritetet konstatuan se djali i kërkuesit kishte bërë vetëvrasje.

Pasi Prokuroria e Shtetit të Varaždin njoftoi kërkuesin për vendimin ky i fundit depozitoi një akuzë penale, duke argumentuar se djali i tij ishte vrasë. Pas akuzës së kërkuesit, Prokuroria e Qarkut Varaždin mori në pyetje personat që kishin lidhje me rastin, duke përfshirë ekspertin e balistikës të Qendrës Forensikës. Më 20 janar 2015, Zyra e Prokurorit të Qarkut Varaždin refuzoi akuzën penale të kërkuesit për arsye se ishte vërtetuar se djali i kërkuesit nuk ishte vrasë, por kishte kryer vetëvrasje. Vendimi i Zyrës së Prokurorit të Qarkut në Varaždin i'u dorëzua avokatit të kërkuesit më 22 janar 2015. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi kishte paraqitur kërkesën e tij në Gjykatë më shumë se një vit dhe katër muaj pas vendimit të prokurorisë së qarkut të Varaždit dhe ndërkohë i kishte dërguar një letër Gjykatës Supreme duke u ankuar për mënyrën në të cilën ishte kryer hetimi për rrethanat e vdekjes së djalit të tij. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, dërgimi i një letre ankuese pranë Gjykatës Supreme, nuk është mjeti i duhur për t'u shteruar dhe nuk mund të ndërpresë rrjedhën e afatit gjashtë mujor. Kështu, Gjykata pranoi kështu se ankesa ishte jashtë afatit 6-mujor dhe nuk duhej të merrej parasysh në përputhje me nenin 35 të Konventës.

⁸⁰ *M and Others k. Kroacisë*, vendim i 2 majit 2017.

⁸¹ *Borojević k. Kroacisë*, vendim i 4 prillit 2017.

⁸² *Trivkanović k. Kroacisë*, vendim i 6 korrikut 2017.

⁸³ *Molnar k. Kroacisë*, vendim i 12 shtatorit 2017.

Neni 3 i Konventës - Ndalimi i torturës dhe dënimit ose trajtimeve çnjerëzor

Gjykata ka dhënë tre vendime dhe ka dhënë një vendim mbi pranueshmërinë për nenin 3 në vitin 2017. Ajo nuk gjeti asnjë shkelje të nenit 3 në dy vendime dhe shkelje të këtij neni në lidhje me nenin 14 të Konventës (ndalimi i diskriminimit) në vendimin e tretë.

Vendimi i i fundit, *Škorjanec k. Kroacisë*, është një çështje e cila kërkon vëmendje. Më 9 qershor 2003, kërkuesja dhe partneri i saj Š.Š. (një rom etnik) kishin biseduar me dy të panjohur dhe më pas ishin sulmuar fizikisht prej tyre⁸⁴. Edhe pse kërkuesi nuk është një rom etnik, sulmuesit i drejtuan fytyrë raciste gjatë sulmit. Si rezultat i sulmit, kërkuesja kishte pësuar lëndime të lehta fizike (kontuzion). Ajo i'u drejtua Gjykatës me pretendimin se autoritetet vendase nuk kishin hetuar në mënyrë efektive krimin kundër saj sepse partneri i saj ishte rom.

Gjykata konstatoi se sistemi juridik kroat parashikon mekanizma të mjaftueshëm efektiv ligjorë për të siguruar një nivel adekuat mbrojtjeje në raste të tilla, sepse Kodi Penal përshkruante shprehimisht krimin e urrejtjes si një formë të rëndë të veprave penale.

Megjithatë, ajo vuri në dukje se autoritetet e ndjekjes penale e kufizuan hetimin dhe analizën e tyre në elementin e krimit të urrejtjes ndaj sulmit të dhunshëm ndaj Š.Š dhe nuk kishin bërë një vlerësim të plotë të faktorëve të tjerë relevantë dhe të lidhjes midis së kërkuesit me Š.Š. dhe motivin racist të sulmit ndaj tyre. Gjykata theksoi se kjo, së bashku me këmbënguljen e prokurorisë në faktin se vetë kërkuesi nuk ishte me origjinë rome dhe dështimi i tyre për të identifikuar nëse ajo ishte perceptuar nga sulmuesit si person me origjinë rome, rezultoi me një vlerësim jo të plotë të rrethanat e rastit. Gjykata gjeti gjithashtu një shkelje të nenit 14 të Konventës për shkak të mënyrës në të cilën autoritetet vendase kryen hetimin në lidhje me kërkesin.

Neni 5 i Konventës - E drejta për liri dhe siguri

Në vitin 2017, Gjykata dha dy vendime dhe një vendim pranueshmërie në lidhje me nenin 5 kundër Kroacisë. Në të dyja rastet Gjykata, konstatoi shkelje të së drejtës për liri dhe siguri për shkak të mënyrës në të cilën autoritetet vendase morën vendim për të zgjatur paraburgimin e kërkuesve.

Gjykata e shpalli të papranueshme kërkesën në çështjen *Grobenski k. Kroacisë*.⁸⁵ Ajo shqyrtoi disa aspekte të së drejtës për liri në këtë rast. Kërkuesi pretendoi se të drejtat e tij ishin shkelur nga paraburgimi i urdhëruar nga gjykata vendase, dhe se paraburgimi ishte bazuar në një rrëfim të tij të marrë në mënyrë të paligjshme. Ai gjithashtu u ankua se ai nuk ishte në gjendje të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij, në veçanti dëshmitë që shkaktuan dyshime të arsyeshme. Gjykata, së pari vuri në dukje se gjykata e brendshme kishte urdhëruar paraburgimin e kërkuesit në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se gjykatat e brendshme i ishin referuar materialit të marrë gjatë hetimit (duke përfshirë të dhënat nga hetimi i vendit të ngjarjes, dëshmitarët që identifikonin kërkuesin dhe deklaratat e dëshmitarëve në dispozicion) dhe kishte dhënë detaje specifike dhe mjaft të hollësisishme në shqyrtimin e bazave për paraburgimin e kërkuesit.

⁸⁴ *Škorjanec k. Kroacisë*, vendim i 28 marsit 2017.

⁸⁵ *Grobenski k. Kroacisë*, vendim i 12 shtatorit 2017.

Sa i përket pretendimit të kërkuarit se ai i kishte pranuar krimet në mungesë të avokatit të tij, Gjykata theksoi se jo domosdoshmërisht duhet të arrihet në përfundimin se kërkuarit i është shkelur e drejta e mbrojtur nga neni 5 § 4 të Konventës, për më tepër kur kërkuari e kishte përsëritur rrëfimin e tij. Gjykata theksoi se jurisprudenca e saj sipas nenit 5 § 4 të Konventës nuk parashikon që gjykatat vendase duhet të bëjnë një vlerësim të plotë për ligjshmërinë e provave të paraqitura kundër një të akuzuari në kontekstin e vendimeve të paraburgimit dhe se një vlerësim i tillë mund të sjellë që procedurat të mos jenë të shpejta sipas nenit 5 § 4 të Konventës. Prandaj, Gjykata konstatoi që kërkesa ishte e pabazuar.

Neni 6 i Konventës - E drejta për një proces të rregullt

Gjykata ka dhënë dhjetë vendime dhe pesë vendime për pranueshmëri në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt gjatë vitit 2017. Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë në shtatë vendime.

Në çështjen *Matanović v. Kroacisë* Gjykata konstatoi shkelje të Kroacisë në lidhje me nenin 6⁸⁶. Në këtë rast, Gjykata shqyrtoi të drejtën për një proces të rregullt në lidhje me nenin 7 të Konventës (nullum crimen nulla pena sine lege) dhe nenin 8 të Konventës (e drejta për respektimin e jetës private). Gjykata theksoi se kërkuarit i ishin shkelur të drejtat e mbrojtura nga neni 6 dhe neni 8 nga fakti se nuk ishin marrë provat e siguruara me masa të posaçme hetimore në procedurën penale kundër tij dhe si rrjedhojë e mungesës së një procedure të përshtatshme me anë të së cilës mund të vlerësohet si duhet relevanca e provave dhe domosdoshmëria e përdorimit të tyre.

Nga ana tjetër, Gjykata konstatoi se nuk ishte shkelur e drejta për një proces të rregullt nga ndërhyrja e një agjenti të infiltruar gjatë procedimeve penale. Kërkuari ishte nënkryetar i Fondit Kroat të Privatizimit, dhe ishte dënuar me 11 vjet burgim për ryshfet. Ai pretendoi përdorimin të paligjshëm të masave sekrete të mbikëqyrjes, rezultatet e të cilave u përdorën në gjyqin kundër tij. Ai gjithashtu kontestoi kapjen nga një agjent i infiltruar dhe mungesën e garancive procedurale sipas nenit 6 dhe se nuk i ishte lejuar qasje në një pjesë të provave të siguruara nga mbikëqyrja sekrete. Sa i përket masave të fshehta të mbikëqyrjes, Gjykata ritheksoi arsyetimin e saj të mëparshëm në çështjen *Dragojević k. Kroacisë*, ku konkludoi se procedura për urdhërimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të përgjimit të telefonit të kërkuarit ku u vendos se nuk ishin plotësuar kërkesat e ligjshmërisë, duke rezultuar në shkelje të së drejtës për jetën private të kërkuarit.⁸⁷

Në lidhje me përdorimin e të një informatori dhe pretendimet e kërkuarit se ishte nxitur për kryerjen e veprës penale nga agjentët provokues, Gjykata arriti në përfundimin se agjentët nuk e kishin nxitur atë të kryente krimin, përkundrazi ata kishin qënë pasivë dhe veprimet e tyre ishin brenda kufijëve të punës së tyre si agjentë. Sa i përket regjistrimeve të përfshira në dosjen e kërkuarit, por që nuk u morrën parasysh, Gjykata vuri në dukje se, për shkak të mosparaqitjes nga ana e kërkuarit të ndonjë argumenti specifik në lidhje me relevancën e mundshme të provave në fjalë gjatë procedurave përpara gjykatave të brendshme, Gjykata nuk ishte në gjendje të konkludonte se pamundësia e pretenduar e kërkuarit për ti konsideruar regjistrimet si prova mund të konsiderohej si një shkelje e barazisë së armëve.

⁸⁶ *Matanović k. Kroacisë*, vendim i 4 korrikut 2017.

⁸⁷ *Dragojević v. Croatia*, vendim i 15 janarit 2015.

Vendimi i Gjykatës në çështjen *Krunoslava Zovko k. Kroacisë*, në të cilën nuk u gjet shkelje e nenit 6 kërkon gjithashtu vëmendje. Kërkuuesja kishte kërkuar nga Fondi Kroat i Sigurimeve Shëndetësore (KSSH) që të njohë të drejtën e saj për raport mjekësor për t'u rikuperuar nga plagët e marra në një aksident të pësuar në punë edhe pse mjeku i përgjithshëm kishte vlerësuar se dhimbjet e qafës për të cilat ajo ankohej nuk kishin lidhje me aksidentin e ndodhur dy vjet më parë. KSSH rrëzoi kërkesën e saj. Krunoslava Zovko pasi dokumentacioni i saj mjekësor u shqyrtua dy herë nga ekspertët, të cilët arritën në përfundimin se dhimbjet e saj nuk kishin lidhje me aksidentin në fjalë. Kërkuuesja inicioi një proces në gjykatën administrative, e cila e pushoi çështjen. Kërkuuesja u ankua përpara Gjykatës për rregullsinë e procedurave administrative, duke pretenduar se ajo ishte përjashtuar tërësisht nga këto procedura duke mos u lejuar të marrë pjesë në to, si edhe të merre raportet e ekspertëve të përdorura për të vendosur mbi themelin e kërkesës së saj për të marrë raportin. Ajo pretendoi se mjekët ishin të anshëm dhe punonin me kohë të plotë për KSSH.

Gjykata mbështeti argumentet e Shtetit se ekspertët e KSSH kishin shqyrtuar të gjitha ankesat e kërkueses për shëndetin e saj dhe u është përgjigjur atyre në mënyrë adekuate. Kërkuuesja u njoftua për gjetjet e tyre dhe pati një mundësi për të kundërshtuar raportet e ekspertëve dhe vendimet përkatëse përpara Gjykatës Administrative të Zagrebit. Prandaj, kërkuuesja kishte marrë pjesë në mënyrë efektive në procesin e brendshëm dhe marrjen e raporteve të ekspertëve. Fakti që ekspertët ishin stafi i KSSH ishte i pamjaftueshëm për të vënë në pikëpyetje paanësinë e tyre.

Në lidhje me vendimet e pranueshmërisë mbi nenin 6, duhet mbajtur në vëmendje vendimi i Gjykatës në çështjen *Marušić k. Kroacisë*, në të cilin u rrëzua ankimi për nenin 6 dhe vendos se ankimi nuk përfshihej në fushëveprimin e këtij neni. Kërkuuesja, një ish profesore e Fakultetit të Mjekësisë së Zagrebit, u ankua në Gjykatë se procesi që kish kryer Këshilli i Integritetit të Shkollës kundër saj kish qenë i padrejtë. Këshilli i Integritetit konstatoi se kërkuuesja kishte përkthyer tekste nga një libër mjekësor i një autori amerikan dhe i përfshirë ato në librin e saj pa cituar autorin ose tekstin e tij. Sipas Këshillit kërkuuesja kishte shkelur Kodin e Etikës së Fakultetit të Mjekësisë dhe për rrjedhojë ndaj saj ishte marrë ndaj saj një vërejtje. Gjykata e pranoi argumentin e shtetit të paditur se nuk kishte juridiksion për të vlerësuar rregullsinë e procesit, sepse kërkuuesja nuk kishte rrezikuar pezullimin ose ndalimin e vazhdimin të aktiviteteve të saj profesionale, si edhe faktin se procesi ishte fokusuar kryesisht në pajtueshmërinë me standardet etike, duke vlerësuar sjelljen e kërkueses në rastin në fjalë. Për rrjedhojë, rezultati i këtij procesi nuk ishte vendimtar për respektimin e të drejtës së saj për një proces të rregullt ligjor garantuar nga neni 6 dhe ankimi u shpall i papranueshëm.

Neni 8 i Konventës – E drejta për respektimin e Jetës Private dhe Familjare

Gjykata ka dhënë tre vendime themei dhe dy vendime pranueshmërie në kuadër të nenit 8 ndaj Kroacisë.

Në vendimin e saj për çështjen *Ž.B. k. Kroacisë*, Gjykata konstatoi se e drejta e kërkueses për respektimin e jetës private sipas nenit 8 të Konventës ishte shkelur nga ndërprerja e procesit penal kundër dhunës në familje. Në vitin 2007, kërkuuesja paraqiti një kallzim penal kundër bashkëshortit të saj duke e akuzuar për dhunë në familje. Gjykata e shkallës së parë e gjeti atë fajtor, por dy vendimet e kësaj gjyakte u anuluan dhe rasti u dërgua dy herë për shqyrtim të mëtejshëm. Ndërkohë, hyri në fuqi Kodi i ri Penal ('KP 2011'), i cili shfuqizoi veprën penale të dhunës në familje. Dhuna në familje ishte e dënueshme sipas Ligjit për Dhunën në Familje si vepër e kundërligjshme. Kur hyri në fuqi Kodi i ri Penal,

proceset penale kundër dhunës në familje u ndërprejnë, sepse Kodi nuk e konsideronte më këtë veprë penale. Kërkesja u ankua në Gjykatë se autoritetet vendase nuk e kishin ndjekur penalisht shkelësin në mënyrë adekuate. Gjykata konstatoi se, edhe pse KP 2011 hequr veprën penale të posaçme të dhunës në familje është kusht, që rastet e dhunës brenda familjes të përbëjnë rrethana rënduese për një sërë veprash të tjera penale (plagosjes, kërcënimit, përdhunimit, etj). Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se KP 2011 krijoi një vazhdimësi të ndjekjes penale të në mënyrë të njëjtë me kodin e mëparshëm dhe se ky kuadër ligjor ofronte mundësi të përshtatshme për ndëshkimin e dhunës në familje. Gjithashtu, Gjykata vërejti se autoritetet përkatëse të ndjekjes penale nuk arritën të riklasifikonin akuzën ndaj bashkëshortit të kërkuësës në kuadër të Kodit të ri Penal. Kjo situatë derivoi ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor, duke derivuar situatën se aktet e dhunës ndaj kërkuësës nuk u adresuan asnjëherë nga një gjykatë kompetente e krijuar me ligj, duke mos ndërshkuar ish bashkëshortin e saj. Kështu, u shkelën të drejtat e kërkuësës garantuar nga Konventa.

Sa i përket të drejtave të prindërve dhe fëmijëve, të cilat gjithashtu bien në fushëveprimin e nenit 8 të Konventës, Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuësve për jetë të qetë familjare, në vendimin e saj *K.B. dhe Të Tjerët k. Kroacisë*. Domethënë, gjykatat vendase morën vendime për takimet prindërore mes kërkuësës dhe dy djemve të saj të mitur, të cilët ishin nën kujdestarinë e babait të tyre. Megjithatë, këto orare nuk u zbatuan sikurse përcaktohej në vendimin gjyqësor për shkak të rezistencës së fëmijëve. Këruesja u ankua se shteti kishte dështuar të përmbushë detyrimet e tij pozitive për të lehtësuar kontaktin midis saj dhe fëmijëve, duke shkelur kështu të drejtën e saj për të respektuar jetën familjare. Gjykata vërejti se gjykatat e brendshme kishin marrë me vonesë masa për rastin e kërkuësës dhe këto masa kishin qenë joefektive. Ndër të tjera, Gjykata theksoi se gjykatat vendase kishin marrë një kohë tepër të gjatë për të vendosur mbi ankesën e kërkuësës. Gjykatat vendase nuk kishin rregulluar përkohësisht të drejtat e kujdestarisë dhe të kontaktit në vendimin e divorcit. Ato nuk kishin arritur të urdhëronin menjëherë një vlerësim të ekspertëve mbi fëmijët lidhur me shkaqet e rezistencës së tyre.

Neni 10 – Liria e Shprehjes

Në 2017, Gjykata dha kundër Kroacisë një vendim në lidhje me lirinë e shprehjes, në lidhje me çështjen *Maruniç k. Kroacisë*, në të cilën konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuësës për t'u shprehur lirisht. Kërkesja ishte drejtoreshë e një ndërmarrjeje publike. Në vitin 2007, Kryetari i Asamblesë së Shoqërisë kritikoi në media mënyrën se si ndërmarrja e kryente punën e saj. Gjithashtu, kërkesja iu përgjigj këtyre kritikave në media. Ajo u shpreh se kompania po akuzohej në mënyrë të paligjshme për çështjet në fjalë dhe bëri u thirrje publike auditorëve shtetërorë, Zyrës për Parandalimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë për të kontrolluar operacionet e kompanisë. Pas paraqitjes së saj në media, kërkesja u shkarkua me argumentin se dëmtoi reputacionin e kompanisë. Ajo nisi procedimet civile kundër kompanisë duke kundërshtuar shkarkimin e saj, por gjykatat kroate vendosën që shkarkimi kishte qenë i ligjshëm. Në kundërshtim me gjykatat kroate, GJEDNJ-ja vendosi që kërkesja kishte të drejtë t'i përgjigjej kritikave publike në të njëjtën mënyrë në të cilën këto kritika ishin shprehur (publikisht dhe në media) dhe se ajo nuk e kishte shkelur detyrën e saj të besnikërisë ndaj kompanisë si punëdhënëse. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se autoritetet vendase kishin shkelur të drejtën e kërkuësës për t'u shprehur lirisht garantuar nga neni 10 i Konventës.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 i Konventës – E drejta për gëzim paqësor të pasurisë

Në vitin 2017, Gjykata dha dy vendime themeli dhe tri vendime pranueshmërie për të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë përcaktuar në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Në rastin e *Boljeviç k. Kroacisë*, Gjykata gjeti se autoritetet vendase kishin shkelur të drejtën e kërkuarit për gëzimin paqësor të pasurisë. Konkretisht, 180,000 euro që i përkisnin kërkuarit u konfiskuan prej tij në procese përpara Këshillit për Kundërvajtje Administrative, sepse ai nuk e kishte respektuar detyrimin për të deklaruar një shumë të tillë parash pranë doganës kur hyri në Kroaci në 2009. Kërkuarisi pohoi se vendimi i autoriteteve shtetërore për të konfiskuar paratë e tij vetëm për shkak se ai nuk i kishte deklaruar ishte i tepruar. Gjykata konstatoi se konfiskimi i parave ishte i ligjshëm, sepse bazohej në dispozitat ligjore në fuqi dhe se ky ndalim ndiqte një qëllim legjitim - luftën kundër pastrimit të parave. Megjithatë, Gjykata vërejti se masa nuk ishte proporcionale, sepse e vetmja vepër që kish kryer kërkuarisi ishte mos deklarimi i parave në kufi. Gjykata vërejti se sjellja e parave në Kroaci nuk ishte e ndaluar, shuma që mund të transferohej përtej kufirit nuk ishte e limituar dhe se paditësi nuk ishte akuzuar për ndonjë vepër penale lidhur me paratë. Gjykata vendosi se shteti kishte shkelur të drejtën e kërkuarit për gëzimin paqësor të pasurisë së tij, sepse edhe pse konfiskimi i parave ishte i ligjshëm dhe kishte një qëllim legjitim, nuk ishte proporcionale.

Neni 2 i Protokollit Nr. 4 i Konventës – Liria e lëvizjes

Gjykata dha një vendim pranueshmërie në lidhje me këtë të drejtë ndaj Kroacisë në 2017, për çështjen *Folnegović k. Kroacisë*. Në periudhën midis viteve 1996 dhe 2013, autoritetet kompetente të ndjekjes penale në Kroaci hapën në total pesëmbëdhjetë çështje penale kundër kërkuarit në lidhje me dyshimin se kishte krijuar një rrjet për ofrimin e paligjshëm dhe mashtrues të kredive në Zvicër për qytetarët kroatë. U pretendua se pesëdhjetë e gjashtë individë kishin rënë viktimë e veprimtarive të tilla kriminale dhe se kërkuarisi kishte shkaktuar gjithashtu dëme në shtetin. Fitimi total i pretenduar vlerësohej të ishte 645,847.06 euro. Gjatë procesit penal kundër tij, kërkuarisi disa herë nuk u paraqit përpara gjykatave kompetente. Për shkak të pamundësisë së autoriteteve kroate për të siguruar praninë e kërkuarit katër seri procedimesh ishin zhvilluar në mungesë të tij. Në këto procese penale kërkuarisi ishte dënuar me burg nga një deri në tre vjet. Atij i ishte dhënë një urdhër ndalimi për të udhëtuar dhe i ishte konfiskuar pasaporta. Kërkuarisi u ankua se një veprim i tillë nga autoritetet shtetërore shkeli të drejtën e tij për lirinë e lëvizjes.

Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte haptazi i papranueshme duke shpjeguar se sipas saj, vendosja e urdhërit të ndalimit administrativ duhet të shihet kundrejt rrethanave të përgjithshme të rastit, të cilat tregojnë se për një periudhë të zgjatur, kërkuarisi shmangi në mënyrë të pajustificuar paraqitjen para gjykatave kompetente për të marrë pjesë në proceset penale kundër tij. Gjykata arriti në përfundimin se, në këto rrethana, nuk kishte asgjë fakt që derivonte përfundimin se gjykatat vendase kishin dështuar të vlerësonin në mënyrë të përshtatshme ekzistencën e një rreziku të qenësishëm për largimin e kërkuarit nga vendi.

MAQEDONIA

Hyrje

Që nga 10 prilli i vitit 1997, koha që ky Shtet ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa” ose “KEDNJ”), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“Gjykata” ose “GJEDNJ”) ka dhënë 141 vendime dhe 426 vendime mbi pranueshmërinë kundër Maqedonisë, prej të cilave tetë vendime dhe gjashtëmbëdhjetë vendime mbi pranueshmërinë janë dhënë gjatë vitit 2017.⁸⁸ Nga këto vendime, 130 janë shqyrtuar nga Dhoma, 13 nga Komiteti dhe dy nga Dhoma e Madhe. Lidhur me vendimet e pranueshmërisë, për 185 raste vendimi u dha nga një Dhomë dhe në 241 raste vendimi u dha nga një Komitet.

Në lidhje me nenin 6 të Konventës, e drejta për një proces të rregullt, janë dhënë 104 vendime, duke gjetur shkelje në 96 raste. Këto raste, kishin të bënin kryesisht me kohëzgjatjen e proceseve dhe moekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, përveç kësaj, shumë raste ngrinin në diskutim çështje që kanë të bëjnë me paanësinë e gjyqtarëve,⁸⁹ duke përfshirë rastet e shkarkimit dhe pastërtisë së figurës të gjyqtarëve,⁹⁰ parimin e barazisë së armëve,⁹¹ veçanërisht në lidhje me shqyrtimin e dëshmive të dëshmitarëve⁹² dhe vlerësimin e opinioneve të ekspertëve,⁹³ si dhe praninë në gjyq.⁹⁴ Pranueshmëria e provave të marra në mënyrë të paligjshme,⁹⁵ përdorimi i provave të marra nga dëshmitarët e marrë në mbrojtje ose anonim,⁹⁶ e drejta për t’u mbrojtur,⁹⁷ e drejta për përkthyes⁹⁸ dhe prezumimi i pafajësisë,⁹⁹ u trajtuan gjithashtu në shumë raste penale. Përveç kësaj, shqyrtimi i nevojave për siguri gjyqësore dhe jurisprudenca e konsoliduar¹⁰⁰, mungesa e arsytimit¹⁰¹, e drejta për të aksesuar gjykatën¹⁰² dhe e drejta për një seancë dëgjimore¹⁰³, u shqyrtuan gjithashtu në disa raste civile dhe administrative.

-
- 88 Lista e vendimeve përfshin *Krstanoski dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017; “*Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peç)*” k. *Maqedonisë*, vendim i 16 nëntorit 2017; *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 tetorit 2017; *Petrović k. Maqedonisë*, vendim i 22 qershorit 2017; *Qendra për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017; *Toleski k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017; *Karajanov k. Maqedonisë*, vendim i 6 prillit 2017; *Selmani dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 9 shkurtit 2017.
- 89 *Mitrov k. Maqedonisë*, vendim i 2 qershorit 2016; *Bajaldžiev k. Maqedonisë*, vendim i 25 tetorit 2011; *Nikolov k. Maqedonisë*, vendim i 20 dhjetorit 2007.
- 90 *Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016; *Mitrinovski k. Maqedonisë*, vendim i 30 prillit 2015.
- 91 *Naumoski k. Maqedonisë*, vendim i 27 nëntorit 2012; *Grozdanoski k. Maqedonisë*, vendim i 31 majit 2007.
- 92 *Dončev dhe Burgov k. Maqedonisë*, vendim i 12 qershorit 2014.
- 93 *Duško Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014; *Stoimenov k. Maqedonisë*, vendim i 5 prillit 2007.
- 94 *Eftimov k. Maqedonisë*, vendim i 2 korrikut 2015; *Atanasov k. Maqedonisë*, vendim i 17 shkurtit 2011; *Nasteska k. Maqedonisë*, vendim i 27 majit 2010; *Mitrevski k. Maqedonisë*, vendim i 21 qershorit 2006.
- 95 *Hajrullahu k. Maqedonisë*, vendim i 29 tetorit 2015.
- 96 *Papadakis k. Maqedonisë*, vendim i 26 shkurtit 2013; *Trampevski k. Maqedonisë*, vendim i 10 korrikut 2012.
- 97 Asnjë shkelje nuk u gjet në *Solakov k. Maqedonisë*, vendim i 31 tetorit 2001.
- 98 Asnjë shkelje nuk u gjet në *Sandel k. Maqedonisë*, vendim i 27 majit 2010.
- 99 Asnjë shkelje nuk u gjet në këtë drejtim në *Poletan dhe Azirovik k. Maqedonisë*, vendim i 12 majit 2016; *Miladinov dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014.
- 100 *Stoilkovska k. Maqedonisë*, vendim i 18 korrikut 2013.
- 101 *Atanasovski k. Maqedonisë*, vendim i 14 janarit 2010.
- 102 *Balažoski k. Maqedonisë*, vendim i 25 prillit 2013; *Demerdžieva dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 10 qershorit 2010; *Fetaovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 qershorit 2008.
- 103 *Mitkova k. Maqedonisë*, vendim i 15 tetorit 2015.

Gjithësej, janë dhënë 19 vendime në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, dhe në 8 prej tyre është konstatuar shkelje lidhur me këtë nen. Në *Stojanovski dhe Tërët*, kërkuessve iu mohua e drejta e tyre për rikthimin e pronës, një tokë e konfiskuar, megjithëse ata përmbushnin kriteret ligjore.¹⁰⁴

Në rastin *Arsovski*, shpronësimi i tokës së kërkuessve në favor të një kompanie private i kishte ngarkuar ata me një barrë të tepërt dhe joproporcionale, pasi shpërblimi ndaj palës së dëmtuar nuk ishte i drejtë.¹⁰⁵ Anulimi i posaçëm i një urdhri kthimi përfundimtar, i dhënë në favor të kërkuessit në rastin *Vikentijević*¹⁰⁶, i cili më vonë u shpall i pavlefshëm, nuk përbente shkelje, duke marrë parasysh parimin e administrimit të duhur të drejtësisë. Konfiskimi i automjeteve në posedim të kërkuessve që shërbeu si instrument për kryerjen e një vepre penale përbente shkelje në dy vendime.¹⁰⁷

Gjykata dha katër vendime në lidhje me nenin 2, të drejtën për jetën.¹⁰⁸ Në rastin e *Sašo Gorgiev*¹⁰⁹, u konstatua shkelje edhe pse nuk kishte pasur si pasojë vdekjen në një rast ku kërkuessi kishte pësuar një dëmtim të shkaktuar nga një polic, i cili më vonë u dënua për “krime të rënda kundër sigurisë publike”, me dy vjet burg. Rasti *Neškoska* kishte të bënte me dështimin për të kryer një hetim efektiv mbi vdekjen e djalit të kërkuessit, i cili u vra nga një anëtar i forcave speciale të policisë gjatë festimit të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare në vitin 2011.¹¹⁰ Gjykata vendosi që veprimet ose mosveprimet e atyre për të cilët dyshohej se ishin përfshirë në dështimin për të raportuar një krim apo një vepër penale, nuk pengonin kryerjen efektive të hetimit dhe për rrjedhojë nuk kishte pasur shkelje. *Kitanovska Stanojković dhe të Tërët*¹¹¹ kishin të bënin me ekzekutimin e vonuar të dënimit me burg.

Në 10 nga 11 vendime lidhur me nenin 3, Gjykata ka konstatuar shkelje të aspektit procedural.¹¹² Përveç *El-Masrit*, *Hajrullahu* është i vetmi vendim, ku Gjykata vlerësoi se trajtimi ndaj të cilit i ishte nënshtruar kërkuessi përbente torturë, duke qenë se ai u rrëmbye dhe u mbajt *incommunicado* (i izoluar) për tri ditë në një shtëpi, një vend i posaçëm ndalimi, dhe më tej ai ishte frikësuar me qëllim për të folur, veprim që i kishte shkaktuar atij dhimbje dhe vuajtje emocionale, psikologjike dhe fizike.¹¹³ Në rastin *Kitanovski*, GJEDNJ konstatoi shkelje të detyrimit material dhe procedural,¹¹⁴ në kuadër të mungesës së veprimeve hetimore mbi kallzimin penal të parashtruesit kundër anëtarëve të njësisë së policisë

104 *Stojanovski dhe të Tërët k. Maqedonisë*, vendim i 23 tetorit 2014.

105 *Arsovski k. Maqedonisë*, vendim i 15 janarit 2013.

106 *Vikentijević k. Maqedonisë*, vendim i 6 shkurtit 2014.

107 *Vasilevski k. Maqedonisë*, vendim i 28 prillit 2016; *Andonovski k. Maqedonisë*, vendim i 17 shtatorit 2015. Asnjë shkelje nuk u gjet në *Sulejmani k. Maqedonisë*, vendim i 28 prillit 2016.

108 *Kitanovska Stanojković dhe të Tërët k. Maqedonisë*, vendim i 13 tetorit 2016; *Neškoska k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016; *Kitanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 janarit 2015; *Sašo Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012.

109 *Sašo Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012.

110 *Neškoska k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016.

111 *Kitanovska Stanojković dhe të Tërët k. Maqedonisë*, vendim i 13 tetorit 2016.

112 *Asllani k. Maqedonisë*, vendim i 10 dhjetorit 2015; *Hajrullahu k. Maqedonisë*, vendim i 29 tetorit 2015; *Andonovski k. Maqedonisë*, vendim i 23 korrikut 2015; *Kitanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 janarit 2015; *El-Masri k. Maqedonisë*, Vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012; *Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012; *Sulejmanov k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2008; *Dželadinov dhe të Tërët k. Maqedonisë*, vendim i 10 prillit 2008; *Trajkoski k. Maqedonisë*, vendim i 7 shkurtit 2008; *Jašar k. Maqedonisë*, vendim i 15 shkurtit 2007.

113 *Hajrullahu k. Maqedonisë*, vendim i 29 tetorit 2015.

114 *Kitanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 janarit 2015.

«Alpha», por edhe faktin që i njëjti prokuror, i cili kishte ngritur akuzë penale kundër kërkuesit, kishte shqyrtuar më parë ankesën e tij, fakt që ngrinte dyshime mbi paanshmërinë e prokurorit.

Në shumë raste,¹¹⁵ Gjykata theksoi se viktimat e shkeljeve të pretenduara nuk janë të detyruara të ndjekin vetë ndjekjen penale të agjentëve shtetërorë, pasi kjo është më tepër një detyrë e prokurorit publik, duke përfshirë edhe në rastin *Gorgiev*¹¹⁶ ku janë shqyrtuar detyrimet pozitive të shtetit lidhur me një incident, në të cilin një i burgosur kishte pësuar lëndime nga një dem gjatë punës në fermën e burgut. Formalizmi i tepruar në insistimin e gjykatave vendase, që kërkuesi të zbulojë identitetin e të gjithë punonjësve të policisë kundër të cilëve ai kishte sjellë akuza plotësuese penale përbënte shkelje të detyrimit procedural në rastin *Trajkovski*.¹¹⁷ *Ilievska* është i vetmi rast ku Gjykata konstatoi shkelje vetëm në lidhje me aspektin material për shkak të trajtimit poshtëruës, pasi kërkuesja ishte prangosur gjatë transferimit të saj në spitalin psikiatrik të Bardovcit, ku duke marrë parasysht gjendjen e saj shëndetësore, masa e ndërmarrë nuk ishte proporcionale.¹¹⁸

Në shtatë vendimet e dhëna në kuadër të nenit 5, e drejta për liri dhe siguri, u konstatuan shkelje.¹¹⁹ Vendimi i Dhomës së Madhe në rastin *El-Masri k. Maqedonisë*,¹²⁰ kishte të bënte me një “dorëzim të jashtëzakonshëm” të një shtetasi gjerman dhe transferimin e tij në Afganistan, ku ai më pas ishte subjekt i keqtrajtimit. Ndalimi i tij si haptazi i pabazuar dhe në izolim (incomunicado) në një vend të posaçëm ndalimi jashtë çdo konteksti gjyqësor, ishte arbitrar në kuadër të heqjes së lirisë. Çështjet më të zakonshme kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e tepërt të paraburgimit dhe mungesën e arsytimit të urdhrave të ndalimit kolektiv¹²¹, por Gjykata gjithashtu diskutoi dhe të drejtën e të pandehurit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset në të cilat masa me arrest shtëpie është zëvendësuar në arrest me burg,¹²² ku arrestimi i paligjshëm dhe heqja e lirisë, i referohej mosrespektimit të urdhrave të gjykatës për shlyerjen e një gjobe dhe mosveprimin e mëvonshëm për të akorduar shpërbllim të drejtë në lidhje me burgimin e paligjshëm, si dhe mos njoftimin e kërkuesit lidhur me arsyet e arrestimit ose burgimit të tij ose të çdo akuze të ngritur kundër tij¹²³ dhe mungesës së dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer një vepër penale.¹²⁴ Vetëm një rast ka të bëjë me ndalimin e pajustificuar dhe të vazhdueshëm në një institucion psikiatrik.¹²⁵

Gjykata konstatoi shkelje në pesë nga gjashtë vendimet që kanë të bëjnë me kërkesat në bazë të

115 *Asllani k. Maqedonisë*, vendim i 10 dhjetorit 2015; *Andonovski k. Maqedonisë*, vendim i 23 korrikut 2015; *Kitanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 janarit 2015.

116 *Gorgiev k. Maqedonisë*, vendim i 19 prillit 2012.

117 *Trajkovski k. Maqedonisë*, vendim i 7 shkurtit 2008.

118 *Ilievska k. Maqedonisë*, vendim i 7 majit 2015.

119 *Miladinov dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014; *Velinov k. Maqedonisë*, vendim i 19 shtatorit 2013; *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012; *Vasilkoski dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 28 tetorit 2010; *Mitreski k. Maqedonisë*, vendim i 25 marsit 2010; *Trajče Stojanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 tetorit 2009; *Lazoroski k. Maqedonisë*, vendim i 8 tetorit 2009.

120 *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012.

121 *Miladinov dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 24 prillit 2014; *Vasilkoski dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 28 tetorit 2010.

122 *Mitreski k. Maqedonisë*, vendim i 25 marsit 2010.

123 *Velinov k. Maqedonisë*, vendim i 19 shtatorit 2013.

124 *Lazoroski k. Maqedonisë*, vendim i 8 tetorit 2009.

125 *Trajče Stojanovski k. Maqedonisë*, vendim i 22 tetorit 2009.

nenit 8.¹²⁶ Këto raste përfshijnë të drejtën e kërkuesit për respektimin e reputacionit të tij,¹²⁷ ushtrimin e të drejtave prindërore, mbajtjen e kontakteve me fëmijët dhe mungesën e ekzekutimit të urdhrave të kontaktit,¹²⁸ integritetin moral dhe fizik të personit, të drejtën për zhvillim personal, si dhe të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore dhe botën e jashtme.¹²⁹

Lidhur me nenin 9, Gjykata nuk konstatoi asnjë shkelje në rastin *Kosteski*,¹³⁰ ndërsa në lidhje me nenin 11 janë konstatuar shkelje në dy raste.¹³¹ Rasti *Shoqata Radko dhe Paunkovski*, kishte të bënte me ndërhyrjen e pajustificuar në lidhje me shpërbërjen e një shoqate menjëherë pas themelimit të saj në bazë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që konstatonte se Statuti dhe Programi i saj ishin nul dhe të pavlefshme dhe se ishin antikushtetuese dhe nxitnin urrejtjen dhe intolerancën kombëtare ose fetare.¹³² Ekzekutimi i këtij vendimi u krye në vitin 2017, ku pas disa refuzimeve të regjistrimit të shoqatës së kërkuesit për arsye procedurale dhe ankesave kundër këtyre vendimeve, kërkesa për regjistrim u pranua më 5 tetor 2016.¹³³

Vendime të 2017

Nga tetë vendimet e dhëna në vitin 2017, pesë vendime¹³⁴ u dhanë nga një Dhomë prej shtatë gjyqtarësh dhe tre të tjerat¹³⁵ nga një Komitet prej tre gjyqtarësh. Në një rast Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10,¹³⁶ nenit 11 marrë së bashku me nenin 9¹³⁷, shkelje të nenit 8,¹³⁸ në katër raste shkelje të nenit 6,¹³⁹ ndërsa në tri raste Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 6¹⁴⁰ dhe në katër raste nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.¹⁴¹

126 *Karajanov k. Maqedonisë*, vendim i 6 prillit 2017; *Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016; *Mitovi k. Maqedonisë*, vendim i 16 prillit 2015; *Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 31 tetorit 2013; *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i 13 dhjetorit 2012.

127 *Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016; *Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 31 tetorit 2013.

128 *Mitovi k. Maqedonisë*, vendim i 16 prillit 2015. Përkundrazi, asnjë shkelje nuk u gjet në këtë drejtim *Mitrova dhe Savić k. Maqedonisë*, vendim i 11 shkurtit 2016.

129 *El-Masri k. Maqedonisë*, vendim i 13 dhjetorit 2012.

130 *Kosteski k. Maqedonisë*, vendim i 13 prillit 2006.

131 "*Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peć)*" k. *Maqedonisë*, vendim i 16 nëntorit 2017; *Shoqata Radko dhe Paunkovski k. Maqedonisë*, vendim i 15 janarit 2009.

132 *Shoqata Radko dhe Paunkovski k. Maqedonisë*, vendim i 15 janarit 2009.

133 [http://hudoc.exec.coe.int/eng#{"EXECDocumentTypeCollection":\["CEC"\],"EXECState":\["MKD"\],"EXECIdentifier":\["004-40878"\]}](http://hudoc.exec.coe.int/eng#{).

134 "*Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peć)*" k. *Maqedonisë*, vendim i 16 nëntorit 2017; *Petrović k. Maqedonisë*, vendim i 22 qershorit 2017; *Qendra për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017; *Karajanov k. Maqedonisë*, vendim i 6 prillit 2017; *Selmani dhe të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 9 shkurtit 2017.

135 *Krstanoski dhe të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017; *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 tetorit 2017; *Toleski k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017.

136 *Selmani dhe të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 9 shkurtit 2017.

137 "*Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peć)*" k. *Maqedonisë*, vendim i 16 nëntorit 2017.

138 *Karajanov k. Maqedonisë*, vendim i 6 prillit 2017.

139 *Qendra për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017; *Toleski k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017; *Karajanov k. Maqedonisë*, vendim i 6 prillit 2017; *Selmani and others k. Maqedonisë*, vendim i 9 shkurtit 2017.

140 *Krstanoski dhe të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017; *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 tetorit 2017; *Petrović k. Maqedonisë*, vendim i 22 qershorit 2017.

141 *Krstanoski dhe të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017; *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 tetorit 2017; *Petrović k. Maqedonisë*, vendim i 22 qershorit 2017; *Toleski k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017.

*Selmani dhe Tërjet k. Maqedonisë*¹⁴² është vendimi i parë në lidhje me Maqedoninë, në të cilën Gjykata konstatoi **shkelje të lirisë së shprehjes të garantuar me nenin 10 lidhur me largimin me forcë të kërkuesve, të gjithë gazetarë, nga Selia Parlamentare ku ata ishin duke raportuar në seancën parlamentare mbi Ligjin për Buxhetin**, të mbajtur më 24 dhjetor 2012.

Gjykata mori në konsideratë protestat e dy grupeve kundërshtarë përpara ndërtesës së Parlamentit dhe atmosferën e tensionuar e cila derivoi në trazira nga një grup deputetësh dhe detyruan Kryetarin të urdhëronte personelin e sigurisë që të merrte masa për të rivendosur rendin dhe të siguronte funksionimin e duhur të Parlamentit. Në mënyrë specifike iu referua rolit të “mbikqyrësit” të medias dhe detyrën e tyre për dhënien e informacionit mbi ngjarjen dhe të drejtën e publikut për të marrë një informacion të tillë. Gjykata nuk gjeti asnjë tregues se sjellja e parregullt e deputetëve në Dhomën e Parlamentit do të kishte vënë në rrezik jetën dhe integritetin fizik të kërkuesve. Ajo vlerësoi se kërkuesit nuk kishin qenë në gjendje të shihnin largimin e deputetëve të opozitës, si një çështje me interes të ligjshëm publik dhe largimi i tyre i pengoi ata të merrnin informacion të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë bazuar në përvojën e tyre personale të ngjarjeve. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat para dhe gjatë debatit parlamentar dhe duke vlerësuar të dy interesat publike, përkatësisht interesat e shërbimit të sigurisë në ruajtjen e rendit në Parlament dhe garantimin e sigurisë publike dhe interesat e publikut në marrjen e informacionit mbi një çështje të përgjithshme interesi, Gjykata vlerësoi se largimi i kërkuesve nuk ishte i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe nuk e kishte përmbushur kërkesën e “nevojës së ngutshme shoqërore” dhe për rrjedhojë, edhe pse arsyet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese kishin qenë të rëndësishme, ato nuk kishin qenë të mjaftueshme për të justifikuar largimin e kërkuesve.

Përveç kësaj, ky është rasti i parë ku Gjykata konstatoi **shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk kishte zhvilluar një seancë dëgjimore**, megjithëse neni 55 i Rregullores së tij parashikonte që, si rregull, një kërkesë individuale kushtetuese sipas nenit 110 § 3 të Kushtetutës do të duhej të mbahej në një seancë publike në praninë e palëve. Duke pasur parasysh se Gjykata Kushtetuese ishte organi i vetëm, i cili vendosi mbi themelin dhe faktet e çështjes, të kontestuara nga palët të cilat kishin qenë relevante për vendimin e saj final. Gjykata vendosi që administrimi i drejtësisë do të kishte shërbyer më mirë duke u dhënë kërkuesve të drejtën për të parashtruar rastin e tyre personal në një seancë para Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, megjithëse kërkuesit kishin kërkuar një seancë dëgjimore, kërkesa e tyre ishte refuzuar dhe Gjykata Kushtetuese, duke mos dhënë asnjë arsye përse e konsideroi se seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme të mbahej. Duke marrë parasysh konstatimet e mësipërme, Gjykata vuri në dukje se nuk kishte pasur rrethana të jashtëzakonshme që mund të justifikonin moszhvillimin e një seance dëgjimore.

Një rast i një rëndësie të veçantë ishte vendimi në çështjen e “*Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peć)*” k. *Maqedonisë*¹⁴³, e cila kishte të bënte me **refuzimin nga autoritetet e brendshme për të regjistruar shoqatën kërkuese**. Kërkesa e saj për regjistrim si një grup fetar u hodh poshtë në dy raste për disa arsye mjaft formale. Vendimi i parë i dhënë nga organi kompetent administrativ u la në fuqi nga Gjykata e Lartë, e cila konsideronte se emri i saj nënkuptonte krijimin e një institucioni fetar paralel, në vend të një grupi fetar siç pretendohet, duke pasur parasysh se emri i tij, në thelb ishte i njëjtë me atë emrin e Kishës Ortodokse Maqedonase (KOM). Vendimi i dytë i dhënë nga gjykata e shkallës së parë, e regjistrimit të kësaj shoqate, e lënë në

142 *Selmani dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 9 shkurtit 2017.

143 “*Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit në Patrikanën e Peć)*” k. *Maqedonisë*, vendim i 16 nëntorit 2017.

fuqi nga Gjykata e Apelit të Shkupit, arsyetoi se KOM kishte “të drejtën historike, fetare, morale dhe substanciale” për ta përdorur atë emër. Në kërkesat kushtetuese, kërkuesi ngriti të njëjtat pretendime për të cilat u ankua para Gjykatës. Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë të dy kërkesat dhe i arsyetoi në mënyrë të gjerë vendimet e saj. Në vendimin e saj të parë, në mënyrë eksplicite thuhej se nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar kërkesën e kërkuetit, ndërsa kërkesa e dytë kushtetuese e paraqitur nga shoqata kërkuese u hodh poshtë për shkak të moszbatimit të kërkuetit për disa kërkesa formale ligjore përpara gjykatës kompetente që kishte kryer regjistrimin.

Në analizën e saj, Gjykata konstatoi dallimet e gjera të vlerësimit të Shteteve në marrëdhëniet e tyre me komunitetet fetare dhe theksoi nevojën që Shteti duhet të ndërmarrë veprime për të pajtuar interesat e grupeve të ndryshme fetare që bashkëjetojnë në një shoqëri demokratike, duke mbetur neutral dhe i paanshëm. Ajo deklaroi se arsyet e parashtruara lidhur me mangësitë formale për regjistrim nuk ishin as të rëndësishme dhe as të mjaftueshme. Për më tepër, Gjykata vërejtë se Kushtetuta maqedonase ruajti ndarjen midis Kishës dhe Shtetit dhe barazinë e të gjitha organizatave fetare përpara ligjit. Ajo theksoi se autoritetet kombëtare duhet të tregojnë vigjilencë të veçantë për të garantuar që opinioni publik kombëtar nuk është i mbrojtur në kuadër të deklaramëve të pikëpamjeve të pakicave, sado të papëlqyeshme që mund të jenë ato dhe roli i autoriteteve në një situatë konflikti midis ose brenda grupeve fetare nuk është që të heqë shkakun e tensionit duke eliminuar pluralizmin, por të sigurojë që grupet konkurruese të tolerojnë njëri-tjetrin. Gjykata përsëriti se nuk mund të ketë justifikime për masat parandaluese për të ndaluar lirinë e tubimit apo të shprehjes, dhe se në asnjë fazë të proceseve të brendshme nuk është pretenduar se kërkuesi kishte mbrojtur përdorimin e dhunës ose të mjeteve antidemokratike për të ndjekur qëllimet e tij, ku u konstatua se mënyra në të cilën autoritetet vendase kishin refuzuar njohjen e shoqatës kërkuese nuk kishin qenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe përbënin **shkelje të nenit 11 të Konventës të marrë së bashku me nenin 9**. Megjithatë, vendimi i Gjykatës nuk është ende i formës së prerë, duke qenë se kërkesa e Qeverisë për referim në Dhomën e Madhe të paraqitur në bazë të nenit 43 § 1 të Konventës është ende në pritje të vendimit të një paneli prej pesë gjyqtarësh të Dhomës së Madhe nëse do kalojë ose jo në juridiksionin e saj.

Një rast tjetër i rëndësishëm ishte *Karajanov k. Maqedonisë*,¹⁴⁴ i cili kishte të bënte me **padrejtësinë e vendimeve të autoriteteve të brendshme në proceset kalimtare kundër kërkuetit**. Në vitin 2013 Komisioni i Verifikimit të Fakteve konstatoi se kërkuesi kishte bashkëpunuar me organet Shtetërore të sigurisë në vitet 1960, ku ai kishte dhënë informacion për vëllain e tij, gruan e vëllait të tij dhe personat e tjerë që jetonin në Suedi, dhe më pas si kryeredaktor i një gazete, ai u kishte dhënë informacione shërbimeve të sigurisë lidhur me artikujt e kolegut dhe marrëdhëniet e tij me njerëzit e tjerë.

Kërkuesi kundërshtoi vendimin e Komisionit duke argumentuar se konkludimet e tij kishin qenë të gabuara pasi çështja kishte të bënte me një person tjetër me të njëjtin emër dhe jo ai, duke paraqitur disa dokumente të cilat, ndër të tjera, vërtetnin se ai kishte një motër dhe jo një vëlla, dhe se kishte kryer shërbimin ushtarak në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe nuk e kishte vizituar kurrë Suedinë. Për më tepër, ai kundërshtoi vërtetësinë dhe origjinalitetin e disa dokumenteve dhe mohoi çdo bashkëpunim me shërbimet e sigurisë. Së fundmi, ai u ankua se reputacioni, dinjiteti dhe integriteti personal i tij ishte komprometuar me publikimin e vendimit të Komisionit në faqen e saj të internetit. Gjykata Administrative në një seancë dëgjimore të mbajtur privatisht hodhi poshtë kërkesën e kërkuetit, duke konsideruar se Komisioni kishte vërtetuar në mënyrë të saktë faktet dhe kishte zbatuar ligjin përkatës. Në

¹⁴⁴ *Karajanov k. Maqedonisë*, vendim i 6 prillit 2017.

apelim, kërkuesi përsëriti parashtrimet e tij dhe më tej deklaroi se Gjykata Administrative nuk e kishte marrë parasysh dëshminë e tij lidhur me rastin në fjalë, i cili nuk kishte lidhje me të dhe se nuk ishin trajtuar gjatë proceseve kontestuese në praninë e kërkuesit, të ndonjë dëshmitari tjetër ose eksperti, por Gjykata e Lartë Administrative e hodhi poshtë kërkesën e tij dhe la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke mos gjetur arsye për të mos marrë parasysh vërtetësinë e fakteve dhe arsyetimet e dhëna.

Gjykata konstatoi se aspekti civil i nenit 6 ishte i zbatueshëm për proceset kalimtare lidhur me verifikimin e pastërtisë së figurës në rastin në fjalë, për të njëjtat argumente të përcaktuara në vendimin e *Ivanovski v Macedonisë*¹⁴⁵. Gjykata konstatoi se gjykatat e brendshme që kishin shqyrtuar pretendimet e tij për rishikim gjyqësor kishin ushtruar juridiksion të plotë mbi faktet dhe ligji nuk kishte arritur të garantonte një **arsyetim bazuar në lidhje me vërtetësinë e provave kundër tij dhe argumenteve të tij në lidhje me identitetin e gabuar dhe për rrjedhojë ato kishin dështuar në identifikimin e ndonjë çështje konkrete faktike për të vërtetuar dyshimin mbi bashkëpunimin e tij me shërbimet e sigurisë. Mospranimi për të vlerësuar vërtetësinë e provave të paraqitura para tyre dëmtonte ushtrimin e së drejtës së kërkuesit për të paraqitur në mënyrë efektive rastin e tij. Përveç kësaj, kërkuesit i ishte privuar e drejta për një seancë dëgjimore, pavarësisht kërkesës së tij eksplicite në këtë drejtim dhe duke pasur parasysh se çështjet e diskutueshme të fakteve dhe ligjit nuk mund të kishin qenë më mirë në paraqitjen e argumenteve me shkrim sesa argumentet më gojë dhe aty nuk ka pasur ndonjë rrethanë të jashtëzakonshme që justifikonte përjashtimin e një seance dëgjimore. Përfundimisht, u konstata se kërkuesit ju shkel e drejta për t'u dëgjuar drejtësisht.**

Për më tepër, Gjykata konstatoi **shkelje të së drejtës së respektimit të jetës private dhe familjare të kërkuesit, meqë publikimi i vendimit të pastërtisë së figurës (lustracionit) në faqen e internetit të Komisionit**, para se ai të ishte përfundimtar përbënte ndërhyrje, edhe pse ishte në përputhje me Ligjin “Për Hapjen e Dosjeve” të vitit 2012, ai nuk i shërbente asnjë prej qëllimeve legjitime të renditura në nenin 8 § 2 të Konventës, por edhe duke pasur parasysh faktin se kërkuesi ishte shtatëdhjetë e shtatë vjeç kur Komisioni dha vendimin në lidhje me të, periudhë kur ai nuk kishte një zyrë publike dhe as nuk ishte kandidat për ndonjë zyrë të tillë. Gjithashtu, Gjykata i referohet shkurtimit të *amicus curiae* të miratuar nga Komisioni i Venecias, i cili shprehu pikëpamjen e tij se publikimi i vendimit të Komisionit për «Verifikimin e Pastërtisë së Figurës», para se ai të shqyrtohej nga një gjykatë kompetente përbënte shkelje të nenit 8.

Përveç shpërblimit lidhur me dëmin jomaterial të akorduar nga Gjykata, kërkuesi pretendoi rigjykimin e çështjes, dhe Gjykata Administrative e la në fuqi kërkesën e tij për rihapjen e proceseve të kontestuara të mosmarrveshjeve administrative, të cilat ishin parashtruar sipas nenit 43 të Ligjit për Mosmarrëveshjet Administrative. Rihapja e proceseve ishin ende në pritje para Gjykatës Administrative në kohën e botimit të këtij publikimi.

Në rastin e *Qendrës për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike k. Maqedonisë*¹⁴⁶ Gjykata konstatoi **shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me aksesin e mohuar në gjykatë të personit juridik kërkues, si rezultat i rrëzimit të kërkesave të tij lidhur me një kontratë me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore Shtetërore për shkak se nuk ishte i bazuar në procedurë.**

¹⁴⁵ *Ivanovski k. Maqedonisë*, vendim i 21 janarit 2016.

¹⁴⁶ *Qendra për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike k. Maqedonisë*, vendim i 15 Qershorit 2017.

Pasi një klinike psikiatrike private kishte respektuar urdhrin e lëshuar nga Inspektorati i Ministrisë së Shëndetësisë për t'u ri-regjistruar, i ishte caktuar një numër i ri tatimor dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore nuk kishte pranuar të nënshkruante një kontratë të re me praktikën e re, deri sa të përfundonte së qeni e vlefshme kontrata e vjetër. Ndërkohë, klinika e re nisi procedurat e kompensimit kundër Fondit për mospërbushjen e kushteve të kontratës. Gjykatat e brendshme hodhën poshtë kërkesën e shoqërisë kërkuese, duke konstatuar se nuk ishte e bazuar në procedurë pasi klinika e re nuk mund të konsiderohej si pasardhëse e praktikës së mëparshme, pasi kishin numra të ndryshëm tatimorë individualë dhe përbënin persona të ndryshëm juridikë, pavarësisht nga argumentet e kërkuesit për ekzistencën e një marrëdhënieje ligjore dhe vazhdimësisë mes tyre. Duke marrë parasysh praktikën gjyqësore vendase, Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Lartë vlerësoi se, në rrethana pothuajse identike që përfshijnë palë të njëjta dhe kontratë të njëjtë, se kërkuesi kishte të drejtë të padiste për procedurë dhe nuk shihte arsye për t'u larguar nga vendimi i gjykatës më të lartë kombëtare. Për më tepër, në rrethanat e veçanta të rastit, gjykatat vendase vendosën një pengesë procedurale të pajustificueshme ndaj shoqërisë kërkuese duke adoptuar një qasje tepër formale kur hodhën poshtë kërkesat e tyre si të pabazuara, gjë që dëmtoi thelbin e së drejtës së tij për akses në gjykatë dhe nuk i dha asnjë mundësi për të shqyrtuar kërkesat e saj në themel.

Në vijim të shqyrtimit të marrë në rastin *Vikentijević*, në dy vendime¹⁴⁷ të tjera Gjykata konstatoi se shuarja e posaçme e një urdhër-kthimi përfundimtar të dhënë në favor të kërkuesve nuk kishte qenë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe në shkelje të të drejtave të tyre pronësore, për sa kohë që në ushtrimin e kompetencës së tyre për rishqyrtim, gjykatat kompetente kishin arsye të shtuara të një karakteri substancial dhe bindës që justifikonte masën e marrë. Në të dyja rastet, Gjykata konstatoi se masat e ankimuar përbënin një ndërhyrje në pasurinë e kërkuesve, por ato ishin në përputhje me nenin 267 (1) (3) të Ligjit për Mosmarrëveshjet Administrative, që parashikonte që një vendim administrativ i formës së prerë, mund të rrëzohej nëse ishte i pamundur të ekzekutohej. Në rastin *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*,¹⁴⁸ ndërhyrja e bërë me iniciativën e Avokatit të Përgjithshëm për të korrigjuar gabimet thelbësore në llogaritjen e sipërfaqes së tokës në fjalë, sipas vendimit të Komisionit të Kthimit, që e bëri të pamundur ekzekutimin e vendimit të parë të kthimit, nuk ishte i pajustificuar dhe joproporcional edhe pse shuarja ndodhi shtatë vjet pasi vendimi fillestar kishte marrë formë të prerë, duke ndjekur një qëllim legjitim për mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta. Në çështjen *Toleski kundër Maqedonisë*,¹⁴⁹ Gjykata vlerësoi se kërkuesit i ishte hequr e drejta pronës "për një interes publik" dhe autoritetet vepruan pa vonesa për të mbrojtur të drejtat e palëve të treta edhe nëse kishte pasur një "mosveprim të dukshëm". Ndërhyrja e mëvonshme e Avokatit të Përgjithshëm para Komisionit të Kthimit ishte e justifikuar, ku mangësitë ishin vërejtur edhe nga organet e tjera të rishikimit, pasi i kishte shërbyer administrimit të duhur të drejtësisë.

Në rastin *Krstanoski dhe Tërjet k. Maqedonisë*¹⁵⁰ Gjykata konstatoi se autoritetet e kthimit pranuan pretendimet e kërkuesve dhe u dhanë atyre kompensim për sipërafqet e tokës të konfiskuar nga paraardhësit e tyre, bazuar në faktet e vërtetuara nga inspektimet në vend dhe konstatimi se tokat në fjalë nuk mund të ktheheshin në pronësi të kërkuesve dhe si rrjedhim, hodhi poshtë ankesat e kërkuesve sipas nenit 6, që autoritetet e kthimit kishin praktikë të qëndrueshme në lidhje me preten-

147 *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 tetorit 2017; *Toleski k. Maqedonisë*, nr. 17800/10, vendim i 15 qershorit 2017.

148 *Spiridonovska dhe Popovski k. Maqedonisë*, vendim i 19 tetorit 2017.

149 *Toleski k. Maqedonisë*, vendim i 15 qershorit 2017.

150 *Krstanoski dhe Tërjet k. Maqedonisë*, vendim i 7 dhjetorit 2017.

dimet identike si haptazi të pabazuara. Në mënyrë të ngjashme, ai hodhi poshtë ankesat e tyre sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 si të papërshtatshme *ratione materiae*, duke konkluduar se mospranimi i Shtetit për t'ju dhënë kërkuesve titullin e pronësisë nuk përbënte një ndërhyrje në të drejtat e tyre pronësore. Gjykata konstatoi vetëm një **shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të gjyqimeve të brendshme për më shumë se katër vjet në dy nivele të juridiksionit**, veçanërisht duke pasur parasysh se rastet e kërkuesve nuk ishin veçanërisht komplekse dhe se ligji i brendshëm kërkonte që mosmarrëveshjet e kthimit të kishin një vëmendje të veçantë.

Në *Petrović k. Maqedonisë*¹⁵¹, Gjykata konstatoi në shkelje të nenit 6 § 1 lidhur me kohëzgjatjen e procedurave të kthimit, të cilat ishin ende në pritje para Gjykatës së Lartë Administrative kur ishte paraqitur kërkesa. Gjykata përsëriti se ankesa e gjobës në Gjykatën e Lartë përfaqëson një mjet efektiv juridik, siç përcaktohet në rastin *Adži-Spirkoska dhe Të Tjerët*.¹⁵² Ajo refuzoi të vlerësojë ndikimin e saj në procedurat e pezulluara të kthimit pasi kërkuesi nuk e kishte kundërshtuar aspektin përshpejtues të mjetit juridik, duke mos e ngritur atë në kërkesën e tij kundër vendimit të Kolegjit të shkallës së parë të Gjykatës së Lartë. Edhe pse kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës në lidhje me ankesën e kërkuesit ka tejkalar periudhën gjashtëmujore, duke pasur parasysh vonesat në lidhje me transferimin e dosjes, duke qenë se kërkuesi kishte dy shtetësi, Gjykata nuk e konsideronte të paarsyeshme sipas rrethanave të rastit dhe i qëndronte opinionit se zgjidhja joefektive nuk ka qënë në kundërshtim me nenin 13.

Në katër nga 16 vendimet e miratuara kundër Maqedonisë në vitin 2017, Gjykata mori në shqyrtimin themelin e çështjes.

Në vendimin e *Ziberi dhe Të Tjerët*¹⁵³, Gjykata diskutoi mbi paanshmërinë e provave të ekspertëve në lidhje me procesin penal në të cilën kërkuesit ishin dënuar për terrorizëm. Gjykatat vendase i referoheshin vendimit të Gjykatës në çështjen *Stoimenov k. Maqedonisë*¹⁵⁴, duke argumentuar se ajo ishte e pazbatueshme për rastin në fjalë, pasi raportet e ekspertëve ishin hartuar pas një urdhri të gjykatës dhe ato nuk përbënin provën e vetme në këtë rast. Gjykata i kushtoi vëmendje të veçantë faktit se ekspertët kishin dhënë dëshmi me gojë në një seancë dëgjimore të mbajtur para gjykatës, ku përfaqësuesve të kërkuesve iu është dhënë mundësia që t'i ballafaqonin ato, një video-regjistrim ishte bërë gjatë inspektimit të kryer nga policia, dhe inspektimi kishte ndodhur në praninë e një gjyqtari të hetimeve paraprake. Të gjitha këto vlerësime i krijuan bindjen Gjykatës të besonte se kishte mbrojtje të mjaftueshme për të garantuar të drejtat efektive të kërkuesve. Për më tepër, ata kishin dështuar në sigurimin e ndonjë treguesi të mungesës së paanshmërisë ose pavarësisë, ndërsa gjykatat e brendshme kishin dhënë arsyetime të gjera dhe të mjaftueshme për të hedhur poshtë argumentet e kërkuesve kundër metodologjisë së përdorur nga eksperti në rastin e tyre. Në këtë kontekst, Gjykata hodhi poshtë si haptazi të pabazuara kërkesat e kërkuesit, se emërimi si ekspert i anëtarëve të Byrosë së Hetimeve Penale të Ministrisë, të cilët ishin në të njëjtën kohë dhe punonjës të Ministrisë, përbënin shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe procesit të rregullt.

151 *Petrović k. Maqedonisë*, vendim i 22 qershorit 2017.

152 *Adži-Spirkoska dhe Të Tjerët k. Maqedonisë*, vendim i 3 nëntorit 2011.

153 *Ziberi dhe Të Tjerët k. Komitetit Maqedonas*, vendim i 23 majit 2017.

154 *Stoimenov k. Maqedonisë*, vendim i 5 prillit 2007.

Në rastin *Runteva k. Maqedonisë*¹⁵⁵, kërkuesja, e cila ishte dënuar për veprën penale të trafikut, u ankua sipas nenit 5 § 1 se ajo ishte ndaluar për dyzet e shtatë ditë më shumë se masa e ndalimit me burg, dënim që i ishte ulur sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, e zëvendësuar më tej nga falja presidenciale dhe në përputhje me rrethanat ishte konsideruar i paligjshëm dhe shkelte lirin e saj me kusht. Gjykata konkludoi se e gjithë periudha e heqjes së lirisë së saj ishte bazuar në një urdhër të gjykatës dhe ishte e ligjshme në kuptim të nenit 5 § 1 (a) të Konventës. Për më tepër, lidhur me ankesën e saj në bazë të nenit 5 § 5 mbi vendimet e gjykatave vendase që hedhin poshtë kërkesën e saj për kompensim për burgimin e pretenduar si të paligjshëm, Gjykata vuri në dukje se vendimi i procesit të dëmshpërblimit nuk ishte arbitrar ose dukshëm i paarsyeshëm dhe neni 5 § 5 nuk gjente zbatim në rastin konkret, duke marrë parasysh konstatimet e mëparshme të Gjykatës lidhur me ankesën sipas nenit 5 § 1.

Vendimi në çështjen *Gerovska Popčevska k. Maqedonisë*¹⁵⁶, kishte të bënte me proceset që Zyra e të Ardhurave Publike filloi me kërkesë të Komisionit Shtetëror Kundër Korrupsionit, ku Zyra konstatoi se kërkuesja nuk kishte arritur të provonte se fondet monetare të kaluara në llogarinë e saj bankare ishin marrë në mënyrë të ligjshme dhe i kishin vendosur një taksë të tatimit e të ardhurave personale që arrinte në masën 70% të aseteve që ishin raportuar më vonë në Komision. Kërkuesi, një ish-gjyqtar, u ankua për akuzën për të cilën dyshohej dhe zbatimin e ligjit me fuqi prapavepruese të rritjes së taksave. Gjykata konkludoi se duke pasur parasysh natyrën e ndryshimeve në procedurë pas njoftimit të çështjes, në veçanti se vendimi i Ministrisë lidhur me rihapjen e proceseve të kontestuara duhet të kishte përfunduar me anulimin e urdhërpagesës, e cila ishte shpallur nul dhe e pavlefshme *ab initio* dhe kërkuesi kishte aplikuar me sukses për rimbursimin e parave. Efektet e mundshme të situatës për të cilën kërkuesi ishte ankuar, ishin korrigjuar në mënyrë të kënaqshme dhe pas zgjidhjes së çështjes, e hoqi çështjen nga lista e rasteve për gjykim.

Vendimi i *Dejanovik*¹⁵⁷ ka të bëjë me aksesin e një ankese gjyqësore sipas nenit 6, në lidhje me proceset civile dhe penale, të cilat ishin iniciuar nga shoqëria kërkuese kundër një kompanie tjetër, e cila kishte për qëllim marrjen e kompensimit. Ndërsa proceset civile kishin përfunduar në favor të shoqërisë së kërkuesit, asnjë vendim mbi themelin nuk ishte marrë në lidhje me kërkesën e veçantë, por identike me ankesën në procesin penal. Pasi kërkuesi kishte dështuar të vazhdonte çështjen para gjykatave civile, pavarësisht nga drejtimi i qartë nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me këtë rast, Gjykata vendosi që kërkuesit nuk i ishte mohuar qasja në gjykatë lidhur me kërkesën e tij për dëmshpërblim dhe ankesa ishte hedhur poshtë si haptazi e pabazuar.

155 *Runteva k. Maqedonisë*, vendim i Dhomës i 3 tetorit 2017.

156 *Gerovska Popčevska k. Maqedonisë*, vendim i Komitetit i 17 tetorit 2017.

157 *Dejanovik k. Maqedonisë*, vendim i Komitetit i 23 majit 2017.

MALI I ZI

Hyrje

Mali i Zi ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (më poshtë e quajtur: “Konventa”) më 6 qershor 2006. Megjithatë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më poshtë e quajtur: “Gjykata”) gjeti në çështjen *Bijelić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, se përgjegjësia që i takon Malit të Zi është e vlefshme duke filluar prej datës 3 mars 2004, datë e ratifikimit të Konventës nga ish-Federat Serbo-Malazeze.

Më 31 dhjetor 2017, Gjykata, në lidhje me Malin e Zi, ka dhënë 37 vendime dhe 50 vendime pranueshmërie.

Nga një total prej 37 vendimesh të dhëna lidhur me Malin e Zi, Gjykata gjeti në 35 vendime ka pasur shkelje të paktën të një neni të Konventës. Megjithatë, në çështjen *Tomiç dhe të Tjerët k. Malit të Zi*, Gjykata nuk konstatoi asnjë shkelje të nenit 6, sipas pikëpamjes se nuk i takonte të vendoste në pikëpyetje interpretimin e ligjit të brendshëm nga gjykatat kombëtare dhe se në parim nuk ishte funksioni i saj për të krahasuar vendimet e ndryshme të gjykatave kombëtare, edhe nëse janë dhënë sipas procedurave dukshëm të ngjashme; ajo duhet të respektojë pavarësinë e këtyre gjykatave. Gjithashtu, u konsiderua se disa divergjenca të interpretimit mund të pranoheshin si një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor. Megjithatë, dallimet e thella dhe të qëndrueshme në praktikën e gjykatës më të lartë vendase mund të jenë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, një parim që parashikohet në Konventë dhe që përbën një nga elementet themelore të shtetit të së drejtës. *Koprivica k. Malit të Zi*¹⁵⁸, është një vendim që i referohet shpërblimit të drejtë.

Për sa i përket nenit 2 të Konventës (e drejta për jetën), lidhur me Malin e Zi, Gjykata dha një vendim, *Randelović k. Malit të Zi*¹⁵⁹, duke theksuar se detyrimi i parashikuar në nenin 2 për të mbrojtur të drejtën e jetës, imponon një detyrim procedural për të hetuar vdekjen, jo vetëm nga punonjësit shtetërorë, por edhe nga individë të panjohur dhe se qëllimi kryesor i hetimit është “të sigurohet zbatimi efektiv i ligjeve vendase që mbrojnë të drejtën për jetën” dhe të sigurojnë llogaridhënien e përgjegjësve.

Në lidhje me nenin 3 të Konventës (ndalimi i torturës) janë dhënë tri vendime, vendimet *Bulatović k. Malit të Zi*, *Milić dhe Nikezić k. Malit të Zi* dhe *Siništaj dhe Të Tjerët k. Malit të Zi*.¹⁶⁰

Përsa i përket nenit 5 të Konventës (e drejta për liri dhe siguri), janë dhënë dy vendime, në çështjet e *Bulatović k. Malit të Zi* dhe *Mugoša k. Malit të Zi*.¹⁶¹

Në shumicën e rasteve (gjithsej 23), Gjykata gjeti se kishte shkelje të nenit 6 të Konventës. Këto shkelje kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave, ekzekutimin e vendimeve të brendshme dhe aksesin në gjykatë.

158 *Koprivica k. Malit të Zi*, vendim i 23 qershorit 2015.

159 *Randelović k. Malit të Zi*, vendim i 19 shtatorit 2017.

160 *Bulatović k. Malit të Zi*, vendim i 22 korrikut 2014; *Milić dhe Nikezić k. Malit të Zi*, vendim i 28 prillit 2015; *Siništaj dhe Të Tjerët k. k. Malit të Zi*, vendim i 24 nëntorit 2015

161 *Mugoša k. Malit të Zi*, vendim i 21 qershorit 2016.

Në lidhje me nenin 8 të Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), janë dhënë tri vendime – *Mijušković k. Malit të Zi, Antović dhe Mirković k. Malit të Zi* dhe *Alković k. Malit të Zi*.¹⁶²

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës (e drejta e pronës), janë dhënë katër vendime: *Mijanović k. Malit të Zi, A. dhe B. k. Malit të Zi, Bijelić k. Malit të Zi* dhe *Lakićević k. Malit të Zi*.¹⁶³

Gjykata konstatoi, shkelje në dy raste në lidhje me nenin 10 të Konventës (liria e shprehjes), respektivisht: *Koprivica k. Malit të Zi* dhe *Šabanović k. Malit të Zi*.¹⁶⁴

Lidhur me nenin 13 të Konventës (e drejta për një zgjidhje efektive), Gjykata gjeti një shkelje në pesë raste: *Milić k. Malit të Zi dhe Serbisë, Stakić k. Malit të Zi, Mirković dhe 3 Tërë k. Malit të Zi, Đuković k. Malit të Zi* dhe *Sinex d.o.o. k. Malit të Zi*.¹⁶⁵

Përveç kësaj, në lidhje me nenin 14 të Konventës (ndalimi i diskriminimit), Gjykata gjeti shkelje në një rast: *Alković k. Malit të Zi*.¹⁶⁶

Vendime të në 2017

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në 2017 vendosi në 19 raste kundër Malit të Zi. Nga këto 19 raste, 13 ishin vendime dhe gjashtë ishin vendime për pranueshmërinë.

Për sa i përket vendimeve, Gjykata, në pesë prej tyre, vendosi si Dhomë e përbërë nga shtatë gjyqtarë, në çështjet *Mirković dhe Tërë k. Malit të Zi, Randelović k. Malit të Zi, Tripčević k. Malit të Zi, Antović dhe Mirković k. Malit të Zi* dhe *Alković k. Malit të Zi*, ndërsa mbi tetë çështjet e tjera u dha vendimi nga një Komitet i përbërë nga tre gjyqtarë – çështjet *Đuković k. Malit të Zi, Svorcan k. Malit të Zi, Tomašević k. Malit të Zi, Jovović k. Malit të Zi, Sineks d.o.o. k. Malit të Zi, Vučinić k. Malit të Zi, Nedić k. Malit të Zi* dhe *Dimitrijević k. Malit të Zi*.

Gjatë vitit 2017 ka pasur gjashtë vendime për pranueshmërinë, dy prej të cilave janë dhënë nga një Dhomë e përbërë nga shtatë gjyqtarë: *Čalović k. Malit të Zi* dhe *Kolosov k. Malit të Zi*, ndërsa në katër rastet e tjera u vendos nga një Komitet prej tre gjyqtarësh: *Šćepanović k. Malit të Zi, Minić k. Malit të Zi, Darmanović k. Malit të Zi* dhe *Petrović k. Malit të Zi*.

162 *Mijušković k. Malit të Zi*, vendim i 21 shtatorit 2010; *Antović dhe Mirković k. Malit të Zi*, vendim i 28 nëntorit 2017; *Alković k. Malit të Zi*, vendim i 5 dhjetorit 2017.

163 *Mijanović k. Malit të Zi*, vendim i 17 shtatorit 2013; *A. dhe B. k. Malit të Zi*, vendim i 5 marsit 2013; *Bijelić k. Malit të Zi dhe Serbia*, vendim i 28 prillit 2009 dhe *Lakićević dhe Tërë k. Malit të Zi*, vendim i 21 shtatorit 2010.

164 *Koprivica k. Malit të Zi*, vendim i 22 nëntorit 2011; *Šabanović k. Malit të Zi*, vendim i 31 majit 2011.

165 *Milić k. Malit të Zi dhe Serbisë*, vendim i 11 dhjetorit 2012; *Stakić k. Malit të Zi*, vendim i 2 tetorit 2012; *Đuković k. Malit të Zi*, vendim i 13 qershorit 2017; *Mirković dhe 3 Tërë k. Malit të Zi*, vendim i 13 qershorit 2017; *Sineks d.o.o. k. Malit të Zi*, vendim i 5 shtatorit 2017.

166 *Alković k. Malit të Zi*, vendim i 5 dhjetorit 2017.

Stanka Mirković dhe Të Tjerët k. Malit të Zi, vendimi i 7 marsit 2017 – shkelje të konstatuara të nenit 6 dhe 13 të Konventës

Ky rast kishte të bënte me kohëzgjatjen e proceseve civile ku ishin përfshirë kërkuesit, të cilët kishin paraqitur një kërkesë pranë Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, duke kërkuar kompensim për tokën e shpronësuar nga paraardhësi i tyre ligjor në vitin 1946. Midis dhjetorit 2004 dhe dhjetorit 2015, çështja e kërkuesve ishte ripërsëritur vazhdimisht dhe ishte pushuar. Duke u bazuar në nenin 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme) dhe nenin 13 (e drejta për një mjet efektiv ligjor), kërkuesit u ankuan për kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit administrativ.

Gjykata vuri në dukje se as kompleksiteti i çështjes dhe as sjellja e kërkuesve nuk shpjegojnë kohëzgjatjen e proceseve administrative, të cilat zgjatën 10 vjet e 6 muaj e 11 ditë, kur gjykatat dhanë njëzet e një vendime dhe e kthyen çështjen nëntë herë.

Gjykata konsideroi se, edhe në qoftë se procedurat mund të ishin zgjatur paksa në këtë rast, kjo nuk do të kishte parandaluar përsëritjet e vazhdueshme të çështjes dhe vonesën e përgjithshme. Një kërkesë për rishqyrtim nuk mund të kishte përshpejtuar procedurat para organeve të ndryshme administrative, as nuk mund të kishte parandaluar përsëritjet e vazhdueshme dhe vonesën e përgjithshme e të vazhdueshme të çështjes.

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për kohëzgjatjen e procedurave para organeve administrative, si dhe të nenit 13 të Konventës për mungesë të mjeteve efektive ligjore.

Randelović k. Malit të Zi, vendimi i 19 shtatorit 2017 – shkelje e aspekteve procedurale të nenit 2

Kërkuesi u ankua se autoritetet malazeze kishin dështuar në zhvillimin e një hetimi të shpejtë dhe efektiv për vdekjen ose zhdukjen e anëtarëve të familjes së kërkuesit. Anëtarët e familjes kishin hipur në një anije në bregdetin e Malit të Zi, me synimin për të arritur Italinë; megjithatë, anija u mbyt në gusht 1999. Kërkuesi u ankua në bazë të neneve të ndryshme të Konventës, se organet përkatëse malazeze nuk arritën të hetojnë menjëherë dhe në mënyrë efektive vdekjet dhe/ose zhdukjet e anëtarëve të familjes së tyre dhe ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës.

Detyrimi në nenin 2, për të mbrojtur të drejtën e jetës imponon një detyrim procedural ndaj Shtetit për të hetuar vdekjet, jo vetëm kur ndodhin në duart e agjentëve shtetërorë, por edhe në duart e individëve privatë ose të panjohur.

Ndonëse mund të ketë pengesa ose vështirësi që cenojnë përparimin në një hetim në një situatë të caktuar, një përgjigje e menjëhershme nga ana e autoriteteve në hetimin e një shkeljeje të pretenduar të së drejtës për jetë, përgjithësisht konsiderohet si thelbësore për garantimin e besimit të publikut dhe në respektimin e shtetit të së drejtës dhe parandalimin e shfaqjes së fshehtësisë ose tolerancës së veprimeve të paligjshme.

Kalimi i kohës në mënyrë të pashmangshme dëmton sasinë dhe cilësinë e dëshmive në dispozicion dhe mungesa e kujdesit hedh dyshime mbi mirëbesimin e hetimit.

Në nenin 2, rastet në lidhje me proceset e ngritura për të sqaruar rrethanat e vdekjes së një individi, kohëzgjatja e proceseve është një tregues i fortë se ato kanë qenë të dëmtuara deri në pikën që përbën shkelje të detyrimeve procedurale të Shtetit të paditur sipas Konventës.

Gjykata konsideroi në këtë rast të veçantë se vonesat nuk mund të konsideroheshin të pajtueshme me detyrimin e Shtetit sipas nenit 2 dhe se hetimi dhe procedurat penale të mëvonshme nuk kishin respektuar kërkesat e një procesi të shpejtë dhe efikas.

Prandaj, Gjykata gjeti një shkelje të aspektit procedural të nenit 2 të Konventës.

Tripčović k. Malit të Zi, vendimi i 7 nëntorit 2017 – shkelje të nenit 6

Kërkuesit ishin bashkëpronarë të dy tokave në Malin e Zi. Fqinji i tyre kishte ndërtuar një gardh metalik që kalonte mbi pronën e kërkuesve, duke e bërë të pamundur aksesin nga një njera tokë në tjetrën. Në qershor të vitit 2011, kërkuesit paraqitën çështjen në gjykatë për shkelje dhe fqinji u urdhërua të hiqte gardhin. Më pas, në dhjetor 2011, Gjykata e Lartë anuloi vendimet e mëparshme në bazë arsyetimit se kërkuesit paraqitën kërkesën e tyre në ditën e parë të hapjes së gjykatave pas një festë dy-ditore, pra jashtë afatit. Duke u bazuar në nenin 6 § 1 (e drejta për tu dëgjuar drejtësisht) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës), kërkuesit u ankuan se vendimi ishte i padrejtë për shkak të arsytimit të pamjaftueshme – si edhe për sa i takon arsyes se, në rastin e tyre, nuk zbatohet afati kohor që mbaron ditën e parë të punës pas një festë kombëtare.

Vendimet e gjykatave duhet të pohojnë në mënyrë adekuate arsyetimet mbi cilat janë bazuar. Shkalla në të cilën zbatohet ky detyrim, për të dhënë arsyet, mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet nën dritën e rrethanave të çështjes. Është gjithashtu thelbësore për autoritetet kombëtare, veçanërisht gjykatat, që të zgjidhin problemet e interpretimit të së drejtës së brendshme.

Nuk është roli i Gjykatës që të vendosë në pikëpyetje interpretimin e së drejtës të brendshme të gjykatave të vendit, ose të merret me gabimet e fakteve apo ligjit që pretendohet se janë kryer nga një gjykatë kombëtare, nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa, dhe nëse interpretimi i ligjit të brendshëm është arbitrar ose dukshëm i paarsyeshëm. Roli i Gjykatës është i kufizuar për të konstatuar nëse efektet e këtij interpretimi janë në përputhje me Konventën.

Në nenin 108 të Kodit të Procedurës Civile të Malit të Zi përcaktohet, me terminologji të qartë, se afati për dorëzimin e ankesave skadon në ditën e parë të punës pas pushimit kombëtar. Nuk kishte arsye të vlefshme në arsyetimin e Vendimit të Gjykatës së Lartë ose vërejtjet e Qeverisë se përse kjo dispozitë nuk do të zbatohet në çështjen në fjalë.

Prandaj, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Antović dhe Mirković kundër Malit të Zi, vendimi i 28 nëntorit 2017 – shkelje e nenit 8

Ky rast ka të bëjë me një ankesë për të drejtën e respektimit të jetës private nga dy profesorë të Departamentit të Matematikës në Universitetin e Malit të Zi, pasi në auditoret e tyre ishin instaluar video mbikqyrëse. Kërkesit argumentuan se kjo përbënte shkelje të të drejtave e tyre sipas nenit 8.

Auditoret e Universitetit janë vendet e punës së profesorëve. Vendi ku ata jo vetëm u japin mësim studentëve, por edhe bashkëveprojnë me ta, duke zhvilluar kështu marrëdhënie të ndërsjella dhe duke ndërtuar identitetin e tyre social. Është konsideruar tashmë se survejimi i fshehtë i një punonjësi në vendin e tij të punës duhet të konsiderohet, si një ndërhyrje e konsiderueshme në jetën private të punonjësit.

Çdo ndërhyrje mund të justifikohet vetëm në bazë të nenit 8 § 2 nëse është në përputhje me ligjin, ndjek një ose më shumë qëllime legjitime të cilave u referohet kjo dispozitë dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur këtë qëllim. Gjykata vuri në dukje se gjykatat vendase nuk shqyr-tuan çështjen e veprave që ishin në përputhje me ligjin, duke pasur parasysh se ato nuk e konsideronin survejimin me video të kundërshtuar si një ndërhyrje në jetën private të kërkesve.

Prandaj, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8.

Alković k. Malit të Zi, vendimi i 5 dhjetorit 2017 – shkelje të nenit 8 në lidhje me nenin 14

Ky rast kishte të bënte me ngacmimin e një burri mysliman rom dhe familjes së tij, ngacmim ky i bërë nga fqinjët e tyre. Duke u mbështetur në veçanti në nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare dhe banesës) të marrë në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit), z. Alković u ankua për dështimin e autoriteteve për të hetuar në mënyrë efektive serinë e sulmeve kundër tij nga fqinjët.

Që një “hetim të konsiderohet efektiv”, në parim duhet të jetë në gjendje të vërtetetojë faktet e rastit dhe identifikimin dhe ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës.

I takon autoriteteve sipas nenit 14, i marrë së bashku me nenet 2, 3 ose 8, për të hetuar ekzistencën e një lidhjeje të mundshme mes qëndrimeve raciste dhe akteve të dhunshme. Kur në një hetim për veprime të dhunshme del në pah një provë abuzimi raciste verbale, duhet të kontrollohet dhe konfirmohet, përmes një shqyrtimi të plotë të të gjitha fakteve për të zbuluar çdo motiv racist të mundshëm për dhunën.

Mënyra e zbatimit të mekanizmave penale nga autoritetet gjyqësore ishte e mangët, në rastin në fjalë, deri në pikën që përbënte shkelje të detyrimeve të shtetit të paditur sipas nenit 8 të Konventës.

Prandaj, Gjykata gjeti një shkelje të nenit 8 në lidhje me nenin 14 të Konventës.

Ćalović k. Malit të Zi, vendim i 14 shtatorit 2017 – kërkesa e shpallur e papranueshme

Kërkesa kishte të bënte me marrëveshjen ndërmjet policisë dhe një kompanie telekomunikacioni, që garantonte aksesin e plotë në bazën e të dhënave.

Kërkesa është shpallur e papranueshme, në kundërshtim me qëllimin e së drejtës për kërkesat individuale sipas nenit 34 dhe nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Kërkuesi nuk i kishte paraqitur Gjykatës një shpjegim mbi arsyen përse nuk kishte dhënë informacion mbi përfundimin e proceseve civile në të cilat marrëveshja e kundërshtuar ishte shpallur nul dhe e pavlefshme ose në lidhje me proceset në gjykatat vendase, të cilat do të kishin një ndikim në kërkesën përpara Gjykatës për të Drejtat të Njeriut.

Për rrjedhojë, Gjykata e shpalli të papranueshme kërkesën.

Kolosov k. Malit të Zi, vendim i 28 shtatorit 2017 – kërkesë e shpallur e papranueshme

Kërkesa ka të bëjë me proceset e divorcit dhe masat e përkohshme në lidhje me pronën, si dhe kërkesën lidhur me aksesin në gjykatë dhe mbrojtjen e pronës.

Vendimi i Gjykatës së Lartë në Podgoricë, ku ankesa e kërkuesit u hodh poshtë nuk ishte arbitrar ose haptazi i pabazuar.

Gjithashtu, Gjykata ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të së drejtës për procs të rregullt dhe të drejtës për gëzim paqësor të posedimit, duke vërejtur se kërkuesi nuk e kishte paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Për rrjedhojë, Gjykata e shpalli kërkesën si të papranueshme.

Çështjet JKGJ (Jurisprudenca e Konsoliduar e Gjykatës):

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në tetë raste të vendosura nga Komiteti me tre gjyqtarë, mori vendim në ato raste ku konstatoi shkelje të afatit të arsyeshëm kohor në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

SERBIA

Hyrje

Republika e Serbisë e ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 3 Mars 2004.

Me 31 dhjetor 2017, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ-ja) ka marrë 179 vendime të formës prerë¹⁶⁷ kundër Serbisë dhe 520 vendime pranueshmërie. Nga këto vendime, Gjykata ka vendosur kundër Serbisë në 167 raste.¹⁶⁸ Komiteti me 3 gjyqtarë ka vendosur për 65 raste, si raste të përsëritura dhe ku Gjykata është shprehur njëherë për to. Dhoma prej 7 gjyqtarësh ka gjykuar 112 raste, dhe vetëm 2 vendime janë marrë nga Dhoma e Madhe. Për vendimet e pranueshmërisë, 397 çështje janë gjykuar nga Komiteti dhe 123 çështje nga Dhoma.

Ndaj Serbisë janë dhënë 136 vendime lidhur me nenin 6 të Konventës, e drejta për një proces të drejtë ligjorë. Gjykata gjeti shkelje të këtij neni në 129 raste. Në më të shumtën e rasteve, shkeljet e nenit 6 kishin të bënin me tejzgjatjen e proceseve ligjore dhe mungesën e forcimit ligjorë të vendimeve vendase. Nga gjykimi i këtyre rasteve u evidentuan gjithashtu edhe probleme në përdorimin e dëshmimeve¹⁶⁹ gjatë një procesi gjyqësor, përkufizimi e paanësisë nga ana e gjykatave¹⁷⁰, gjykimet e dretja për çëshjtet penale¹⁷¹, mungesa e qartësisë ligjore si dhe humbja e besimit të publikut në sistemin gjyqësorë¹⁷². Pati probleme gjithashtu në të drejtën e publikut për tu dëgjuar¹⁷³, në prezumimin e pafajësisë¹⁷⁴, në formimin e trupave gjyqësore¹⁷⁵, procederat për zotësinë ligjore¹⁷⁶, si dhe në të drejtën për akses në gjykatë, ku sipas ligjit vendas egzistojnë edhe disa përjashtime ligjore¹⁷⁷.

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, me të drejtën e gëzimit të pronës, Gjykata ka marrë 74 vendime ndaj Serbisë. Nga këto vendime, në 73 prej tyre Gjykata gjeti shkelje të këtij neni¹⁷⁸. Pjesa më e madhe e çështjeve kishin të bënin me ndërhyrjet e pamjaftueshme të organave vendore në forcimin e vendimeve gjyqësore mbi ndërtimet me pronësi shoqërore. Rasti i parë i paraqitur ishte

167 Numri i vendimeve në këtë materialë përfshin vendimet e marra nga Komiteti prej 3 Gjyqtarësh për çështjet e ashtëquajtura "të përsëritura", vendimet e mara nga Dhoma prej 7 gjyqtarësh dhe vendimet e Dhomës së Madhe me 17 gjyqtarë.

168 Vendimet ku nuk u gjetën shkelje janë: *Damjanović k. Serbisë*, vendim i 18 nëntorit 2008; *Molnar Gabor k. Serbisë*, vendim i 8 dhjetorit 2009; *Juhas Đurić k. Serbisë*, vendim i 7 qershorit 2011; *Dobrić k. Serbisë*, vendim i 21 qershorit 2011; *Mitić k. Serbisë*, vendim i 22 janarit 2013; *Luković k. Serbisë*, vendim i 26 marsit 2013; *Đekić dhe Të Tjerët k. Serbisë*, vendim i 29 prillit 2014; *Stanković dhe Trajković k. Serbisë*, vendim i 22 dhjetorit 2015; *Cupara k. Serbisë*, vendim i 12 korrikut 2016; *Zdravković k. Serbisë*, vendim i 20 shtatorit 2016 dhe *Cvetković k. Serbisë*, vendim i 7 shkurtit 2017.

169 Vendimi i 19 Qershorit 2012, *Hajnal k. Serbisë*.

170 Vendimi i 3 Nëntorit 2011, *Šorgić k. Serbisë*.

171 Vendimi i 18 Tetorit 2011, *Stanimirović k. Serbisë*.

172 Vendimi i 1 Dhjetorit 2009, *Vinčić dhe të tjerë k. Serbisë*; Vendimi i 5 Tetorë 2010, *Rakić dhe të tjerë k. Serbisë* dhe Vendimi i 13 Dhjetorit 2011, *Živić v dhe të tjerë k. Serbisë*.

173 Vendimi i 8 Qershorit 2010, *Motion Pictures Guarantors Ltd k. Serbisë*.

174 Vendimi i 19 Shtatorit 2006, *Matijašević k. Serbisë*.

175 Vendimi i 2 Prillit 2013, *Momčilović k. Serbisë*.

176 Vendimi i 13 Tetorit 2009, *Salontaji Drobnjakk. Serbisë*.

177 Vendimi i 11 Shkurtit 2014, *Maširević k. Serbisë*.

178 Vendimi i 8 Dhjetorë 2009, asnjë shkelje nuk u gjet në çështjen *Molnar Gabor k. Serbisë*.

Kaçapor dhe të tjerë kundër Serbisë.¹⁷⁹ Pas këtij rasti janë gjykuar edhe 63 raste të ngjashme, ku një pjesë e mirë e vendimeve janë marrë nga Komitetet prej 3 gjyqtarësh, si raste që tashmë Gjykata është shprehur njëherë.¹⁸⁰ Ndër rastet në shkelje, Gjykata gjeti shkelje të këtij neni edhe në dy çështje ku shteti kishte cenuar të drejtën e pensionit¹⁸¹ si dhe nuk kishte marrë masa për një ndërtim pa leje.¹⁸² Gjykata gjithashtu, me anë të Dhomës së Madhe, në rastin pilot të *Ališić dhe të tjerë kundër Serbisë*¹⁸³, ku shteti i kishte privuar kërkuesve që të përdornin kursimet e tyre për më shumë se 20 vite, vendosi që kjo cenonte nenin 1 të Protokollit 1 dhe për këtë arsye qeveria e Sllovenisë dhe Serbisë ndërmorën disa ndryshime ligjore për të shmangur shkeljet e mëtejshme. Në 28 dhjetor 2016, qeveria e Serbisë miratoi një ligj që zbatonte vendimin e Gjykatës mbi çështjen në fjalë. Në një vendim të kohëve të fundit, Gjykata vendosi se për çështjen *Muratović*¹⁸⁴ ishte zbatuar ligji i miratuar nga parlamenti serb mbi çështjen *Ališić dhe të tjerë*. Për rastin e *Grudić*¹⁸⁵ shteti kishte cenuar të drejtat e kërkuesit duke ndërhyrë në gëzimin e të mirave që zotëronte. Gjykata u shpreh se në këtë rast, për shkak të këndvështrimeve të Ministrisë vendase, kërkuesit që jetonin nuk mund të merrnin pensionin, që me ligj duhej të shpërndahej në vendin ku jetonin. Edhe për rastin *Skenderi dhe të tjerë*¹⁸⁶, kemi të bëjmë me problematikë të ngjashme me rastin e lartpërmendur, por me disa ndryshime. Gjykata u shpreh se në këtë rast, kërkesa e kërkuesit të parë ishte e papranueshme dhe se kufizimi për një afat ligjor prej 3 vitesh ishte i ligjshëm, proporcional dhe kishte qëllime të arsyeshme¹⁸⁷. Në fund, Gjykata e rrëzoi tërësisht kërkesën e tyre, duke qenë se kërkuesit nuk kishin ezauruar deri në fund mjetet e brendshme ligjore¹⁸⁸, siç ishte Gjykata Kushtetuese vendase. Me 7 dhjetor 2017, Këshilli i Ministrave miratoi një rezolutë mbi zbatimin e vendimit mbi çështjen *Grudić* dhe ndërpreu shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes *Skenderi dhe të tjerë*¹⁸⁹.

Mbi nenin 3 të Konventës, ndalimin e keqtrajtimit, Gjykata ka marrë 9 vendime ndaj Serbisë. Vetëm në 6 raste janë gjetur shkelje të këtij neni¹⁹⁰. Problematikat që shfaqen në këto raste kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterëve ligjore përsa i përket hetimeve¹⁹¹ si dhe për aftësinë e autoriteteve vendase për të pikasur në kohën e duhur rreziqet dhe marrjen e masave të duhura për parandalimin e tyre¹⁹². Në rastin *Habimi*, pavarësisht se neni 3 ishte cenuar nga ana procedurale, Gjykata nuk arriti të gjente një

179 Vendimi i 15 Janarit 2008, *Kaçapor dhe të tjerë k. Serbisë*.

180 42 vendime janë dhënë përmes procedurës së gjykimit të çështjeve bazuar në zgjidhjen e dhënë nga Gjykata për çështje të ngjashme me to, dhe të gjithë këto çështje kishin të bënin me mos miratimin e vendimeve mbi ndërtesat me pronësi shoqërore. Në një pjesë të mirë të rasteve, çështjet u mbyllën me anë të marrëveshjeve mes palëve.

181 Vendimi i 8 Tetorit 2013, *Pejić k. Serbisë*; Vendimi i 10 Dhjetorit 2013, *Krstić k. k. Serbisë*.

182 Vendimi i 25 Nëntorit 2008, *Kostić k. Serbisë*.

183 Vendimi i Dhomës së Madhe i 14 Korrikut 2014, *Ališić dhe të tjerë k. Bosnje Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Maqedonisë*.

184 Vendimi i 21 Marsit 2017, *Muratović k. Serbisë*.

185 Vendimi i 27 Prillit 2012, *Grudić k. Serbisë*.

186 Vendimi i 4 Korrikut 2017, *Skenderi dhe të tjerë k. Serbisë*.

187 *Ibid*, §§ 99-102.

188 *Ibid*, §§ 103-109.

189 [http://hudoc.exec.coe.int/eng#{"EXECIdentifier":\["001-179894"\]}](http://hudoc.exec.coe.int/eng#{)

190 Vendimi i 23 Shkurtit 2010, mbi çështjen *Dermanović k. Serbisë* nuk u gjet asnjë shkelje, Vendimi i 5 Shkurtit 2013, *Otašević k. Serbisë* dhe Vendimi i 29 Prillit 2014, *Dekić dhe të tjerë k. Serbisë*.

191 Vendimi i 19 dhjetorit 2017, *Krsmanović k. Serbisë*; Vendimi i 3 Qershorit 2014, *Habimi dhe të tjerë k. Serbisë*; Vendimi i 7 Janarit 2014, *Lakatoš dhe të tjerë k. Serbisë*; Vendimi i 19 Qershorit 2012, *Hajnal k. Serbisë*; Vendimi i 18 Tetorit 2011, *Stanimirović k. Serbisë*.

192 Vendimi i 14 Dhjetorit 2010, *Milanović k. Serbisë*.

shkelje të plotë të nenit për shkakun kryesor se hetimi ishte kryer në mënyrë të papërshtatshme nga ana e autoriteteve vendase¹⁹³. Mbi çështjen *Hajnal*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 3, si nga ana procedurale ashtu dhe në tërësi¹⁹⁴. Për çështjen e *Milanović*¹⁹⁵, Gjykata gjeti shkelje të nenit 3 ashtu dhe të nenit 14 i marrë së bashku me nenin 3 të Konventës.

Mbi nenin 2, e drejta e jetës, Gjykata ka marrë 4 vendime ndaj Serbisë, ku në 3 prej tyre¹⁹⁶ ka gjetur shkelje të nenit 2 të Konventës. Në rastin e *Mučibabić* Gjykata gjeti shkelje ligjore duke qenë se gjatë ushtrimit të detyrave shtetërore pati humbje jete dhe se autoritetet vendase nuk kishin plotësuar mjaftueshëm kriteret procedurale për hetimin e kësaj ngjarje¹⁹⁷. Për çështjen e *Mladenović*¹⁹⁸, autoritetet vendase kishin mangësi në zbatimin e procedurave detyruese hetimore dhe gjithashtu kishte mangësi ligjore e tërë procedura në vetvete. Rasti *Petrović*¹⁹⁹, kishte të bënte me mungesën e profesionalizmit nga ana e autoriteteve vendase përsa i përket paanshmërisë, gadishmërisë dhe hetimin e detajuar të fakteve që zotëronin.

Gjykata ka marrë 7 vendimi rreth nenit 5 të Konventës, e drejta për liri dhe siguri, ku në 6 raste ka hasur shkelje të këtij neni²⁰⁰. Problematikat e evidentuara nga Gjykata kanë të bëjnë me rastet e nevojës për mbajtjen në ambientet e paraburgimit të një personi dhe kur mund të përdoren mënyra të tjera kufizuese²⁰¹, problematikë mbi mënyrën e paraqitjes së akuzuarit përpara një Gjykate apo organeve të tjera ligjore²⁰², prezumimi i pafajsisë²⁰³ si dhe rastet kur dikush dënohet mbi bazën e vendimeve të panjohura ligjorisht²⁰⁴ nga shteti në fjalë.

Për nenin 8 të Konventës, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, Gjykata ka marrë 15 vendime ndaj Serbisë. Nga këto vendime, në 12 prej tyre janë gjetur shkelje të këtij neni²⁰⁵. Problematikat që u hasën në këto çështje kishin të bënin me detyrimin ligjorë pozitivë që kishte shteti për bashkimin e fëmijëve me prindërit²⁰⁶, neglizhenca në kontrollin e zotësisë ligjore²⁰⁷, ndërhyrje të padrejta në korrespondencën e të burgosurve²⁰⁸, mungesa e përcaktimit drejtë të atësisë²⁰⁹, mungesa e mjeteve proce-

193 Vendimi i 3 Qershorit 2014, *Habimidhe të tjerë k. Serbisë*.

194 Vendimi i 19 Qershorit 2012, *Hajnal k. Serbisë*.

195 Vendimi i 14 Dhjetorit 2010, *Milanović k. Serbisë*.

196 Vendimi i 22 Janarit 2012, *Mitić k. Serbisë*, çështja kishte të bënte me vetvrasjen e një të burgosuri dhe Gjykata nuk gjeti shkelje të Konventës bazuar në nenin 2 të saj.

197 Vendimi i 12 Korrikut 2016, *Mučibabić k. Serbisë*.

198 Vendimi i 22 Majit 2012, *Mladenović k. Serbisë*.

199 Vendimi i 15 Korrikut 2014, *Petrović k. Serbisë*.

200 Në vendimin e 23 Marsit 2013 nuk u gjet asnjë shkelje, një çështje që kishte të bënte me tejkalimin e kohës së qëndrimit të kërkuesit në ambientet e paraburgimit.

201 Vendimi i 7 Januarit 2014, *Lakatoš dhe të tjerë k. Serbisë*; Vendimi i 23 Shkurtit 2010, *Dermanović k. Serbisë*.

202 Vendimi i 28 Prillit 2009, *Milosević k. Serbisë*.

203 Vendimi i 23 Shtatorit 2008, *Vrenčev k. Serbisë*.

204 Vendimi i 21 Marsit 2017, *Mitrović k. Serbisë*.

205 Vendimi i 18 Nëntorit 2008, Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje në *Damnjanović k. Serbisë*; Vendimi i 20 Shtatorit 2016, *Zdravković k. Serbisë* dhe Vendimi i 7 Shkurtit 2017, *Cvetković k. Serbisë*.

206 Vendimi i 20 Shtatorit 2016, *Zdravković k. Serbisë*; Vendimi i 13 Prillit 2010, *Krivošej k. Serbisë*; Vendimi i 26 Qershorit 2007, *Tomić k. Serbisë*.

207 Vendimi i 13 Tetorit 2009, *Salontaji-Drobnjak k. Serbisë*.

208 Vendimi i 19 Majit 2009, *Stojanović k. Serbisë*.

209 Vendimi i 17 Korrikut 2007, *Jevremović k. Serbisë*.

durale që iu vinë në ndihmë ankuesve²¹⁰, dhe pamundësia e prindërve për të qenë në dijeni të fatit të fëmijëve të tyre²¹¹. Ndër rastet e gjykuara, problemë ka shfaqur edhe zbatimi i masava ligjore në sferën e marrëdhënieve private mes individëve, për të garantuar integritetin e tyre fizikë dhe moralë²¹². Në çështjen e *Zorica Jovanović*²¹³ Gjykata gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës si pasojë e dështimit të shtetit për të garantuar prindërve sigurinë dhe dijeninë për fatin e fëmijës tyre të sapolindur, duke qenë se ky fëmijë ishte shpallur i vdekur. Gjykata e urdhëroi Serbinë që brënda 1 viti të merrte masa ligjore me anë të një ligji të veçantë (*lex specialis*), që do të shërbente për zgjidhjen e të gjithë rasteve e ngjashme në të ardhmen. Në tetor të vitit 2016, Ministria e Drejtësisë hartoi një projektligj për rastin në fjalë. Projektligji nuk u miratua dhe në shtator të vitit 2017, Këshilli i Ministrave miratoi një rezolutë të brendshme. Në dhjetor 2017, Këshilli i Ministrave mori një vendim ku i kërkonte të gjithë autoriteteve serbe që të merrnin masa urgjente për vënien në zbatim të projektligjit të hartuar nga Ministria e Drejtësisë.

Në lidhje me nenin 10 të Konventës, e drejta për tu shprehur lirshëm, Gjykata gjykoj 7 raste dhe në të gjitha rastet gjeti shkelje të këtij neni. Nga rastet e gjykuara, u gjetën shkelje në respektimin e të drejtës për privatësi si në sferën private ashtu dhe në atë publike²¹⁴, në rëndësinë që kishte detyra e gazetarit si një vëshgues i pavarur mbi autotitetet shtetërore²¹⁵, fakti që ky nen mbron mendimet apo idetë me nota ofenduese, shokuese apo shqetësuse për publikun²¹⁶, egzistenca e mekanizmave të drejtë gjykesë dhe denuesë²¹⁷, si dhe e drejta thelbësore që gëzojnë partitë politike apo aktivistë të ndryshëm për të shprehur mendimet e tyre, veanërisht gjatë fushatave zgjedhore²¹⁸. Probleme u evidentuan edhe në kërkesat mbi operatorët për informacione elektronike²¹⁹, dhe nëse masat që ishin marrë ndaj ndihmësve ligjorë të kërkuesve për shpifje ishin të nevojshme dhe proporcionale²²⁰.

Gjykata është shprehur me dy vendime në lidhje me nenin 14 të Konventës. Në çështjen e *Milanović*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 marrë sëbashku me nenin 3 të Konventës²²¹. Për *Vučković kundër Serbisë*, pavarësisht se sipas Gjykatës kishte shkelje të nenit 14, Dhoma e madhe rrëzoi kërkesën duke qenë se kërkuesi nuk kishte ezauruar të gjithë mundësitë ligjore për zgjidhjen e problemit nga autoritetet vendase²²². Në çështjen *Paunović and Milivojević*²²³ Gjykata gjeti shkelje në nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës, duke qenë se përfundimi i mandatit të kërkuesit nuk kishte baza ligjore. Shkelje të nenit 4 të Protokollit 7 është gjetur në çështjen *Milenković*²²⁴, për shkak të zhvillimit dy herë të së njëjtës procedurë ligjore.

210 Vendimi i 13 Marsit 2007, *VAM k. Serbisë*.

211 Vendimi i 26 Marsit 2013, *Zorica Jovanović k. Serbisë*.

212 Vendimi i 1 Korrikut 2014, *Isaković Vidović k. Serbisë*.

213 Vendimi i 26 Marsit 2013, *Zorica Jovanović k. Serbisë*.

214 Vendimi i 20 Nëntorit 2007, *Bodrožić dhe Vujin k. Serbisë*, dhe Vendimi i 4 Prillit 2017, *Milislavljević k. Serbisë*.

215 *Ibid.*

216 Vendimi i 23 Qershorit 2009, *Bodrožić k. Serbisë*.

217 Vendimi i 20 Nëntorit 2007, *Filipović k. Serbisë*.

218 Vendimi i 6 Nëntorit 2007, *Lepojić k. Serbisë*.

219 Vendimi i 25 Qershorit 2013, *Youth Initiative for Human Rights k. Serbisë*.

220 Vendimi i 11 Shkurtit 2014, *Tešić k. Serbisë*.

221 Vendimi i 14 Dhjetorit 2010, *Milanović k. Serbisë*.

222 Vendimi i 28 Gushtit 2012 and vendimi i 25 Marsit 2014 i Dhomës Madhe, *Vučković k. Serbisë*.

223 Vendimi i 24 Majit 2016

224 Vendimi i 1 Marsit 2016.

Vendime gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017 Gjykata mori 26 vendime kundër Serbisë. Në 25²²⁵ çështje ajo gjeti shkelje të Konventës. Përsa i përket organeve që shqyrtuan çështjet, 21 vendime u morën nga Komitetet prej 3 gjyqtarësh duke qenë se ishin raste të përsëritura ku Gjykata ishte shprehur më parë dhe 5 vendime u morën nga Dhoma²²⁶.

Nga çështjet e gjykuara, në 13 prej tyre Gjykata evidentoi shkelje të së drejtës për një kohëzgjatje të arsyeshme të gjykimit (neni 6) dhe të drejtës së pronës (neni 1 I Protokollit 1), për shkak të mungesës së zbatimit të vendimeve vendase për pronat me pronësi shoqërore. Komiteti prej 3 gjyqtarësh gjykoj 12 çështje si raste që Gjykata kishte krijuar një praktikë të konsoliduar dhe ishte shprehur më parë²²⁷, ndërsa 1 vendim u mor nga Dhoma²²⁸. Çështjet në fjalë ishin një vazhdimësi e çështjes së *Kačapor dhe të tjerë kundër Serbisë*²²⁹, ku u morën një seri vendimesh mbi bazën e disa marrëveshjeve miqësore mes palëve. Sipas Gjykatës, duke qenë se shteti ushtronte një kontroll efektiv ndaj pronave me pronësi shoqërore, ishte detyrë e saj që të mbante përgjegjësi për borxhet e tyre. Duke i qëndruar vendimit të marrë mbi çështjen *Kačapor dhe të tjerë kundër Serbisë*, edhe në këto 13 raste, Gjykata urdhëroi Serbinë që ti paguante nga buxheti i shtetit të gjithë shumën e përcaktuar për çdo kërkues nga ana e Gjykatave vendase, duke zbritur shumat që tashmë ishin alokuar më parë. Për shpenzimet e procesit gjyqësor, Serbia duhe ti paguante kërkuesve 2000 euro secilit për dëm jomonetarë.

Gjykata është shprehur me 5 vendime për shkelje të së drejtës për zhvillimin e një procesi gjyqësor civil, penal dhe administrativë në një kohëzgjatje të arsyeshme²³⁰. Të gjitha rastet u gjykuan nga Komitetet prej 3 gjyqtarësh duke qenë se ishin raste të përsëritura dhe ku Gjykata ishte shprehur më parë. Për të gjitha çështjet vendimet u morën në favor të kërkuesve dhe shteti u detyrua të dëmshpërblente kërkuesit për dëmin jomonetarë.

Në vazhdimësinë e gjykimit të çështjes *Savić kundër Serbisë*²³¹, Gjykata u shpreh edhe për 4 raste të tjera²³² të shkeljes të së drejtës për një gjykim në një kohëzgjatje të arsyeshme, por me një veçori, këtu shumat dëmshpërblëse që kishte vendosur Gjykata Kushtetuese për këta shkelje nuk ishin të mjaftueshme. Të gjitha vendimet u morën nga Komiteti prej 3 gjyqtarësh, si raste të mirpërcaktuara nga Gjykata më parë. Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 të Konventës në të gjithë rastet dhe urdhëroi

225 Vendimi i 7 Shkurtit 2017, asnjë shkelje e nenit 8 të Konventës nuk u gjet në *Cvetković k. Serbia*.

226 Vendimet e e Dhomës përfshijnë: Vendimi i 19 Dhjetorit 2017, *Krsmanović k. Serbisë*; Vendimi i 27 Qershorit 2017, *Krndija k. Serbisë*; Vendimi i 4 Prillit 2017, *Milislavljević k. Serbisë*; Vendimi i 21 Marsit 2017, *Mitrović k. Serbisë*, dhe Vendimi i 7 Shkurtit 2017, *Cvetković k. Serbisë*.

227 Vendimi i 10 Janarit 2017, *Mives DOO k. Serbisë*; Vendimi i 24 Janarit 2017, *Nikolić dhe të tjerë k. Serbisë*; Vendimi 14 Marsit 2017, *Tehogradnja DOO k. Serbisë*; Vendimi i 14 Marsit 2017, *Koka Hybro Komerc DOO Brojler k. Serbisë*; Vendimi i 4 Prillit 2017, *Živković k. Serbisë*; Vendimi i 4 Prillit 2017, *Pavlović dhe Pantović k. Serbisë*; 25 Prillit 2017, *Ignjatović k. Serbisë*; Vendimi i 16 Majit 2017, *Janković k. Serbisë*; Vendimi i 3 Tetorit 2017, *Radulović k. Serbisë*; Vendimi i 17 Tetorit 2017, *Batić dhe të tjerë k. Serbisë*; Vendimi i 17 Tetorit 2017, *Maksović k. Serbisë* dhe Vendimi i 17 Tetorit 2017, *Bilić k. Serbisë*.

228 Vendimi i 27 Qershorit 2017, *Krndija k. Serbisë*.

229 Vendimi i 15 janarit 2008, *Kačapor and Others k. Serbisë*.

230 Vendimi i 28 marsit 2017, *Marković k. Serbisë*; vendimi i 28 marsit 2017 *Blagojević k. Serbisë*; vendimi i 28 marsit 2017, *Jovanović k. Serbisë*; vendimi i 17 tetorit 2017, *Stokić k. Serbisë* dhe *Joksimović k. Serbisë*, vendimi i 7 nëntorit 2017.

231 Vendimi i 5 prillit 2016, *Savić k. Serbisë*.

232 Vendimi i 4 prillit 2017, *Ković dhe të tjerë k. Serbisë*, Vendimi i 11 Prillit 2017, *Borović dhe të tjerë, Momčilović dhe të tjerë k. Serbisë*, vendimi i 5 dhjetorit 2017, dhe *Milovanović k. Serbisë*, vendimi i 19 dhjetorit 2017.

dëmshpërblimin e kërkuesve për dëm jomonetar. Përpara se kërkuesit të parashtronin pretendimet e tyre në GJEDNJ, ata kishin zhvilluar dhe një process gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese vendase, ku kjo e fundit kishte gjetur shkelje të nenit 6 në të gjithë rastet, dhe kishte urdhëruar dëmshpërblim për dëmin jomonetarë të shkakuar. Ashtu si në rastin e *Savić dhe të tjerë*, edhe në këto raste, shteti kundërshtonte pranueshmërinë e pretendimeve të kërkuesve duke qenë së për këtë shkelje, Gjykata Kushtetuese kishte marrë një vendim në favorin e tyre si dhe dëmshpërblimi i akorduar nga Gjykata Kushtetuese ishte i mjaftueshëm për cënimin e të drejtës tyre për nenin 6 të Konventës. Gjykata u shpreh se duke qenë së kundërshtimi i shteti bazohet në themelin e çështjes, ashtu si dhe në rastin e *Savić dhe të tjerë*, atëherë edhe keto çështje duhen gjykuar në themel. Duke i gjykuar çështjet në themel, Gjykata u shpreh në të njëjtën mënyrë që ishte shprehur edhe mbi çështjen *Savić dhe të tjerë*, duke vënë theksin te fakti nëse Gjykata Kushtetuese kishte akorduar një shumë të arsyeshme dhe të drejtë për kërkuesit. Sipas Gjykatës, shuma nuk ishte e mjaftueshme dhe ishte më e ulët se standardi i vendosur nga GJEDNJ-ja për rastet e ngjashme. Gjykata gjithashtu theksoi se për përcaktimin e shumës dëmshpërblyese ishin marrë parasysh të gjithë rrethanat e çështjeve. Ajo kishte marrë në konsideratë jo vetëm kohëzgjatjen e procesit gjyqësor por edhe sasinë e shumës së akorduar, duke u bazuar në nivelin e jetesës së shtetit palë, dhe gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe faktin që këto pagesa akordohen më shpejt nga gjykatat vendase sesa nga GJEDNJ-ja. Në fund, Gjykata duke parë faktet dhe rrethanat specifike të çështjeve, doli në konkluzionin se shuma e akorduar nga Gjykata Kushtetuese për cenimin e nenit 6 të Konventës ishte e pamjaftueshme. Për kërkuesit nuk ishte zhbërë dëmi edhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dhe si përfundim Gjykata u shpreh se procesi i tyre gjyqësor nuk ishte zhvilluar në një kohëzgjatje të arsyeshme.

Në lidhje me nenin 5§1 të Konventës, e drejta për liri dhe siguri, Gjykata shqyrtoi vetëm çështjen e *Mitrović kundër Serbisë*²³³, ku u gjet shkelje e këtij neni. Ky vendim u dha nga Dhoma. Rasti në fjalë kishte të bënte me dënimin me 8 vite të kërkuesit për vrasje, dhe ky vendim u morë nga një gjykatë e Republikës së Krajnës Serbe. Sipas vendimit, ai duhet të vuante dënimin në rrethin e Manastirit Beli. Në 20 qershor 1996, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Erdut-it, ai u transferua në një burg të Sremskas në Mitrovicë, në territorin e Republikës Serbe, për arsye sigurie. Autoritetet serbe nuk ndërmorën asnjë masë ligjore për njohjen dhe zbatimin e një vendimi të huaj. Kërkuesi qëndroi në ambjentet e burgut në Mitrovicë deri në 5 shkurt të vitit 1999. Atij iu dha e drejta e lejes vjetore për tu larguar nga burgu deri me datë 15 shkurt 1999, por nuk u kthye më dhe për pasojë u lëshua një urdhër arresti. Kërkuesi u arrestua nga autoritetet serbe në vitin 2010, gjatë kohës kur ky i fundit po tentonte të kalonte kufirin nga Kroacia drejt Serbisë. Pas arrestimit, ai u dërgua që të vuante dënimin e mbetur po në burgun në Sremska të Mitrovicës. Kërkuesi u lirua nga burgu në 15 nëntor 2012 për shkak të amnistisë së Presidentit të Republikës së Serbisë. Në 7 mars të vitit 2011, ai kishte nisur një proces gjyqësor civilë për të kërkuar dëmshpërblim për kufizimin e padrejtë të lirisë, por kërkesa e tij ishte rrëzuar. Sipas pretendimeve të kërkuesit, kufizimi i lirisë së tij nga data 7 qershor 2010 deri në 15 nëntor 2012, ishte i padrejtë dhe cënonte nenin 5§1(a) të Konventës. Nga shqyrtimi i çështjes, Gjykata u shpreh se kërkuesi kishte vuajtur një dënim për vrasje, vendim ky i marrë nga një gjykatë e një vendi jashtë juridiksionit të Republikës Serbe, më saktësisht në një vend që dikur quhej Republika e Krajnës Serbe. Fill pas marrjes së vendimit për të, kërkuesi ishte dërguar që të vuante dënimin në një burgë që ndodhej në juridiksionin e Republikës Serbe. Sipas Gjykatës, autoritetet shtetërore nuk kishin kryer asnjë procedurë ligjore për njohjen dhe ekzekutimin e atij vendimi, procedurë që ishte e detyruar të zbatohet për këto raste sipas normave ligjore në fuqi në atë kohë. Në përfundim, Gjykata doli në konkluzionin se duke qenë se nuk

233 Vendimi i 21 marsit 2017.

ishite ndjekur procedura e njohjes se vendimit të huaj nga autoritetet vendase, ky vendim nuk egzistonte në Republikën e Serbisë dhe për pasojë kërkuesi nuk mund të vuante një dënim që nuk ishte njohur më parë nga autoritetet shtetërore vendase. Gjykata u shpreh se ndalimi dhe kufizimi i lirisë së kërkuetit ishte i padrejtë dhe për pasojë ishte shkelur neni 5§1(a) i Konventës.

Në lidhje me nenin 10, e drejta e shprehjes, Gjykata ka shqyrtuar vetëm një çështje, ku dhe ka gjetur shkelje të këtij neni. Çështja në fjalë ishte *Milisavljević kundër Serbisë*²³⁴ dhe vendimi u morë nga Dhoma. Kërkuesi në këtë rast u dënua për një artikull me titull “Hetuesi i Hagës”, të botuar në të përditshmen *Politika*. Sipas gjykatës vendase, kërkuesi kishte kryer veprën penale të fyerjes duke e konsideruar N.K-në si një “shtrigë dhe prostitutë”. Kërkuesi u dënua për këtë vepër penale. Sipas Gjykatës ishte e qartë që shteti kishte ndërhyrë në të drejtën e individit për të shprehur mendimin e tij, duke qenë se ky mendim prekte dhe cenonte reputacionin e një individi tjetër. Në rastet kur kemi dy të drejta që përplasen me njëra-tjetrën, nga një anë e drejta e gjithëkujtë për të shprehur mendimin lirshëm dhe nga ana tjetër e drejta e respektimit të jetës private, detyra e Gjykatës është të përcaktojë raportet e balancës dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes së shtetit. Sipas Gjykatës, ky dallim duhet të bëhet mes individit dhe personave që i përkasin sferës publike, siç janë politikanët, persona që merren me punët publike apo aktivistë të tjerë. Duke qenë se një person që nuk i përket sferës publike dhe nuk ndikon në të me anë të punës apo pozicionit të tij do të gëzonte të drejtën që të kërkonte mbrojtjen e jetës private pa asnjë përjashtim, persona që janë figura publike dhe që puna e tyre lidhet me publikun, mund të përballen me kritika dhe komente më të zgjeruara si pasojë e aktivitetit tyre, dhe për këtë arsye duhet të pranojnë një ndërhyrje më të madhe në jetën e tyre private dhe të jenë më shumë tolerantë ndaj këtyre ndërhyrjeve. Gjykata doli në përfundimin se reagimi i autoriteteve vendase ndaj kërkuetit dhe artikullit të tij ishte i papërshtatshëm për një vend demokratikë dhe nuk i shërbente një qëllimi legjitimë. Sipas Gjykatës, pavarësisht se fjalët e përdorura nga kërkuesi ishin ofenduese dhe nuk ishin përdorur thonjëza apo mënyra tjera filtrimi, ato fjalë nuk ishin mendimi apo reagimi i tij personal, por ndjesia që kishin të tjerët ndaj N.K-së. Gjykata vuri theksin të fakti që autoritetet vendase nuk ishin përqëndruar në të gjithë tekstin apo kontekstin e shkrimit, por ishin limituar vetëm tek fjalët me konotacion ofendues. Një fakt tjetër shqetësues dhe i papranueshëm për Gjykatën është edhe argumenti i qeverisë se dënimi ndaj kërkuetit ishte i butë. Gjykata nuk ndalet në ashpërsinë e dënimit, por ajo që ka rëndësi për Gjykatën është dënimi i kërkuetit për veprën penale të fyerjes. Nëse kërkuesi, që në këtë rast ishte një gazetarë, do të dënohet për fyerje të supozuara personale duke u bazuar në artikullin e tij për një figurë publike, atëherë, sipas Gjykatës, kjo do të ndikonte në vazhdimësinë e punës së gazetarve për të vëzhguar dhe paraqitur këndvështrimet e tyre për sferën publike.

Në lidhje me nenin 3 të Konventës, ndalimi i keqtrajtimit, Gjykata ka gjykuar vetëm një çështje, çështjen e *Krsmanović kundër Serbisë*²³⁵. Në 1 prill 2003, kërkuesi ishte arrëstuar në bazë të operacionit “Sablá” dhe ishte marrë në pyetje nga policia. Më pas ai vuajti 1 vit e 2 muaj burgë. Me 18 mars 2004, e ëma e kërkuetit i paraqiti një kërkesë Inspektorit të Përgjithshëm të Shërbimeve (IPSH) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke pretenduar se djali i saj ishte torturuar gjatë marrjes në pyetje, si nga agjentët e anti-terrorit ashtu edhe nga ato të policisë. IPSH-ja rrëzoi kërkesën e saj duke pretenduar se nuk bazohej në fakte dhe prova. Me 1 qershorë të vitit 2017, kërkuesi paraqiti një ankesë në zyrën e prokurorit të çështjes kundër disa autorëve të panjohur krimesh si dhe ndaj 3 oficerëve të policies, të cilët i identifikoi vetëm nga mbiemri. Duke qenë se kërkesa e tij u rrëzua nga prokurori, ai

234 Vendimi i 4 prillit 2017.

235 Vendimi i 19 dhjetorit 2017.

iu drejtua një ndihmës prokuroi me kërkesën që të hetoheshin një sërë individësh. Edhe kjo kërkesë iu rrëzua dhe në këto rrethana, kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e tij për apelimin e vendimeve të mëparshme. Ndodhur në këto kushte, kërkuesi iu drejtua GJEDNJ-së duke pretenduar se ai ishte keqtrajtuar nga oficerët e policisë, si gjatë kohës së marrjes në pyetje ashtu edhe gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Gjykata e rrëzoi kërkesën e Serbisë që pretendonte se Gjykata nuk kishte kompetenca për gjykimin e çështjes për shkak të tejkalimit të afatit ligjor për gjykimin e saj. Në lidhje me themelin e çështjes, me pretendimin e kërkuetit që ai ishte keqtrajtuar nga oficerët e policisë dhe për këtë arsye ishte shkelur neni 3 i Konventës, Gjykata u shpreh se është detyrë e institucioneve përkatëse të shtetit palë për të hetuar çdo rast të tillë ku ka dyshime të arsyeshme, vecanërisht kur bëhet fjalë për shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky detyrim që kanë shtetet palë për një hetim të mirëqenë vjen edhe për efektë të zbatimit të nenit 1 të Konventës. Gjykata gjithashtu theksoi se duhen plotësuar disa kushte nga shtetet palë që hetimi të konsiderohet i plotë dhe i drejtë, për të plotësuar aspektet procedurale të nenit 2 dhe 3 të Konventës. Së pari, hetimi duhet të jetë i përshtatshëm, duke nënkuptuar që nga ky hetim duhet të përcaktohen fjalorët dhe dënimi për shkelejt e mundshme ligjore. Së dyti, personi apo personat që do të ndërmarin këtë hetim duhet të distancohen dhe të mos kenë asnjë formë raporti me institucionin që po hetohet, si dhe duhet ta ushtrojnë këtë detyrë të pavarur edhe në praktikë. Së treti, hetimi duhet të jetë i plotë dhe i detajuar, dhe autoritetet përkatëse nuk duhet ta marrin vendime për mbylljen e çështjes apo përfundimet, nga informacione sipërfaqësore dhe keqinformime të ndryshme. Së katërti, hetimi duhet të zhvillohet në mënyrë të menjëhershme dhe të merret seriozisht që në momentin që paraqitet një akuzë zyrtare. Pavarsisht se në këtë rast nuk ka pasur ankesa për këtë aspekt të hetimit, autoritetet shtetërore duhet gjithmonë të ndërmarin këto hetime në mënyrë të menjëhershme kur dyshohet që ka shkelje të nenit 3. Së pesti dhe së fundmi, hetimi duhet të lejojë një farë shkalle të arsyeshme transparence dhe dijenie për publikun në lidhje me ecurinë e hetimit, për aq sa mund t'ia lejojë hetimi, duke hequr në këtë rast çdo hije dyshime. Duke u bazuar në këto pika të lartë përmendura, Gjykata mendon se ankesat e paraqitura nga kërkuesi dhe nëna e tij, raportet mjekësore dhe shfaqja e një video, janë prova të mjaftueshme që autoritetet vendase të nisnin një hetim të plotë siç e kërkon edhe Konventa për rastin e keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje dhe gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në burgë. Shteti serb ishte i detyruar që ti kryente këto hetime. Për çështjen në fjalë janë kërkuar hetime nga tre institucione të ndryshme shtetërore. Në fillim kërkesa iu drejtua Inspektoriatit të Përgjithshëm të Shërbimeve, me pas Zyrës së Prokurorit të çëshjes, dhe në fund kërkesa iu drejtua një gjyqtari hetues. Kërkesat u rrëzuan nga këto institucione me argumentin se mungonin provat, që në këtë rast kishte të bënte me mungesën e keqtrajtimit apo identitetin i keqtrajtuësve. Hetimet e zhvilluara nga autoritetet serbe u ndalën më shumë në marrjen në pyetje të oficerëve të policisë, të cilët dyshohej që kishin marrë pjesë në keqtrajtimin e kërkuetit, por nuk iu dha hapsira e nevojshme kërkuetit që të ishte i pranishëm për të dëgjuar dëshmitë e tyre. Në përgjithësi, pretendimet e kërkuetit nuk u morën shumë seriozisht dhe nuk u vlersuan si të arsyeshme, edhe pse ai gëzonte një raportë mjekësorë që mbështeste pretendimin e tij. Në këndvështrimin e Gjykatës, pavarsisht se autoritetet serbe kishin të gjithë faktet e mundshme për identifikimin e autorëve, në fundë autorët nuk ishin identifikuar. Sipas Gjykatës, fillë pas marrjes së kërkesës së kërkuetit për shkelje të nenit 3, hetimi duhet të ishte shtrirë jo vetëm të oficerët e policisë, por edhe tek persona të tjerë që mund të kishin qenë prezentë në këtë çështje, si dhe ti jepej mundësia kërkuetit që të ballafaqohej me personat e pyetur. Këtë detyrim Serbia nuk e kreu në mënyrën e duhur. Në përfundim, Gjykata mendon se shteti ka dështuar në detyrën e saj për të zhilluar një hetim të mirëfilltë dhe efektivë për rastin në fjalë, pavarsisht se kishte prova të mjaftueshme për të gjetur fajtorët brenda rradhëve të policisë.

Vendimet

Në vitin 2017, Gjykata ka marrë 26 vendime ndaj Republikës së Serbisë. Nga këto 26 vendime, 14 prej tyre nuk u gjykuan nga Gjykata për arsyen se u zgjidhën me anë të marrëveshje mes palëve dhe me zgjidhjen e dhënë nga mekanizmat e ndryshëm ligjorë kombëtarë²³⁶. Komiteti shpalli si të papranueshme 12 çështje, ndërsa Dhoma shqyrtoi dhe doli me një vendim për 5 nga këto raste²³⁷.

Në çështjen *Muratović*²³⁸, Gjykata e rrëzoi kërkesën e tij me argumentin se Serbia e kishte miratuar ligjin që bazohej në çështjen *Ališić dhe të tjerë*²³⁹, dhe për këtë arsye, rasti i *Muratović* gjente zgjidhje nga legjislacioni i brendshëm serbë.

Në çështjen *Skenderi dhe të tjerë*²⁴⁰, pavarësisht se ishte i ngjashëm me çështjen *Grudić*, ku Gjykata gjeti shkelje të së drejtës së individit për gëzimin e pronës, Gjykata nuk pranoi pretendimin e parë të kërkuësve me argumentin se afati ligjorë prej 3 vitesh që u shfaq në këtë çështje, ishte i drejtë, ligjshëm dhe proporcionalë²⁴¹. Në fundë, Gjykata e rrëzoi kompletë kërkesën e kërkuësit duke qenë se nuk kishin ezauruar të gjithë mjetet ligjore kombëtare për zgjidhjen e problemit tyre²⁴².

Në lidhje me rastin e Dhomës Ekonomike Kroate²⁴³, Gjykata e rrëzoi kërkesën me argumentin se ky institucion nuk përmbushte kushtin e *ratione personae*, duke qenë se nuk ishte tërësisht një organizatë jofitimprurëse që të përmbushte kushtin e nenit 34 të Konevntës, dhe kishte akoma lidhje me Qeverinë e Kroacisë.

Në çështjen *Fejić dhe të tjerë*²⁴⁴, kërkesën e tyre me pretendimin se rasti i vdekjes së një të afërmi të tyre nuk ishte hetuar në mënyrën e duhur nga autoritetet serbe, Gjykata e rrëzoi me argumentin se pretendimet e tyre ishin paraqitur në Gjykatë pas afatit të lejuar 6 mujorë.

Për çështjen *Đorđević dhe të tjerë*²⁴⁵, Gjykata e hoqi nga lista e çështjeve për shqyrtim duke qenë se ky rast kishte gjetur zgjidhje nga autoritete vendase. Kërkuësit pretendonin se ishte shkelur e drejta e tyre për tu shprehur dhe për tu mbledhur lirshëm, përkatësisht neni 10 dhe 11 i Konventës, duke qenë se vendi ku ata do të mbledheshin ishte ndryshuar nga autoritetet vendase. Çështja kishte të bënte me Paradën Gei të vitit 2009, dhe mos lejimi i mbledhjes së Paradës Gei të vitit 2011, 2012 dhe 2013. Gjykata vuri në dukje faktin se problemi i kërkuësve vinte si pasojë e organizimit të mbledhjeve sipas një ligji të vitit 1992, por Gjykata Kushtetuese tashmë kishte marrë masat e duhura për ta ndryshuar këtë ligj. Madje edhe përceptimi i publikut për këto çështje kishte ndryshuar pozitivisht me kalimin

236 Vendimi i 17 janarit 2017, *Đorđević dhe të tjerë k. Serbisë*.

237 Vendimi i 21 marsit 2017, *Muratović k. Serbisë*; Vendimi i 25 prillit 2017, *Dhoma Ekonomike Kroate k. Serbisë*; Vendimi i 4 korrikut 2017, *Skenderi dhe të tjerë k. Serbisë*; Vendimi i 19 shtatorit 2017, *Tordaj k. Serbisë*, dhe Vendimi i 26 Shtatorit 2017, *Fejić dhe të tjerë k. Serbisë*.

238 *Muratović k. Serbisë*, vendimi i 21 marsit 2017,

239 *Ališić dhe të tjerë k. Bosnje Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Maqedonisë*, Vendimi i Dhomës së Madhe i 14 korrikut 2014

240 *Skenderi dhe të tjerë k. Serbisë*, vendimi i 4 Korrikut 2017

241 *Ibid.*, §§ 99-102

242 *Ibid.*, §§.

243 Vendimi i 25 Prillit 2017, Dhoma Ekonomike Kroate.

244 *Fejić dhe të tjerë k. Serbisë*, vendim i 26 shtatorit 2017

245 *Đorđević dhe të tjerë k. Serbisë*, Vendimi i 17 Janarit 2017.

e kohës. Sipas Gjykatës, ndryshimet ligjore që kishin ardhur si pasojë e Gjykatës Kushtetuese ishin të mjaftueshme për të gjetur zgjidhje kërkuesit, dhe për këtë arsye nuk e mori në shqyrtim çështjen.

AIRE Centre

AIRE Centre është një organizatë joqeveritare që përhap njohjen e të drejtës evropiane dhe u ofron ndihmë viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut. Ekipi i juristëve ndërkombëtarë ofron informacione, përkrahje dhe këshilla për standardet juridike të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Eksperiencë të veçantë ka në çështjet gjyqësore para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe ka marrë pjesë në më shumë se 150 çështje. Gjatë 20 viteve të kaluara, AIRE Centre ka mbajtur dhe ka marrë pjesë në seminare të ndryshme në Evropën Qëndrore e Lindore, në favor të avokatëve, gjyqtarëve, zyrtarëve të qeverisë dhe organizatave joqeveritare.

AIRE Centre vëmendje të veçantë i kushton vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku është e pranishme prej mbi një dekade e gjysmë, duke realizuar një sërë programesh për sundimin e ligjit në partneritet me institucionet dhe gjykatat vendore. Synimi ynë nëpër të gjitha këto programe është të çojmë përpara zbatimin vendor të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të ndihmojmë procesin e integritimeve evropiane nëpërmjet forcimit të sundimit të ligjit dhe respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, si dhe me nxitjen e bashkëpunimit rajonal ndërmjet gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të profesionit juridik.



Foreign &
Commonwealth
Office

Përgatitja e këtij botimi është mbështetur nga Zyra e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar dhe Komonuelthit. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Zyrës së Punëve të Jashtme dhe të Komonuelthit.